

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 86-të i botimit
Mars 2018/ Nr. 3



Ministeriali i NATO-s në Bruksel 14-15 shkurt 2018

XHAÇKA-STOLTENBERG

Vlerësohet kontributi ynë në misionet paqëruajtëse

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 86-të i botimit
Nr. 3/2018

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfuturi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)



Përmbajtja

Numri 3

PËRKUJTIMORE

- 8** 6 vjet pa Dëshmorin e Atdheut kapiten Feti Vogli

CEREMONIA

- 10** Përkujtohet 37 vjetori i rënies së dëshmorëve të Fekenit

FORCA TOKËSORE

- 16** Fillon Kursi XI-të i Forcave Speciale

BAZA AJRORE FARKË

- 23** Helikopterët Cougar: Stërvitje për misione brenda dhe jashtë vendit

MEHMET PASHË DËRRALLA

- 40** Ministri i parë i luftës dhe fryma e re e Kombit shqiptar

STAFI

DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA
Albert ZHOLI
Saimir ALIJA

Redaktore korrektore:

Anila DODA

Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



4 MINISTERIALI I NATO-S

Xhaçka-Stoltenberg Vlerësohet kontributi ynë në misionet paqëruajtëse

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, zhvilloi një takim të veçantë me sekretarin e Përgjithshëm të NATO, Jens Stoltenberg, gjatë takimi...



6 QENDRA STËRVITORE E FA

130 rekrutë të rinj nisen drejt Bunavisë

130 djem e vajza janë kandidatët më të rinj për oficerë në Forcat e Armatosura. Për 9 javë ata do të jenë pjesë e Stërvitjes Individuale Bazë, në...



14 STËRVITJA "PUMA"

Gjeneral Kollçaku, inspektoi stërvitjen "Fekeni 18-01"

Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, inspektoi javën që kaloi, datë 8 shkurt, Stërvitjen 72-orëshe të Batalionit të Dytë të...



18 INTERVISTA

Gjeneralbrigade Avdiaj: Viti 2018 vit sfidash dhe prioritetesh

Intervistë me gjeneralbrigade Vladimir AVDIAJ, Komandant i Forcës Ajrore. Gjatë vitit 2018 Forca Ajrore do të marrë...

Ministeriali i NATO-s në Bruksel 14-15 shkurt 2018

Xhaçka-Stoltenberg

Vlerësohet kontributi ynë në misionet paqëruajtëse

Sekretari i Përgjithshëm i NATO, Jens Stoltenberg, vlerësoi angazhimin për buxhetin në fushën e mbrojtjes dhe kontributin njerëzor të ushtarakëve tanë në misionet paqëruajtëse

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, zhvilloi një takim të veçantë me sekretarin e Përgjithshëm të NATO, Jens Stoltenberg, gjatë takimi të ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO, që u mbajt në datat 14 dhe 15 shkurt në Bruksel.

“E informova sekretarin e Përgjithshëm mbi angazhimin e Shqipërisë, që brenda vitit 2024, 2% e Prodhimit të Brendshëm Bruto t’i dedikohet fushës së mbrojtjes, si edhe rikonfirmova rritjen e angazhimit të vendit tonë në të gjitha misionet e NATO dhe BE, apo edhe në misionin e ri kombëtar siç janë emergjencat civile”, - tha ministrja Xhaçka pas takimit.

Nga ana e tij, zoti Stoltenberg, vlerësoi angazhimin e Shqipërisë për të përmbushur detyrimet e ndërmarra në kuadër të buxhetit, dedikuar në fushën e mbrojtjes.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO njëherësh vlerësoi kontributin njerëzor të vendit tonë në misionet paqëruajtëse, për përkushtimin dhe profesionalizimin e ushtarakëve tanë. Takimi i ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO, u zhvillua gjatë dy ditëve në Bruksel, merr një rëndësi të veçantë, pasi i paraprin takimeve përgatitore të Samitit të kryetarëve të shteteve anëtare të Aleancës së Atlantikut të Veriut,

që do të mbahet në Bruksel në 11 dhe 12 korrik. Takimi i ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, pra më 14-15 shkurt 2018 në Bruksel, kishte në qendër të diskutimeve përgatitjen për Samitin e ardhshëm të NATO-s në korrik 2018.

Ministeriali filloi me takimin e

Grupit të Planifikimit Bërthamor. “Kjo është pjesë e konsultimeve tona të rregullta për të mbajtur forcat bërthamore të NATO-s të sigurta, të mbrojtura dhe efektive”, cilësoi në konferencën për shtyp Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, që mbajti përpara



takimeve të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, më 13 shkurt 2018 kur njoftoi mbi agjendën e këtij ministeriali të datës 14-15 shkurt 2018, por dhe në Deklaratën hyrëse që dha para fillimit të takimeve të Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s më 14 shkurt 2018.

Por ndërkohë modernizimi i Strukturës së Komandës së NATO-s, ishte vendimi i rëndësishëm i takimit ministror, "për të siguruar që njëzetentë kombet të mund të veprojnë si një, shpejt dhe në mënyrë efektive". Aleatët ranë dakord të krijojnë dy komanda të reja, një për Atlantikun dhe një komandë mbështetëse për lëvizjen ushtarake brenda Europës, si dhe një Qendër të re Operacioni Cyber.

Pra rënia dakord për të krijuar këtë Komandë të re të Forcave të Përbashkëta për Atlantikun që do të përqëndrohet "në mbrojtjen e linjave të komunikimit të detit midis Amerikës së Veriut dhe Evropës, si dhe infrastrukturës kritike", ishte çështje e rëndësishme në vendimet e këtij ministeriali. "Komanda do të luante një rol vendimtar në krizë dhe konflikt. Tetëdhjetë për qind e Zonës së Përgjegjësisë së SACEUR mbulohet nga uji dhe ne duhet të qëndrojmë përpara kërcënimeve të mundshme si në det dhe nën të". Prandaj krijimi i një komande të re mbështetëse për të përmirësuar lëvizjen e shpejtë të trupave dhe pajisjeve brenda Evropës "është një pjesë kyçe e parandalimit dhe mbrojtjes tonë kolektive".

Në ditën e dytë të takimit, më 15 shkurt 2018, ministrat e Mbrojtjes të NATO-s diskutimet e tyre i përqendruan mbi sigurinë dhe mbrojtjen e NATO-s, dhe rolin e Aleancës në projektimin e stabilitetit dhe luftën kundër terrorizmit, "në progresin tonë në zbatimin e qëndrimit tonë të parandalimit dhe mbrojtjes", gjithashtu në "rolin e NATO-s në projektimin e stabilitetit dhe luftën kundër terrorizmit". NATO kontribuon në Koalicionin Global për të Mposhtur ISIS me fluturimet e mbikëqyrjes AWACS dhe trajnimin për forcat irakiane. "Koalicioni ka bërë përparim të madh, kryesisht për shkak të elasticitetit dhe profesionalizmit të forcave irakiane. Sot,



Sekretari amerikan i Mbrojtjes, vlerëson bashkëpunimin me Shqipërinë

Gjatë takimit të ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s në Bruksel, ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka pati një takim të veçantë me sekretarin amerikan të Mbrojtjes James N. Mattis. Në bisedën miqësore të zhvilluar gjatë punimeve të këtij Ministeriali, sekretari Mattis vlerësoi bashkëpunimin dypalësh Shqipëri-SHBA, sidomos në fushën e sigurisë dhe Mbrojtjes.

Takimi me sekretarin Mattis i paraprin vizitës së ministres Xhaçka në Departamentin Amerikan të Mbrojtjes në muajin prill.

Ndërkohë në takimin Ministerial të NATO-s që u zhvillua në Bruksel në datat 14 dhe 15 shkurt Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka u takua edhe me Ministren e Mbrojtjes të Gjermanisë Ursula von der Leyen ku u bisedua për marrëdhëniet midis dy vendeve në fushën ushtarake, por edhe situatën e sigurisë në rajon.

pothuajse i gjithë territori i mbajtur dikur nga ISIS në Irak dhe Siri është rimarrë. Më shumë se shtatë e gjysmë milion njerëz janë çliruar", tha Jens Stoltenberg, "por ISIS do të mbetet një kërcënim edhe kur ata nuk mbajnë asnjë territor. Kështu që trajnimi për forcat irakiane është çelësi". Prandaj ndërsa Koalicioni zhvendos fokusin nga operacionet luftarake në ndërtimin e kapaciteteve, "mbështetja e trajnimit të NATO-s do të bëhet edhe më e rëndësishme". Madje në përgjigje

të kërkesës nga qeveria irakiane dhe Koalicioni Global, do ta vendosë praninë e NATO-s në "një bazë më të fortë", me procedurat e përcaktuara për gjenerimin e forcave dhe financimin. "Kjo do të ndihmojë ta bëjë Irakun më të sigurt dhe ne jemi më të sigurt". Kështu që lidhur me këtë, takimi ministror i Mbrojtjes i NATO-s ra dakord mbi fillimin e planifikimit për një mision trajnimi të NATO-s në Irak, me qëllim të nisjes së misionit në Samitin e NATO-s në korrik.

130 rekrutë të rinj nisen drejt Bunavisë

Nga 130 kandidatë, 10 kandidatë janë femra dhe 10 kandidatë janë me arsim të lartë

130 djem e vajza janë kandidatët më të rinj për oficerë në Forcat e Armatosura. Për 9 javë ata do të jenë pjesë e Stërvitjes Individuale Bazë, në Shkollën e Trupës në Bunavi (Vlorë). Në ceremoninë e përcjelljes së rekrutëve të rinj, zhvilluar ditën e hënë, më 19 shkurt 2018 paradite ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, vlerësoi numrin në rritje të vajzave dhe të rinjve me arsim të lartë, të cilët kanë aplikuar dhe janë përzgjedhur për të të qenë së shpejti pjesë e Forcave të Armatosura.

"Si ministere e Mbrojtjes do të doja ta përmirësoja akoma më shumë raportin gjinor në favor të vajzave. Sot vlerësoj prirjen e rritjes së këtij numri dhe kërkoj që kjo të kihet parasysh në vazhdimësi. Nga ana tjetër, fakti që për statusin e ushtarakëve të rinj aplikojnë dhe vajza dhe djem me arsim të lartë, na bën të gjithëve shpresplotë se niveli intelektual dhe ai i profesionistëve në ushtrinë tonë do të jetë gjithmone edhe më i garantuar.

Për këto nevojitet padiskutim që testimet në çdo fazë të tyre të kryehen me shumë rregullsi, me shumë seriozitet, me disiplinë dhe transparencë të lartë", - tha ministrja Xhaçka në fjalën e saj.

Në cilësinë e ministres së Mbrojtjes, ajo siguroi të rinjtë dhe familjarët e tyre se do të gjenden pranë në rrugëtimin e bukur dhe plot sfida.

"Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm do t'ju gjenden pranë për përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës dhe bazës materiale për t'u interesuar për vështirësitë e shfaqur në praktikën e përditshme të punës suaj. Ju siguroj se bashkë me gjithë efektivin e FA do të jemi krah jush për t'i shkuar deri në fund dhe me sukses detyrave tuaja, pjesë e kësaj saj rruge të bukur por me plot vështirësi, kufizime, që sapo keni hyrë. Të gjithë bashkë po punojmë që karriera juaj e saponitur, sikundër edhe e gjithë efektivëve të FA, të vlerësohet dhe të promovohet, në bazë të meritave dhe performancës të treguara gjatë punës. Reforma që kemi nisur do t'i krijojë mundësi të gjithëve që të shprehin sa më mirë nivelin e përgatitjes profesionale në shërbim të FA por dhe të rrisin nivelin profesional në përgjithësi të FA, për rrjedhojë edhe cilësinë e realizmit të detyrave të përbashkëta", - deklaroi Ministrja e Mbrojtjes.

Sipas statistikave të muajve të fundit, raporti mes numrit të aplikantëve që kanë shpehur dëshirë për të qenë pjesë e FA dhe atij të kandidatëve të përzgjedhur është gati 3 me 1. Të rinjtë që u nisen për në Bunavi, 130 vetë, ku 10 kandidatë janë femra dhe 10 kandidatë me arsim të lartë rezultuan fitues të testit fizik, intelektual dhe psikologjik, për rekrutimet e reja për ushtarë/detarë aktivë në Forcat e Armatosura.



Vlerësim dhe promovim në bazë të meritokracisë dhe trajtim përherë e më tepër dinjitoz për ushtarakët shqiptarë, ishte mesazhi kryesor që ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, u dha efektivëve të Batalionit III të Këmbësorisë (b3k) në Poshnje, ditën e dielë, më 25 shkurt, gjatë qëndrimit të saj në Berat, në kuadër të mbledhjes së qeverisë në këtë qark. Në vizitën e saj në b3k, ministrja Xhaçka shoqërohej nga zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi dhe komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani.

Fillimisht ministrja Xhaçka falënderoi të gjithë efektivët e këtij batalioni për angazhimin dhe kontributin e tyre në përmbytjet e fundit, sidomos tani që Emergjencat Civile janë nën përgjegjësinë e institucionit që ajo drejton. "Dua të ndalem pak tek



Batalionit III të Këmbëtorisë (b3k) në Poshnje

Misionet paqeruajtëse, përgjegjësi për vete e të tjerët

Ministrja Xhaçka: "Vetëm ata që vërtet meritojnë, janë ata që do të shkojnë në mision dhe kur them meritë, kam parasysh përgatitjen për këtë ditë"

Emergjencat Civile që tashmë janë fushë përgjegjësie e Ministrisë së Mbrojtjes, sepse e kam parë kontributin, dedikimin, përkushtimin, profesionalizmin e gjithsecilit prej jush në ato operacione shumë të vështira në fillim të dhjetorit, kryesisht në zonën e Fierit dhe të Vlorës, por edhe këtu në Berat me punën e jashtëzakonshme që ka bërë gjithsecili prej jush për t'i ardhur në ndihmë atyre banorëve që vuanin pasojat e motit të keq" - tha ministrja Xhaçka,

e cila u shpreh se ishte në dijeni të vështirësive dhe nevojave të ushtarakeve dhe për të cilat shprehu angazhimin e saj për një trajtim më dinjitoz për secilin prej tyre.

Më tej ministrja Xhaçka zhvil-

loi një bisedë të shkurtër edhe me ushtarakët që kanë kaluar me sukses testet për t'u bërë pjesë e kontingjentit të ardhshëm shqiptar, i cili do të shërbejë në misionin e NATO Resolute Support në Kabul të Afganistanit, në kuadër të rritjes së kontributit të vendit tonë dhe shtimit të trupave shqiptarë në këtë mision.

Ministrja Xhaçka i siguroi ata për një proces përzgjedhës të rregullt, të bazuar tërësisht në meritë dhe për të cilin mori konfirmimin e tyre. "Është shumë e rëndësishme që ky të jetë një proces, i cili vlerëson më të mirët, që vlerëson meritokracinë dhe vlerëson ata njerëz që vërtet janë të përgatitur për të shkuar në



misione paqeruajtëse, sepse sigurisht, ju të gjithë e kuptoni që është një përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe që merrni mbi vete, jo vetëm për t'i shërbyer vendit tonë, por edhe për të projektuar siguri atje ku shkoni. Që do të thotë mbroni të tjerët edhe mbroni veten dhe duhet të jeni maksimalisht të përgatitur për këtë moment dhe prandaj insistoj që këto testimet, që ky moment vlerësimi të jetë sa më i hapu, sa më transparent edhe gjithsecili prej jush të jetë i qartë për vlerësimin që merr dhe për vlerësimin që merr shoku juaj. Vetëm ata që vërtet meritojnë, janë ata që do të shkojnë në mision dhe kur them meritë, kam parasysh përgatitjen për këtë ditë. Dhe që ky mjedis të jetë më konkurrues dhe të promovojë realisht cilësinë dhe profesionalizmin, duhet të jeni të gjithë në garë më njeri – tjetrin."

PËRKUJTIMORE

6 vjet pa Dëshmorin e Atdheut kapiten **FETI VOGLI**

*“Dëshmorit të Atdheut”, kapiten Feti Vogli,
humbi jetën në misionin luftarak “Eagle 4”,
në Kandahar, Afganistan*

Në mjediset e batalionit të Forcave Speciale, u zhvillua të martën më 20 shkurt, ceremonia përkujtimore me rastin e 6 -vjetorit të rënies në krye të detyrës të Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli, në misionin luftarak “Eagle 4”, në Kandahar, Afganistan. Në ceremoni morën pjesë ministrija e Mbrojtjes znj. Olta Xhaçka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani, komandanti i Batalionit të Forcave Speciale kolonel Ilirjan Dauti, komandantë forcash dhe repartesh autonome të Shtabit të Përgjithshëm, miq, familjarë dhe të afërm të Dëshmorit të Atdheut kapiten Feti Vogli. Ministrija e Mbrojtjes Olta Xhaçka, në fjalën e saj u shpreh se vepra e të rënëve nuk harrohet, por ajo do të kujtohet e do të respektohet brez pas brezi dhe se do të vlerësohet edhe në të ardhmen për arritjen e objektivave.

“Nga Afganistani në Irak, nga Çadi në Bosnje, nga Kosova në Mali, nga Adriatiku në Egje dhe kudo që na kërkohet, shembulli i Feti Voglit na mëson se detyra dhe përkushtimi për sigurinë e paqen, i bën ushtarakët tanë të marrin mbi vete rrezikun e sfidave të përditshme, veçanërisht në misione. Rënia në krye të detyrës e kapiten Feti Voglit, është dëshmi e faktit, se ju, jo vetëm keni zgjedhur një profesion të vështirë, por edhe se kurajo, përkushtimi, vetëmohimi dhe mbi të gjitha, profesionalizmi juaj, janë tiparet, që përshkojnë integritetin tuaj si bij fisnikë të popullit, si shërbëtorë besnikë të atdheut. Është kjo arsyeja që shembulli i kapiten Feti Voglit dhe ushtarakëve shqiptarë në misione, frymëzon brezat e rinj sot e kurdoherë”, - deklaroi ministrija.

Sipas ministres Xhaçka, prania e Shqipërisë në Aleancën e NATO dhe përkushtimi ynë, sikundër e dëshmon edhe shembulli i Feti Voglit, janë pjesë e vlerave të patjetërsueshme që shoqëritë e vendeve partnere me ne, besojnë, mbrojnë dhe promovojnë.

“Ne si shqiptarë, këndeje dhe an-

dej kufirit, nuk harrojmë për asnjë moment, se NATO është mburoja më e besueshme përballë çdo agresioni dhe barbarie që shfaqet pranë dhe larg vendndodhjes sonë gjeografike. Çmimi sublim i kapiten Feti Voglit na tregon se forcat që na kërcënojnë vlerat, parimet dhe mënyrën tonë të të jetuarit në një sistem demokratik dhe shoqëri të lirive dhe të drejtave të njeriut, janë akoma aty, duke e sfiduar çdo ditë mjedisin e sigurisë sonë kolektive”, - deklaroi ministrija e Mbrojtjes gjatë ceremonisë ku merrni pjesë familjarë të Dëshmorit të Atdheut dhe kolegë të tij.

Komandanti i batalionit të Forcave Speciale, kolonel Ilirjan Dauti, në fjalën e mbajtur në këtë ceremoni përkujtimore, u shpreh ndër të tjera se: “...ne e nderojmë me respekt, e kujtojmë me dëshpërim, por askush nuk mund ta kuptojë dhembjen dhe humbjen më shumë se familja e tij. U bënë 6 vjet nga dita kur nëna humbi birin, bashkëshortja udhëtarin e saj të jetës, fëmija prindin, vëllai vëllanë dhe kolegët shokun që do t’iu mungojë gjatë, megjithatë kujtimi i Fetiut do të mbetet i gjallë në mendjet dhe zemrat e të gjithëve...” - tha ndër të tjera kolonel Dauti.





Portreti i Dëshmorit Feti Vogli në panteonin e martirëve të luftës në Afganistan

Nënkolonel KASEM SALIASI
Kabul, Afganistan

Ceremonia përkujtimore me rastin e 6-vjetorit të rënies në krye të detyrës së Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli, u përmbyll me vendosjen e kurorave pranë bustit të tij, në nderim dhe respekt të sakrificës sublime të tij, në shërbim të paqes dhe demokracisë.

Kapiten Feti Vogli, humbi jetën 6 vite më parë në Afganistan, ku shërbeu si pjesë e kontingjentit paqeruajtës "Eagle 4" të batalionit të Forcave Speciale. Ai është pjesë-tari i parë i Forcave të Armatosura që humb jetën në një mision jashtë vendit.



Gjashtë vjetori i rënies në krye të detyrës të Dëshmorit të Atdheut, Kapiten Feti Vogli është përkujtuar në një ceremoni të veçantë, të zhvilluar në mjediset e komandës së "Mbështetjes së Luftës" në vendin ku ai luftoi dhe dha jetën në Afganistan.

Me iniciativën e Përfaqësuesit të Lartë Ushtarak Kombëtar Shqiptar në Afganistan Kolonel Altin Kurti, portreti i dëshmorit të atdheut Kapiten Feti Vogli, vendoset në panteonin përkujtimorë midis portreteve të dhjetra ushtarakëve të NATO-s të rënë në krye të detyrës në Afganistan.

Ishin ftuar dhe merrnin pjesë në këtë ceremoni: Gjeneral Brigade Michael Fenzel Drejtor i Planifikimit të Mbrojtjes, drejtues të lartë të komandës dhe shtabit të "RS" si dhe ushtarakë dhe civilë të tjerë kolegë të kontingjentit shqiptar në këtë komandë.

Gjeneral Fenzel, në fjalën e rastit vlerësoj dhe çmtoj kontributin e Ushtrisë Shqiptare në përgjithësi dhe në veçanti të ushtarakëve shqiptarë të pranishëm në mision për tu përqëndruar më pas tek dëshmori Kapiten Feti Vogli.

Midis të tjerash Gjeneral Fenzel theksoj se: "Sot është një ditë tepër e veçantë për të kujtuar një nga shokët e armëve i cili sakrifikoj jetën në emër të paqes në këtë vend Kapiten Feti Vogli. Pikërisht si sot gjashtë vite më parë ai dha jetën në shërbim të lirisë për popullin e Afganistanit. Vendosja e portretit të tij në panteonin e dhjetra martirëve të tjerë që kanë dhënë jetën në këtë mision i shton më tepër energjitë këtij gjeneratori i cili na frymëzon e na nxit për të punuar më me përkushtim në punën tonë. Ai vërtetë iku në moshë të re por vepra dhe emri i mirë që la pas do të kujtohen nga ne dhe brezat e tjerë që do të vijin".

Kolonel Kurti në emër të SHSHP të FA dhe MM, falenderoi në radhë të parë Gjeneral Fenzel, për përkrahjen dhe ndihmën që ai dha në vendosjen e portretit të Kapiten Voglit në këtë panteon. Ai falenderoj gjithashtu edhe të gjithë të pranishmit të cilët nderuan me praninë e tyre në ceremoni.

Me tej Kolonel Kurti midis të tjerash theksoj se: të gjithë ata që punuan me Kapiten Feti Voglin, e njohën si një njeri i cili shkëlqeu me pasionin e tij për punën dhe për këtë ai gëzoj respekt dhe besim nga të gjithë kolegët dhe bashkëluftëtarët e tij. Gjatë gjithë kohës së shërbimit të tij atë e karakterizoj përkushtimi i lartë ndaj detyrës. Si e tillë, vendi ynë, Shqipëria, jo vetëm që i nderon e respekton heronjtë e vetë por gjen tek ata edhe forcën për të ecur përpara. Në të njëjtën kohë, Shqipëria është e angazhuar për të kontribuar për paqen dhe do të vijojë të luftojë kundër terrorizmit global.

Më pas moderatori i ceremonisë, Nënkolonel Ken Smith (SHBA) lexoj me zë të lartë për të gjithë të pranishmit jetëshkrimin në portretin e kapiten Voglit. Pas kësaj të gjithë të pranishmit në ceremoni, me radhë, bënë homazh dhe u falën duke shfaqur respekt të thellë para portretit të dëshmorit kapiten Vogli.

Për realizimin e kësaj ceremonie u angazhuan me përkushtim të veçantë të gjithë ushtarakët Shqiptar që aktualisht shërbejnë në komandën "Resolute Support" në Kabul si; Kolonel Altin Kurti, Nënkolonel Kasem Saliasi, Major Alkion Dalanaj dhe Nënkolonel Edvis Spahi si dhe stafi i Institutit Gjerman të Gjeografisë me në krye Nënkolonel Thomas Hirsch.

Kapiten Vogli la pas veprën e tij që vështirë se do të mund të harrohet, ai është tashmë pjesë e memories jo vetëm kombëtare shqiptare por edhe në Afganistan. Ai tashmë do të kujtohet e nderohet edhe nga të gjithë ndërkombëtarët që do të shërbejnë në këtë komandë.



Përkujtohet 37 vjetori i rënies së dëshmorëve të Fekenit

Më datën 6 shkurt 2018 pranë Obelisikut të Dëshmorëve të Fekenit në Garnizonin "Skënderbej" u zhvillua ceremonia përkujtimore me rastin e 37 vjetorit të rënies së Dëshmorëve të Fekenit. Në ceremoni ishin të pranishëm: Zëvendësministri i Mbrojtjes zoti Petro Koçi, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA General Brigade Bardhyl Kollçaku, Zëvendës shefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes Gjeneral Brigade Bajram Begaj, Zëvendës komandanti /Zëvendësrektori i Akademisë së Forcave të Armatosura Kolonel Edmond Braneshi, familjarë, të afërm dhe bashkëkohës të dëshmorëve, ushtarakë të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA si dhe Akademisë së Forcave të Armatosura.

Zëvendës komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Kolonel Edmond Braneshi në fjalën e rastit falënderoi të pranishmit, kujtoi misionin fisnik dhe aktin heroik të ushtarakëve që ranë në krye të detyrës për të mos vdekur kurrë. "...Sot në 37 - vjetorin e rënies në krye të detyrës së Dëshmorëve të Fekenit vijmë të gjithë së bashku për të përkujtuar veprën e tyre madhore, që mbart në vetvete një histori duke i dhënë përjetësinë 11 dëshmorëve. 6 shkurti është dita e mesazhit të sakrificës, që ruan dhe transmeton ndjenjën vetëmohuese të trimërisë dhe guximit, aq sa e dhimbshme është edhe e lavdishme për gjithë ushtarakët shqiptarë. Akti heroik i tyre ka lartësuar figurën e personalitetin e të gjithë ushtarakëve dhe protagonistëve të kësaj ngjarjeje. Ndaj jemi këtu për të shprehur nderimin e respektin për jetën dhe veprën e dëshmoreve tanë: Komandantit të Batalionit Dushan Shamenti, Shefit të planëzimit Çlirim Pulaj, petagogut Nikolaj Bero, studentëve: Aleko Gjoni,

Besnik Shehu, Bilbil Pashaj, Bujar Aga, Ilir Gramatiko, Nexhip Çopa, Gemal Lika, Pëllumb Rrapo"

Kolonel Braneshi shprehu mirënjohjen e thellë prindërve e të afërmeve të dëshmorëve të Fekenit si dhe shokëve të tyre, që në çdo 6 shkurt kanë qënë së bashku për të respektuar aktin e tyre heroik.

Në emër të bashkëkohësve dhe familjarëve foli ish pedagogu i përgatitjes fizike dhe ushtarake zoti Mark Mici, i cili në fjalën e tij vlerësoi aktin heroik të pedagogëve dhe studentëve të Shkollës të cilët

Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, Akademisë së Forcave të Armatosura si dhe u vendosën tufa me lule nga familjarët, të afërmit dhe shokët e tyre. Më 6 shkurtit 1981 gjatë një stërvitje dimërore të studentëve të ish-Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Feken, për shkak të rënies së dy ortekëve të dëborës që u shkëputën nga mali i Meçekut humbën jetën 3 pedagogë dhe 8 studentë të Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve. Në kujtim të veprës së tyre të pavdekshme



me vetmohim dhe heroizëm arritën të shpëtonin shumë jetë njerëzish. Jemi këtu për të nderuar kujtimin dhe veprën e pavdekshme të tyre".

Të gjithë të pranishmit mbajtën një minutë heshtje në shenjë respekti për 11 dëshmorët e 6 shkurtit. Pranë Obelisikut të Dëshmorëve të Fekenit u vendosën kurora me lule në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura,

një rrugë në Tiranë mban emrin "Rruga Dëshmorët e Fekenit".

"Bijtë e pavdekshëm të Shkollës së Bashkuar të Oficerave" me autor Kadri Shametaj - është libri që i kushtohet 11 dëshmorëve, oficerë e studentë, që dhanë jetën e tyre të re në krye të detyrës për shpëtimin e shokëve nga orteku i dëborës në qendrën stërvitore të Fekenit.

Majore Merita Alimuçaj

NË TETOR-STËRVITJA “KASTRIOTI-18”

Në ambientet e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, filloi ditën e hënë, më 26 shkurt, punimet seminary për procesin e planëzimit operacional me personelin e Shtabit të Përgjithshëm. Në hapjen e punimeve të këtij seminary morën pjesë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, drejtori i Operacioneve dhe Stërvitjes në SHPPFA, kolonel Ilir Xhebexhia, si dhe drejtorët e drejtorive në SHPPFA.

Në përshëndetjen e tij në këtë seminar, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, pasi theksoi rëndësinë e përgatitjes së shtabeve për planëzimin dhe drejtimin e operacioneve luftarake dhe jo luftarake, u shpreh ndër të tjera se: "Ky seminar do të jetë në funksion të përgatitjes së personelit të Shtabit të Përgjithshëm për stërvitjen komando shtabi "Kastrioti-18", që do të zhvillohet në muajin tetor të këtij viti.

Në vijim drejtori i Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm, kolonel Ilir Xhebexhia prezantoi punën e bërë për përgatitjen seminary, përmbajtjen e tij si dhe theksoi nevojën e angazhimit të gjithë personelit pjesëmarrës për arritjen e objektivit që ka të bëjë me aftësimin e person-



Planëzimi operacional me personelin e Shtabit të Përgjithshëm

elit për zbatimin e procedurave të planëzimit dhe drejtimit të operacioneve. Seminary u zhvillua nga data 26 shkurt 2018 deri më datë 2 mars 2018 dhe u organizua

dhe drejtua nga Sektori i Trajnimit dhe Stërvitjes, në Drejtorinë e Operacioneve dhe Stërvitjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcës së Armatosura.

Gjeneral Kollçaku inspekton Bazën Ajrore, Kuçovë

Më datën 9 shkurt 2018, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, bëri një vizitë njohëse në

Bazën Ajrore, Kuçovë. Gjeneral Kollçaku shoqërohej nga zëvendëseshfi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Manushaqe Shehu, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Vladimir Avdiaj, komandantët e Forcave dhe drejtorët e drejtorive në SHPPFA. Gjatë kësaj vizite, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, nëpërmjet një brifingu, u informua mbi misionin, detyrat dhe gjendjen aktuale

të kësaj baze, si dhe më pas inspektuan nga afër mjediset e Bazës, duke u njohur me infrastrukturën dhe kapacitetet që kjo bazë ofron.



Gjeneral Kollçaku uron gjeneralin Brahman Rama

Gjeneral Kollçaku: FSK rol konstruktiv në stabilitetin rajonal

Me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, shefi i Shtabit i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ka uruar komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Brahman Rama. Në letër, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA të Shqipërisë, shprehet. „Me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, më lejoni që në emrin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, por edhe në emrin tim personal, t'ju përcjell urimet më të singerta e të përzemërta. Ky përvjetor, shënon një datë jubileare jo vetëm për popullin e Kosovës, por për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Në këto dhjetë vite, jo vetëm janë hedhur themelet e forta të shtetit të Kosovës, por hapat e bëra për konsolidimin dhe integrimin e këtij shteti në strukturat Euro-Atlantike janë të konsiderueshme”.

Më tej, gjenerali Bardhyl Kollçaku, shkruan: „Pjesë e rëndësishme dhe vitale e shtetit të Kosovës është edhe Forca e Sigurisë së Kosovës, e cila me shërbimin e saj ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës, ka arritur të krijojë besimin dhe krenari brenda vendit, ndërkohë që gëzon mbështetje ndërkombëtare gjithnjë e në rritje”.

Në fund, shefi i Shtabit të FA të Republikës së Shqipërisë, gjenerali Kollçaku shkruan: “Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vlerësojnë jashtëzakonisht shumë rolin dhe kontributin e Forcave të Sigurisë së Kosovës në drejtim të forcimit të stabilitetit në rajon. FARSH do të vijojnë mbështetjen për FSK transformimin dhe integrimin sa më të shpejtë në strukturat Euro-Atlantike të sigurisë, si dhe të forcojë bashkëpunimin dypalësh në fusha të ndryshme ushtarake”.



Më datën 15 shkurt 2018 në mjediset e auditoriumit “Gjeneral Enrico Tellini” të Garnizonit “Skënderbej” u zhvillua sesioni shkencor me temë “Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë dhe pavarësia e saj”, organizuar nga akademistët e Kursit të Lartë të Oficerit nën kujdesin e Departamentit të Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore të Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Në sesionin shkencor morrën pjesë Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA Gjeneral Brigade Bardhyl Kollçaku, Zëvendësministri i Mbrojtjes i Forcës së Sigurisë së Kosovës zoti Burim Ramadani, Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës Gjenerallejtënant Brahman Rama, Zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA Gjeneral Brigade Manushaqe Shehu, Komandanti i Komandës së Doktrinės dhe Stërvitjes Gjeneral Brigade Bajram Begaj, Komandantët e Forcave, drejtorë drejtorie në SHP, Zëvendëskomandanti /Zëvendësrektor i Akademisë së Forcave të Armatosura Kolonel Edmond Braneshi, ushtarakë të shtabit të KDS, QDK, kurset institucionale të Akademisë së Forcave të Armatosura, etj.

Fjalën e hapjes në sesionin shkencor e mbajti Shefi i Departamentit të Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore Kolonel Prof. Asoc. Dr. Agim Sula. Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës zoti Burim Ramadani, theksoi se viti 2018 është viti i Skënderbeut, viti i 20 vjetorit të rënies së heroit Adem Jashari si dhe i 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Uroj që sesioni shkencor të shkojë mbarë dhe jemi krenar për mbështetjen e dhënë nga shteti Shqiptar si dhe nga vendet e tjera të NATO-s e BE. Bashkëpunimi ynë është i hapur dhe njëkohësisht shëmbull i bashkëpunimit në rajon drejt rrugës për në NATO dhe në Bashkimin Europian”.

Në përsëritjet e tij në këtë sesion shkencor, komandanti i Komandës së Doktrinės dhe Stërvitjes, gjeneral brigade Bajram Begaj, pasi falënderoi të gjithë të pranishmit u shpreh se: “Sot mbushen 10 vjet nga shpallja e Pavarësisë së Kosovës. Deri në këtë ditë u desh një luftë e gjatë, gati shekullore, që ajo, në tokën e vet, të dhënë nga zoti, të shijonte lirinë si dikur, mote

10 vjetori i Pavarësisë dhe
19 vjetori i ndërhyrjes të NATO-s

“Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë dhe pavarësia e saj”

Sesion shkencor me rastin e 10 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës dhe 19-vjetorit të ndërhyrjes ushtarake të NATO-s në Kosovë

më parë... U deshën 10 vite për të ardhur në 17 shkurt 2008... Kosova sot është një realitet evropian dhe ndërkombëtar, ka në themel të vet orientimin properëndimor, orientimin drejt ekonomisë së tregut, demokratizimin e vendit, barazinë e qytetarëve, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, respektimin e vlerave më të mira të minoriteteve, stabilizimin në rajon dhe ndërkombëtar dhe mbi të gjitha është një shtet modern që bazohet në vlerat më të mira perëndimore...”, - u shpreh ndër të tjera gjeneral brigadegjeneral Begaj.

Një përshëndetje e veçantë në këtë aktivitet u adresua nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH,

gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili duke shprehur kënaqësinë e tij, theksoi se ky sesion është një evokim që i bëhet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe 10 - vjetorit të Pavarësisë së Kosovës. Gjithashtu, gjeneral brigade Kollçaku, falënderoi kontributin e dhënë nga FSK në emergjencat civile, ku sot inaugurohet dhe një nga urat në Korçë, ku FSK ka dhënë kontributin e saj.

Më pas, aktiviteti ka vazhduar me referate nga studentë kosovarë dhe shqiptarë të Kursit të Lartë të oficerit, në Akademinë e Forcave të Armatosura shqiptare.

Nënkolonel Bekim Fejzullahu, mbajti kumtesën “Rruga e Kosovës drejt pavarësisë dhe konsolidimit të

saj si shtet demokratik dhe funksional”. Nënkolonel Shpëtim Gjepali mbajti kumtesën “Krimet e luftës nga forcat ushtarake e policore-jugosllave në Kosovë”. Nënkolonel Dritan Merdani mbajti kumtesën “Argumentet ligjore pro ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë”. Nënkolonel Lavdim Çota mbajti kumtesën “Argumentet ligjorë kundër ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë”. Nënkolonel Bedri Qoli mbajti kumtesën “Raporti i Komisionit Ndërkombëtar për Kosovën”.

Përfundimet e punimeve të Sesionit Shkencor “Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë dhe pavarësia e saj” u mbajtën nga Zëvendëskomandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura Kolonel Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi, i cili vlerësoi punën e bërë nga akademistët e Kursit të Lartë të Oficerit në veçanti akademistët e ardhur nga Kosova dhe Departamenti i Lidershipit dhe Shkencave Shoqërore. Ky Departament, theksoi ai - krahas mësimdhënies ka gjetur hapësirat e nevojshme për punë kërkimore, për ti bërë pjesë të eventeve kombëtare dhe njëkohësisht për të shpalosur vlerat e tyre të brendshme. Është mirë që në këtë kuadër, edhe temat kursore të bëhen prezent në këtë auditor, gjë që do të rrisë përgjegjësinë për një punë me cilësi më të lartë kërkimore e shkencore. Në përfundim të fjalës Kolonel Braneshi i uroj të pranishmit për 10 vjetorin e pavarësisë së Kosovës.

Merita Alimuçaj



Stërvitja 72-orëshe e Kompanisë III "Puma"

Gjeneral Kollçaku, inspektoi stërvitjen "Fekeni 18-01"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, inspektoi në datë 8 shkurt, Stërvitjen 72-orëshe të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë së Forcës Tokësore (b2kFT), "Fekeni 18-01". Në këtë inspektim ai shoqërohej nga zëvendëshefja e Shtabi të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Manushaqe Shehu, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani, komandanti i b2k kolonel Arjan Hila, drejtorë drejtorish në SHP, si dhe përfaqësues nga shtabi i Forcës Tokësore.

Në fjalën e tij drejtuar trupave të këtij reparti elitë jo vetëm të Forcës Tokësore, por edhe të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Kollçaku, pasi vlerësoi përgatitjen e tyre profesionale, u shpreh ndër të tjera: "...ishte kënaqësi e veçantë për mua, por besoj edhe për gjithë drejtorët e Shtabit të Përgjithshëm, që të ndiqnim nga afër përfundimin e stërvitjes 72-orëshe të Kompanisë III "Puma". Një planëzim i shkëlqyer nga shtabi i batalionit, i cili u konkretizua me aplikimin tepër profesional të të gjithë efektivit ushtarak oficer dhe nën-oficer në terren. Gëzohem që shikoj që tradita e shkëlqyer, që ky repart ka krijuar ndër vite, jo vetëm që nuk është ndërprerë për asnjë moment gjatë rrugëtimit të tij të lavdishëm në historinë e Forcave të Armatosura, por shikoj me kënaqësi të madhe që ka arritur një nivel vërtetë mbresëlënës, duke qenë një repart i denjë për ecur më të njëjtin hap me homologët e tij në Aleancë. Ju përgëzoj dhe ju falënderoj për emcionin e veçantë, që më dhuroat me demonstrimin tuaj tepër profesional".

Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes, krenohet me efektivetë të nivelit tuaj, duke iu pasur gjithmonë në vëmendjen e veçantë, si bërthama kryesore e transformimit dhe ndërtimit të grup batalionit, një objektivi ky që po bëhet i prekshëm nga dita në ditë.



Jemi sot këtu për të siguruar gjeneral brigade Cahani dhe kolonel Hilën, se do na keni gjithmonë pranë për t'ju mbështetur në objektivin madhor, që është certifikimi i grup - batalionit...." - tha ndër të tjera gjeneral brigade Kollçaku, në fjalën e tij drejtuar efektivëve të b2kFT.

Një vlerësim të veçantë për stërvitjen e trupave të b2kFT, shprehu edhe zëvendëshefja e Shtabi të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Manushaqe Shehu, e cila përgëzoi të gjithë efektivin e b2kFT, për masat e marra për realizimin e një stërvitje reale dhe me standarde, sipas kërkesave të NATO duke vlerësuar në mënyrë të veçantë pjesëmarrjen e efektivit femër në këtë stërvitje.

"Vura re se asgjë nuk i dallonte ato, në fushën e luftimit nga kolegët e tyre meshkuj. Vura re me krenari moralin e tyre të lartë, krenarinë për uniformën që mbajnë veshur. Shpresoj dhe besoj shumë se në të ardhmen numri i vajzave që do t'i bashkohen Forcave të Armatosura, do të jetë edhe më i madh. Por jo vetëm numri, por jam e bindur se edhe cilësia dhe

profionalizmi i tyre do të vijë vetëm duke u rritur" - u shpreh gjeneralë brigade Shehu.

Stërvitja "Fekeni 18-01" u zhvillua në rajonin stërvitor të Fekentit dhe i përkiste karakterit të luftimit mësymës. Inspektimi i gjeneral brigade Kollçakut, përkoi me fazën e tretë të zhvillimit të "Fekeni-18", e cila përfshinte ekzekutimin e stërvitjes dhe realizimin e vlerësimit.

Dinamika e veprimeve gjatë kësaj faze, përshtu realizimin me sukses të një sërë detyrave si: përcaktimi i rrugëve të lëvizjes; përgatitja me artileri e mësymjes; afrimi në vijën kryesore të mbrojtjes së armikut; marrja e objekteve të përcaktuara në planin e luftimit; mbështetja me artileri e mësymjes, si dhe futja në luftim e rezervës për realizimin e detyrës së largët.

Të gjitha këto veprime të kryera me përpikmëri dhe profesionalizëm të lartë nga efektivët e b2kFT, u ndoqën në çdo hap të tyre me vëmendje të veçantë nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku dhe stafi që e shoqëronte.

Bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Turqi në interes të përbashkët

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerale brigade Manushaqe Shehu, priti më 7 shkurt, në një takim kortezie zëvendës atasheun ushtarak të Republikës së Turqisë në Shqipëri, kapiten Adem Turksoy. Qëllimi i takimit ishte urimin e gjenerale Shehut me rastin e marrjes së detyrës së re, atë Zëvendës shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Gjenerale brigade Shehu, pasi i uroi mirëseardhjen në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare e njohu atë me zhvillimet më të fundit në FARSH. Gjatë takimit, Gjenerale brigade Shehu ka vlerësuar bashkëpunimin shumë të mirë midis dy vendeve, Shqipërisë dhe Turqisë dhe në këtë kuadër bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, e cila ka konsistuar në arsimimin dhe kualifikimin e ushtarakëve shqiptarë në akademitë dhe shkollat ushtarake turke në të gjitha nivelet dhe llojet e forcave. "Pjesëmarrja në stërvitje të përbashkëta, mbështetja logjistike, bashkëpunimi në kuadër të operacioneve ushtarake në përmbushje të angazhimeve të Aleancës dhe më gjerë për menaxhimin e krizave në funksion të paqes dhe stabilitetit, modernizimi i Forcave të Armatosura shqiptare, si dhe kurimi i ushtarakëve në spitalet ushtarake të Turqisë, është treguesi më i qartë, prandaj jam shpresëplotë se ky bashkëpunim dhe mbështetje në fushën ushtarake, ndër vite ka qenë i



shkëlqyer dhe me tendencë për konsolidim të mëtejshëm", u shpreh ndër të tjera gjenerale brigade Shehu. Nga ana i tij zëvendës atasheu ushtarak i Republikës së Turqisë në Shqipëri, e uroi gjenerale brigade Shehun për marrjen e detyrës së re të Zëvendës shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura shqiptare dhe theksoi me nota pozitive bashkëpunimin e shkëlqyer midis dy vendeve dhe në veçanti ato në fushën e mbrojtjes, ku Forcat e Arma-

tosura turke kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin ndihmë Forcave të Armatosura shqiptare në fusha të ndryshme si, në fushën e edukimit, trajnimit, logjistike, të shëndetësisë dhe në atë të misioneve të përbashkëta në dobi të sigurisë dhe paqes kudo në botë. Në fund të takimit të dy bashkëbiseduesit shprehën bindjen se bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Turqi është i shkëlqyer dhe do të njohë gjithmonë rritje në interes të përbashkët.

GJENERALE SHEHU-KOLONEL TUTUIANU

Bashkëpunimi ushtarak me Rumaninë ka njohur progres

Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerale brigade Manushaqe Shehu, priti në 31 janar një takim kortezie atasheun ushtarak të Republikës së Rumanisë në vendin tonë, kolonel Florin Tutuianu. Pasi i uroi mirëseardhjen në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral Shehu e njohu atë me zhvillimet më të fundit në Forcat e Armatosura shqiptare. Gjenerale Shehu gjatë takimit vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë midis dy vendeve.

"Bashkëpunim ushtarak midis dy vendeve tona është për tu vlerësuar pasi ka njohur progres në fushën e trajnimit dhe edukimit të ushtarakëve shqiptarë në Ru-



mani. Gjithashtu ky bashkëpunim ka konsistuar dhe në stërvitjet e përbashkëta dhe shumëkombëshe si dhe në pjesëmarrjet e përbashkëta në misionet paqeruajtëse në Irak, Afganistan dhe KFOR. Pjesëmarrja e ushtarakëve rumun në Kursin e Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen që zhvillohet pranë Akademisë së FA në Shqipëri, është një tjetër tregues i këtij bashkëpunimi midis vendeve tona", u shpreh ndër të tjera gjeneralë brigade Shehu ushtarakëve rumunë. Atasheu ushtarak rumun, kolonel Tutuianu, shprehu gatishmërinë e Forcave të Armatosura rumune për vijimin dhe rritjen e bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve dhe ofroi mundësinë e pjesëmarrjes gjatë vitit 2019 të trupave tona në stërvitje të përbashkëta, si dhe pjesëmarrjen e personelit ushtarak në kurse të ndryshme trajnimi në Rumania. Të dy bashkëbiseduesit shkëmbyen mendime të përbashkëta për vijimin e projektit "Women's leader in Security and Defense", ku Rumania është lider në këtë projekt dhe që gjenerale Shehu ka qenë pjesëmarrëse në konferencën e 13-të "The Gender Mainstreaming in Security and Defense Leadership- a comprehensive approach", zhvilluar në Bukuresht në qershor 2017. Të dy bashkëbiseduesit shprehën bindjen se bashkëpunimi ushtarak Shqipëri-Rumani do të njohë gjithmonë rritje në interes të përbashkët, duke rithekësuar se ky bashkëpunim është i rëndësishëm, jo vetëm në kuadër të bashkëpunimit dy palësh, por edhe si dy vende anëtare të NATO-s.

Fillon Kursi XI-të i Forcave Speciale

Rreth 50 ushtarakë, efektivë të Forcave dhe reparteve të ndryshme të Forcave të Armatosura filluan ditën e enjte, më 1 shkurt 2018, kursin e XI-të bazë të Forcave Speciale. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në ambientet e batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore (BFSFT) merrnin pjesë: zv/omandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Dedë Prenga, shefi i shtabit të FT kolonel Petrit Çuni, komandanti i batalionit të Forcave Speciale kolonel Ilirjan Dauti, komandanti i Qendrës Stërvitore të FT Kolonel Dritan Stroni, si dhe përfaqësues nga shtabi i Forcës Tokësore.

Aktiviteti u hap nga komandanti i Batalionit të Forcave Speciale, kolonel Ilirjan Dauti. Pasi iu uroi mirëseardhjen të ftuarave në ceremoni kolonel Dauti bëri një përmbledhje të asaj çfarë përfaqëson ky kurs si dhe të sfidave me të cilat pritet të përballen pjesëmarrësit në të. "Të përfundosh këtë kurs, do të thotë të sfidosh aftësitë ekstreme fizike dhe psikike, duke u bërë i aftë të përshkatesh me mjedisin që të rrethon dhe të prevalosh mbi çdo situatë në detyra luftarake, por gjithashtu edhe sfidave të ndryshme, që mund të hasen në jetën e përditshme.

Unë jam besimplotë, se në përfundim të këtij kursi, efektiviteti që do të certifikohet si operator special do të ketë marrë një set tjetër njohurish dhe konceptesh ushtarake dhe një përjasje të re në mënyrën e të planëzuarit dhe të vepruarit." - tha ndër të tjera komandanti i batalionit të Forcave Speciale, kolonel Ilirjan Dauti.

Ceremonia u përshëndet edhe nga zv/komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Dedë Prenga, i cili fillimisht përgëzoi organizatorët e këtij kursi për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve të cilët do të kenë mundësinë që për gati gjashtë muaj, të tregojnë se e meritojnë

Rreth 50 ushtarakë, efektivë të reparteve të FA filluan kursin bazë 6-mujor të Forcave Speciale



beretën e Forcave Speciale. Më tej gjeneral Prenga, kërkoi nga të gjithë kursantët mobilizim disiplinë dhe vendosmëri, për të asimiluar plotësisht programin e këtij kursi të rëndësishëm, jo vetëm për pjesëmarrësit në të, por edhe për instruktorët, drejtuesit e batalionit të Forcave Speciale por edhe më gjerë.

"Kur të ndodheni përballë sfidave dhe vështirësive të kursit, mendoni vetëm një gjë, ju jeni pjesa elitë

dhe më e përzgjedhur e Forcave të Armatosura..." - tha në fjalën e tij gjeneral Prenga. Më tej ai shprehu bindjen e tij personale, se stafi i instruktorëve, me përgatitjen e tyre që vjen nga eksperiencia disavjeçare në këtë repart elitë të Forcës Tokësore do të dijë të përcjellë edhe tek kursantët e këtij kursi që starton, njohuritë më të mira duke bërë që në fund të gjashtë muajve ata do të kenë arritur rezultate të shkëlqyera.



Në ambientet e batalionit "Komando" të Forcës Tokësore, u zhvillua ditën e hënë, datë 5 shkurt 2018, ceremonia e fillimit të kursit të XIII-të "komando." Në këtë aktivitet të thjeshtë, por tepër domethënës, merrnin pjesë: komandant i Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore(QSFT), kolonel Dritan Stroni, zv/komandanti i batalionit të Forcave Speciale n/kolonel Artur Loka, si dhe specialisti i operacioneve në G3/7 FT n/kolonel Behar Mara. Fjalën e hapjes, e mbajti zv/komandanti i batalionit "Komando", major Melsi Hysaj. Ky i fundit pasi falenderoi të pranishmit për prezencën, fillimisht bëri një rezym të asaj çfarë përfaqëson kursi "Komando".

"Ky kurs, është një domosdoshmëri për rritjen e aftësive operacionale dhe profesionale të trupave "komando" si dhe është vazhdimësi e traditës së këtyre trupave... dua të garantoj se batalioni "Komando", do të vazhdojë të trajnojë dhe stërvisë ushtarakë të aftë, për të mundur përmbushjen me sukses të të gjitha detyrave" - tha ndër të tjera në fjalën e tij, major Hysaj.

Ceremonia, u përshëndet gjithashtu edhe nga komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel Dritan Stroni, i cili përgëzoi të gjithë pjesëmarrësit në këtë kurs, duke vlerësuar dëshirën dhe pasionin që ata kanë për tu rritur profesionalisht, duke marrë çdo ditë e më tepër njohuri të reja në profesionin e tyre. Kolonel Stroni, kërkoi nga të gjithë

Kursi i XIII-të 3 muajor "Komando"

Tre muaj për rritjen e aftësive operacionale dhe profesionale të trupave "komando"



pjesëmarrësit në këtë kurs tepër të veçantë për efektivat "Komando", vendosmëri, profesionalizëm dhe disiplinë të lartë, pasi vetëm kështu ata do të mund të kapërcejnë çdo vështirësi, që paraqet kursi i kësaj natyre.

Kursi i XIII-të "komando", do të

vazhdojë për një periudhë tre mujore dhe në të priten të trajtohen tema të luftës në prapavijë të armikut, alpinizëm, goditje objekti, topografi, zbulim etj.

Ervin Hodo
FSK kontribut për Forcat e Armatosura

Kursi "Junior Staff Training Course"

Britanikët trajnojnë Grup-Batalionin e Këmbësorisë së lehtë

Një grup instruktorësh të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar, zhvilluar nga data 12 shkurt deri në 16 shkurt 2018 kursin "Junior Staff Training Course" me oficerët shqiptarë të Grup - Batalionit të Lehtë të Këmbësorisë (GBLK).

Qëllimi i këtij kurs, është pajisja e ushtarakëve shqiptarë me njohuritë bazë në lidhje me Procesin e Planizimit Operacional si dhe me Doktrinën Ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar.

Kursi në fjalë, u zhvillua në mjediset e Forcës Tokësore, me pjesëmarrjen e 31 oficerëve të funksioneve të ndryshme si komandant toge, komandant kompanie, oficer shtabi batalioni nga Forca Tokësore dhe Komanda e Mbështetjes. Ky trajnim, i cili zgjati 4

ditë vlerësohet si tepër i rëndësishëm për të gjithë pjesëmarrësit në të, duke qenë se GBLK në të ardhmen parashikohet të bashkëveprojë ngushtësisht me trupat britanike.



Intervista

Gjeneralbrigade AVDIAJ

Viti 2018 vit sfidash dhe prioritetesh

Intervistë me gjeneralbrigade Vladimir AVDIAJ, Komandant i Forcës Ajrore

“Gjatë vitit 2018 Forca Ajrore do të marrë pjesë në dy stërvitje shumëkombëshe. Stërvitja e parë “Adriatic Strike 2018” do të zhvillohet në Slloveni dhe stërvitja e dytë “Suber Junction 2018” në Gjermani”.

Intervistoi: MIMOZA GOLIKJA

Gjeneral Vladimir Avdij, Shtypi Ushtarak ka ndjekur hap pas hapi angazhimin e Forcës Ajrore, dhe jo vetëm, në emergjencën civile të kohëve të fundit, në operacionet humanitare, në stërvitjet brenda dhe jashtë vendit në rreshtimin në krah të partnerëve në NATO etj. Gjithashtu ne e kemi pasqyruar këtë angazhim të Forcës Ajrore, krahas veprimtarisë dinjitoze të Forcave tona të Armatosura. Nisur nga Direktiva e Mbrojtjes 2018, pyetja e parë që dua t’ju drejtoj është në lidhje me objektivat dhe synimet për vitin 2018. Cilat janë ato?

Forca Ajrore me kapacitetet e saj vazhdon të përmbushë misionin e saj kushtetues në mbrojtjen e sovranitetit të hapësirës ajrore, në bashkëpunim me NATO-n, mbështetjen e Forcave të Armatosura me transport ajror, përbalimin e emergjencave civile dhe dhënien e ndihmës në mbështetjen e autoriteteve civile me transport mjekësor dhe në bështetje të Policisë së Shtetit.

Angazhimi i deritanishëm i aseteve të Forcës Ajrore në stërvitjet brenda dhe jashtë vendit, marrja pjesë në operacionet humanitare në ndihmë të komunitetit kanë mundësuar një pr-



ezantim dinjitoz të tyre dhe janë një bazë e fortë për përmbushjen me cilësi të paketës së Objektivave të Kapaciteteve për vitin 2018.

Viti 2018 është një vit sfidash dhe prioritetesh për Forcën Ajrore. Primare për vitin 2018 do të jetë rritja e niveleve cilësore operacionale, duke synuar shndërrimin e tyre në një forcë, të mirëmotivuar, të mirëstërvitur dhe të mirëpajisur, të aftë për të realizuar operacione/stërvitje të një spektri të gjerë "joint" dhe "combined", fokusuar në Direktivën e Mbrojtjes-2018 dhe në moton: Mission First, e cila kërkon para se gjithash rritjen e nivelit të përgatitjes dhe gatishmërisë operacionale nga të gjithë repartet operacionale të Forcës Ajrore.

Me qëllim realizimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike, puna e strukturave të Forcës Ajrore do të përqëndrohet në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të NATO-s, detyrimet kushtetuese, rritja e kapaciteteve ushtarake dhe profesionalizmit të tyre, si dhe rritja e kontributit tonë në komunitet. Gjithashtu rëndësi e veçantë do t'i kushtohet përmbushjes së objektivave strategjike, të cilët synojnë rritjen graduale të kapaciteteve ushtarake, bazuar në standardet e NATO-s, duke realizuar kërkesat operacionale për të marrë pjesë në misionet e mbrojtjes kolektive dhe ato paqeruajtëse të drejtuara nga Aleanca.

Gjatë vitit 2018, synojmë rritjen e kapaciteteve operacionale për vëzhgimin, monitorimin në mënyrë të pandërprerë të hapësirës ajrore të Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me NATO-n, nëpërmjet realizimit të fazës së parë të projektit të modernizimit të Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore, duke realizuar një kontroll të sigurtë të mjeteve tona ajrore kombëtare, rritjen e sigurisë së fluturimit, lidhjen me Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Raketore të NATO-s, si dhe me sistemin e menaxhimit të trafikut ajror civil të vendit tonë.

Zoti Avdiaj, ju përmendët objektivat dhe e cilësuar vitin 2018 një vit sfidash dhe prioritetesh

për Forcën Ajrore dhe theksuat prioritet kryesor kapacitetet ushtarake dhe profesionalizmin e tyre. Mund të na thoni diçka rreth helikopterëve COUGAR dhe përgatitjes së tyre, çfarë hapash jeni duke ndërmarë në lidhje me ta, për të marrë pjesë në operacione të drejtuara na NATO?

Përgatitja, kompletimi dhe çertifikimi nga strukturat e NATO-s i dy helikopterëve AS 532 AL "Cougar", për të rritur kapacitetet operacionale dhe ndërveprueshmërinë, me



qëllim pjesëmarrjen në misione dhe stërvitje të përbashkëta, si brenda dhe jashtë vendit (në kuadër të NATO/BE), ka filluar tashmë dhe vijon puna në praktikë për arritjen e kapaciteteve të nevojshme me qëllim pjesëmarrjen në stërvitje/operacione me NATO-n në fillim të vitit 2019. Si objektivi mbetet përmbushja e Kërkesave Operacionale për pajisjen e helikopterëve COUGAR dhe ekuipazheve fluturuese me të gjithë elementët e domosdoshëm për të operuar në kushte ekstreme meteorologjike, natën dhe ditën. Realizimi i këtyre kërkesave do të bëjë rritjen e operacionalitetit të helikopterëve të Gjeneratës së IV, me qëllim pjesëmarrjen me dinjitet, në misionet jashtë vendit në kuadër të NATO-s dhe detyrimeve që kemi ne në këtë aleancë.

Zoti gjeneral, përgatitja dhe pjesëmarrja në stërvitjet ndërkombëtare, mbështetja e stërvitjeve të strukturave tona të FA, stërvitjet e kërkim-shpëtimit me pjesëmarrje të strukturave të tjera civile dhe ushtarake është

gjithçka që përmbledh konceptin e stërvitjes ajrore. Si do të jetë ajo për këtë vit?

Stërvitja ajrore do të vijojë të jetë prioritet dhe si qëllim do të ketë ruajtjen dhe aftësimin e ekuipazheve fluturuese për kryerjen e operacioneve në kushte të pamjes së kufizuar dhe në kushte ekstreme të motit. Në fokus të stërvitjeve ajrore do të jetë përgatitja dhe pjesëmarrja në stërvitjet ndërkombëtare, mbështetja e stërvitjeve të strukturave të FARSH-s, si dhe

organizimi i një stërvitje kërkim-shpëtimit me pjesëmarrje jo vetëm të strukturave të Forcës Ajrore, por edhe të strukturave të tjera civile dhe ushtarake.

Koncepti i stërvitjes ajrore, si dhe i të gjithë elementëve të tjerë të saj, gjatë vitit 2018 do të fokusohet për të siguruar personel dhe mjete ajrore (helikopterë) të gatshme për tu dislokuar në një zonë operacioni të drejtuar nga NATO, me qëllim që t'i shërbejë trajnimit të ekuipazheve fluturuese dhe elementëve të komandim-kontrollit gjatë pjesëmarrjes në stërvitjet jashtë vendit tonë si "Saber Junction 18" dhe "Adriatic Strike 18".

Ekuipazhet tona fluturuese trajnohen me qëllim pjesëmarrjen në stërvitje të drejtuara nga strukturat e NATO-s dhe aleatët, si "Adriatic Strike 18", "Saber Junction 18", "Albanian Lion 18", SAR etj, si dhe për të marrë pjesë në mbështetje të operacioneve brenda vendit për përballimin e emergjencave civile në kushte specifike të motit në ndihmë të autoriteteve lokale, stërvitje ajrore

sipas versioneve të përdorimit të helikopterëve, SAR, MEDEVAC, Transport Trupash, VIP, ambulancë ajrore, apo edhe në mbështetje të Policisë së Shtetit.

Risi për vitin 2018 është se ekuipazhet fluturuese do të trajnohen dhe aftësohen për të kryer fluturime me pesha të varura Bampy Bucket (kovat që do të shërbejnë për fikjen e zjarreve).

Programi i stërvitjes ajrore ka filluar që në fillim të vitit dhe ai zhvillohet në përputhje me misionin dhe detyrat e Forcës Ajrore, ku synojmë të standardizojmë dhe konsolidojmë stërvitjen individuale dhe kolektive të ekuipazheve fluturuese. Në planet e arsimimit dhe stërvitjes për 2018 është marrë parasysh edhe njohja, përditësimi dhe zbatimi i doktrinave nga të gjitha strukturat e Forcës Ajrore, intensifikimin e procesit të standardizimit të STANAG që mbështesin Objektivat e Kapaciteteve dhe prioritetet e Forcave të Armatosura.

Për vitin 2018 do të punojmë seriozisht për mbajtjen në gatishmëri të mjeteve ajrore me qëllim pjesëmarrjen në operacione të ndryshme ajrore në përmbushje të detyrimeve tona për përballimin e Emergjencave Civile dhe ndihmën ndaj komunitetit.

Vëmendje do t'i kushtojmë edhe stërvitjes dhe kryerjes së programeve të kalimit të pilotëve për të fluturuar nga një tip helikopteri në tjetrin, kjo për të rritur operacionalitetin dhe gatishmërinë



e ekuipazheve fluturuese.

Tashmë Forca Ajrore, e ka krijuar eksperiencën e saj me pjesëmarrje në stërvitje shumëkombëshe krahas Forcave të NATO-s, kam parasysh këtu pjesëmarrjen në dy stërvitje ndërkombëtare vitin e kaluar. Do të jetë forca juaj këtë vit pjesëmarrëse në stërvitje të tilla shumëkombëshe?

Sigurisht. Siç u shpreha edhe më sipër, gjatë vitit 2018 Forca Ajrore do të marrë pjesë në dy stërvitje shumëkombëshe. Stërvitja e parë "Adriatic Strike 2018" do të zhvillohet në Slloveni dhe stërvitja e dytë "Suber Junction 2018" në Gjermani.

Eksperiencia e fituar vitin e kaluar nga pjesëmarrja në stërvitjet "Saber Junction 17" dhe

"Combined Resolve-8", të zhvilluara në Gjermani, si në procesin e planëzimit ashtu dhe në atë të ekzekutimit duhet të shërbejë në rritjen e mëtejshme të aftësive taktiko-operacionale dhe ndërvepruese për realizimin e objektivit të Forcës Ajrore për marrjen pjesë me dy helikopterë, në operacione të drejtuar nga NATO, pas vitit 2019.

Stërvitjet e përbashkëta me strukturat e tjera të Forcave të Armatosura, kanë treguan se strukturat tona ajrore bashkëveprojnë me profesionalizëm të lartë, duke zbatuar procedurat standarde të operimit, koordinimit, komunikimit, bashkëpunimit dhe ndërveprueshmërisë.

Procesi i modernizimit të Bazës Ajrore Farkë ka bërë që personeli të përballlet me kërkesa të shumta



në drejtim të zotërimit të njohurive e aftësive të domosdoshme për njohjen e përdorimin e procedurave standarde të operimit sipas STAN-AG-ëve të implementuar.

Pjesëmarrja e Forcës Ajrore në stërvitjet shumëkombëshe që përmendëm më lart, do të shërbejë për aftësimin dhe shkëmbimin e experiencës ndërmjet vendeve të Aleancës, rritjen profesionale të ekuipazheve tona fluturuese, përbalimin e ngarkesës së stërvitjes në kushte pothuajse reale.

Këto stërvitje janë në funksion të përbushjes së detyrimeve tona që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO dhe kontribuojnë në rritjen e ndërveprueshmërisë, zbatimit të procedurave standarde, përmirësimin e zhvillimit të kapaciteteve dhe aftësive operacionale në kryerjen e operacioneve luftarake në një mjedis të përbashkët dhe shumëkombësh.

Nisur edhe nga pjesëmarrja në dy stërvitjet e zhvilluara në Gjermani në vitin 2017, po punojmë për eliminimin e mangësive të hasura dhe po marrim masat e nevojshme për një pjesëmarrje sa më dinjitoze gjatë 2018.

Zoti gjeneral, vitet e fundit efektivët e Forcës Ajrore i kemi parë të japin shembuj të vërtetë heroizmi në emergjencat civile, po gjithashtu kemi parë se po ndeshemi shpesh e më shpesh me pjesëmarrjen në operacionet SAR nga ana e efektivave të Forcës Ajrore. Ç'është ky shërbim dhe si realizohet nga ana juaj?

Rastet e Emergjencave Civile janë një ndër fenomenet e shpesh-ta që po has vendi ynë këto vitet e fundit. Nisur nga kjo, edhe gatishmëria dhe operacionaliteti në instancat përkatëse të këtij shërbimi janë rritur. Një hallkë e rëndësishme në gjithë zinxhirin e komandim-drejtimit dhe realizimit të këtyre misioneve është edhe Forca Ajrore. Kjo forcë me strukturat dhe repartet e saj është përpjekur me gjithë mundësitë për të realizuar në kohë dhe më së miri misionin e saj.

Pjesëmarrja në misione të tilla

GJENERAL AVDIAJ-KOLONEL CORNACCHIA

Forca Ajrore kërkon mbështetje nga italianët

Atasheu ushtarak italian kolonel Fabio Cornacchia zhvilloi më 8 shkurt, një takim pune me komandantin e Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi fushat e bashkëpunimit dypalësh për vitin 2018. Gjeneral brigade Vladimir Avdiaj e njohu atasheun ushtarak italian me nevojat e Forcës Ajrore për pjesë këmbimi për teknikën ajrore, trajnimin e personelit, pilot/teknik dhe kontrollor ajror. Atasheu ushtarak italian kolonel Fabio Cornacchia, shprehu angazhimin dhe gatishmërinë për vazhdimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy vendeve.



janë të shumta. Nisur nga këto fenomene, kushtet atmosferike por edhe terreni që ofron Shqipëria, Forca Ajrore disponon helikopterët modernë dhe shumë funksionalë COUGAR dhe EC-145, të cilët plotësojnë kapacitetet e nevojshme operacionale për pjesëmarrjen në operacione të tilla.

Menjëherë pas marrjes së urdhërit për një mision SAR specialistët e Forcës Ajrore analizojnë faktorët që ndikojnë në realizimin me sukses dhe pa premisa për ngjarje të jashtëzakonshme, siç janë: faktorët meteorologjikë, zona e kërkimit, tipologjia e misionit etj.

Operacionet e kërkim-shpëtimit SAR që nga fillimi i saj e deri në përfundim karakterizohen nga një koordinim dhe bashkëveprim i situatës dhe veprimeve midis strukturave të Qendrës së Bashkuar Operacionale (QBO), Qendrës së Komandim Kontrollit të Forcës Ajrore (QKR), Shërbimit Meteorologjik Ushtarak dhe Bazës Ajrore Farkë.

Me qëllim përmirësimin e punës për pjesëmarrjen në operacionet SAR, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura është ngritur dhe funksionon Qendra e Kërkim-Shpëtimit SAR, me të cilën ne kemi kontakte dhe bashkëpunim të vazhdueshëm.

Ne kemi një eksperiencë të mirë nga pjesëmarrja e viteve të fundit në këto operacione, si dhe po punojmë për realizimin e kërkesave operacionale për eliminimin e mangësive që mund të hasen gjatë zhvillimit të operacioneve SAR.

Me qëllim eliminimin e të mangësive dhe diskutimin e problematikave të dala në misionet SAR, sugjeroj organizime takimeve të përbashkëta me të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura që angazhohen në operacionet të tilla. Me anë të këtyre takimeve apo edhe stërvitjeve të përbashkëta synohet improvizimi i dhënies së ndihmës së shpejtë nga ajri sa më shpejt të jetë e mundur pranë

QKR së Forcës Ajrore, pasi reagimi me helikopter mundëson dhënie dhe ndihmës së parë për njerëzit në rrezik shumë më shpejt se çdo lloj tjetër ndërhyrjeje.

Personeli, teknika ajrore, teknika tokësore dhe infrastruktura janë zemra dhe muskujt e Forcës Ajrore në mbështetje për përballimin e Emergjencave Civile. A kanë nevojë ato për zhvillim dhe për përmirësim?

Forca Ajrore është gjithmonë në pararojë të operacioneve të Emergjencave Civile. Siç u shpreha dhe më lart, për shkak të tipologjisë së operacionit, kushteve dhe terrenit që ofron vendi ynë, pjesëmarrja e helikopterëve të Forcës Ajrore në këto lloj operacionesh është vendimtare. Të shumta janë operacionet në rastet e përmytjeve, zonave të blokuara nga dëborat, apo edhe në ndihmë të të plagosurve në rast aksidentësh, apo fatkeqësish natyrore. Tradita vazhdon, dhe ne sërish do të jemi aty.

Ekuipezhet tona fluturuese tashmë janë familjarizuar me operacione të tilla, por gjithmonë ka nevojë për përmirësime dhe rritje profesionalizmi. Këtë vit Forca Ajrore do të rrisë kapacitetet e saj operacionale, duke marrë pjesë edhe në operacionet e fikjes së zjarreve. Kemi siguruar paisjet përkatëse për këtë qëllim dhe jemi në fazën e trajnimit të ekuipezheve ajrore për fluturime në operacione të shuarjes së zjarrit, apo fluturimet me pesha të varura dhe Bumpy Bucket (kovat për fikjen e zjarreve).

Gjeneral Avdiaj, do të donim një përgjigje lidhur me blerjen dhe instalimin e radarit të ri. Në çfarë faze jeni konkretisht tani me zbatimin e këtij projekti dhe si do të jetë operacionaliteti juaj, në çfarë niveli?

Qendra e Kontroll Raportimit përbën strukturën bazë të integritetit në Sistemin e Integruar të Mbrojtjes Ajrore dhe Mbrojtjes Raketore të Aleancës (NATINAMDS). Ajo është një strukturë kyçe në

përbërje të Forcës Ajrore, e cila operon pa ndërprerje gjatë 24 orëve, duke luajtur një rol shumë të rëndësishëm në koordinimin, ekzekutimin dhe komandim kontrollin e operacioneve ajrore të Aleancës, realizimin e Policimit Ajror, shkëmbimin e pamjes ajrore dhe kordinimin e të gjitha aktiviteteve ajrore në operacionet humanitare dhe në operacionet në Emergjencat Civile.

Prioritet për vitin 2018 është kalimi i kësaj qendre nga faza "testing mode" në operacionale të plotë "operational mode". Operacionaliteti është kërkesa kryesore e sistemit të vëzhgimit, pasi është treguesi kryesor i efektivitetit dhe realizimit të misionit të Forcave Ajrore "Për sigurimin e sovranitetit ajror të Republikës së Shqipërisë".

Forca Ajrore do të modernizo-

het me një radar të gjeneratës së fundit, që prodhohet nga kompania prestigjioze "Lockheed Martin" në SHBA. Në kuadër të marrjes së radarit të ri Forca Ajrore ka hartuar një plan të detajuar dhe konkret pasi teknologjia e avancuar dhe operimi i këtij radari kërkojnë masa të mirë studiuar për përgatitjen e personelit shfrytëzues, përgatitjen e terrenit për vendosjen e tij, si dhe gjithë masat e tjera për një operim të suksesshëm.

Instalimi i radarit të ri do të sigurojë mbulimin ajror të territorit të vendit tonë, si dhe do të ofrojë një pamje të situatës ajrore në kohë reale. Ndërtimi i një sistemi modern të vëzhgimit ajror krijon mundësi për të arritur kërkesat operacionale të kontrollit të hapësirës ajrore për realizimin e Policimit Ajror, si dhe për zbulimin e objekteve ajrore edhe në lartësi më të ulëta.



"Ekuipezhet tona fluturuese trajnohen me qëllim pjesëmarrjen në stërvitje të drejtuara nga strukturat e NATO-s dhe aleatët, si "Adriatic Strike 18", "Saber Junction 18", "Albanian Lion 18", SAR etj, si dhe për të marrë pjesë në mbështetje të operacioneve brenda vendit për përballimin e emergjencave civile në kushte specifike të motit në ndihmë të autoriteteve lokale, stërvitje ajrore sipas versioneve të përdorimit të helikopterëve, SAR, MEDEVAC, Transport Trupash, VIP, ambulancë ajrore, apo edhe në mbështetje të Policisë së Shtetit".



Helikopterët Cougar: Stërvitje për misione brenda dhe jashtë vendit

Ky është fluturimi i parë në formacion helikopterësh për vitin 2018, për rritjen e shkallës së gatishmërisë operacionale për realizimin e misionit

Në Bazën Ajrore Farkë, në zbatim të Planit Vjetor të Stërvitjes Ajrore, u zhvilluan më 22 shkurt 2018, fluturimet në formacion helikopterësh, fillimisht me dy dhe më pas me tre helikopterë Cougar.

Fluturimet në formacion helikopterësh zhvillohen si vijimësi e trajnimit të ekuipazheve fluturues, në përmbushje të objektivit të kapacitetit të Forcës Ajrore, me synim kompaktësimin e ekuipazheve fluturuese për fluturime në formacion, si dhe dhënia e eksperiencës së fituar në stërvitjet e përbashkëta, që u zhvilluan vitin e ka-

luar në Gjermani, me qëllim përgatitjen e ekuipazheve fluturues në stërvitjet e përbashkëta që do të zhvillohen brenda dhe jashtë vendit në të ardhmen.

Ky ishte fluturimi i parë në formacion helikopterësh për vitin 2018, i cili kërkon nivel të lartë angazhimi për ekuipazhet ajrore, si dhe përqendrim maksimal për ruajtjen e masave të parrezikshmërisë së fluturimit. Trajnimi i ekuipazheve fluturues do të vazhdojë njëkohësisht dhe me një përgatitje të thelluar teorike me ekuipazhet e tjera, për rritjen e shkallës së gatishmërisë operacionale për realizimin e misionit.



Forca Ajrore

Transporti Mjekësor me helikopter pranë njerëzve në nevojë

Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter si pjesë e strukturave operacionale të Bazës Ajrore Farkë në Forcën Ajrore, është një hallkë e rëndësishme, që bën të mundur transportimin e të sëmurëve nga të gjitha zonat e vendit drejt spitaleve të kryeqytetit apo edhe jashtë tij. Me moton "Të shpëtojmë çdo jetë në rrezik" ka kryer me sukses detyrën e saj në dhënien e ndihmës së parë dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, duke u ndodhur në çdo kohë, në çdo skaj të vendit, në çdo orë të ditës dhe në çdo stinë të vitit, sidomos kjo në kushtet gjeografike dhe klimaterike të vendit tonë.

Gjatë fundjavës që kaloi helikopteri EC-135, kreu katër misione si ambulancë ajrore, mi-

sione të cilat ishin të shpërndara nga veriu në jug të Shqipërisë, përkatësisht në Sarandë, Bajram Curri, Burrel dhe Korçë. Gjatë fundjavës u bë transportimi i dy të plagosurve në dy aksidente në Korçë dhe në Burrel drejt Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë. Gjithashtu u bë transportimi i një personi të sëmurë nga Saranda, si dhe transportimi i një

fëmije të sëmurë nga Bajram Curri, drejt Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë. Njësia e Transportit Mjekësor me Helikopter, do të vazhdojnë të qëndrojnë në gatishmëri për realizimin e misionit, në të gjitha rastet kur do të kërkohet ndërhyrja e tyre.



Trajnim për njësitë detare që veprojnë në det

Në datën 20 dhe 23 shkurt 2018, në mjediset e Repartit Special të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit Delta-Forcë, Radhimë, Vlorë, si dhe në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Durrës, nga specialistët e Forcës Detare, kapiten i rangut të tretë Artan Malo, kapiten i rangut të tretë Ilijan Kristo dhe kapitenlejtënant Enkel Lule u trajnuan efektivë të institucioneve që kanë interes në det për përdorimin e pajisjeve dhe radarëve që disponojnë këto mjete. Qëllimi i këtij aktiviteti është rritja e operacjonalitetit dhe ndërveprueshmërisë së njësive detare për zbatimin e ligjshmërisë në det.

Fillon Kursi i Avancuar i Oficerit të Forcës Ajrore (KAO)

Në Qendrën Stërvitore të Forcës Ajrore, filloi të hën më 19 shkurt 2018, Kursi i Avancuar i Oficerit të Forcës Ajrore (KAO). Për këtë qëllim, në ambientet e Garnizonit të Kuçovës, u zhvillua edhe ceremonia e fillimit të këtij kursi. Në fjalën e hapjes shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore, nënkolonel Adrian Kuli theksoi se: "Fillojmë sot Kursin e Avancuar të Oficerit (KAO) të Forcës Ajrore, një kurs ky institucional që shërben si kusht për marrjen e gradës së "kapitenit". Një falënderim i veçantë shkon për komandantin e Forcës Ajrore gjeneral brigade Vladimir Avdiaj dhe për bashkëpunimin me Bazën Ajrore Kuçovë, të cilat bënë të mundur sigurimin e gjithë infrastrukturës së duhur për krijimin e kushteve normale për jetesë, trajnim dhe stërvitje të personelit kursant të ardhur nga repartet e ndryshme të Forcës Ajrore si dhe nga forcat e tjera."

Në përfundim duke iu uruar suksese nënkolonel Kuli kërkoi nga kursantët: disiplinë, angazhim serioz, mobilizim dhe përkushtim gjatë gjithë periudhës së kursit, me qëllim asimilimin dhe përvetësimin e plotë të programit mësimor dhe stërvitor të këtij kursi si dhe arritjen e rezultateve sa më të larta në përfundim të tij. Kursi i Avancuar i Oficerit të Forcës Ajrore (KAO), zhvillohet



në 12 javë mësimore dhe në total përfshin 360 orë mësimore. Kurrikulum i këtij kursi synon përgatitjen e kursantëve me njohuri të plota teorike dhe shprehite praktike për: konceptet bazë të udhëheqjes ushtarake të lidershipit taktik; thellimin e njohurive në fushën e artit taktik dhe menaxhimin e stërvitjes; përgatitjen e tyre si lider i ardhshëm në drejtimin e strukturave të ulta në Forcën Ajrore; dhënien e njohurive të reja tekniko - profesionale, organizative e metodike në rol të

komandantit të këtyre strukturave; thellimin e njohurive për artin taktik, mbi vendin dhe rolin e nënrepartit në përbërje të repartit në operacionet e ndryshme luftarake, paqeruajtëse e humanitare. Ky kurs zhvillon aftësitë organizuese, drejtuese dhe analizuese nëpërmjet zhvillimit praktik dhe metodik të mësimave; përgatitjes pjesëmarrësit për drejtimin e nënrepartit në gjithë aktivitetin e tij; jep njohuritë më të domosdoshme në zgjidhjen e detyrave operacionale të repartit.

Çertifikata mirënjohjeje për fituesit e (CISM 2018)

Në "Ditën e Ndërkombëtare të Sporteve (CISM 2018)", i cili u zhvillua në datën 12 shkurt në kodrat e Liqenit Artificial, në Tiranë, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes u përfaqësua nga studentët e Kursit të Arsimimit të Përgjithshëm të Oficerëve (KAPO). Gara u zhvillua në dy disiplina, 10 km për vrapuesit djem dhe 6 km për vrapueset vajza. Në kategorinë e vajzave, vendin e parë e zuri kadete Xhuliana Tahillari nga Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes. Komandanti i KDS gjeneral brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj në shenjë mirënjohjeje për fitueset e garës organizoi një ceremoni të thjeshtë për tu shpërndarë çertifikata mirënjohjeje 5 vajzave, të cilat zunë vendet e para. Komandanti i KDS gjeneral brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj pasi uroi fitueset dhe i përgëzoi për garën, u shpreh ndër të tjera se: "Përgatitja serioze fizike, pjesëmarrja në garë, është një fillim i mbarë për



karrierën ushtarake, me punë dhe vullnet shpresojmë të arrini dhe realizoni objektivat tuaja. Ne do të jemi gjithmonë mbështetja juaj".

Në auditorin e Ministrisë së Mbrojtjes, Komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani mbajti një leksion njohës mbi Forcën Tokësore për studentët e Akademisë së Forcave të Armatosura. Të pranishëm ishin shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, komandanti i KDS gjeneral brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj, stafi pedagogjik dhe gjithë kursantët e kurseve në AFA. Misioni i FT, infrastruktura, armatimi, personeli, arsimimi, stërvitja, operacionet dhe sfidat që e presin Forcën Tokësore ishin çështjet kryesore të trajtuara në leksion. Gjithashtu, gjeneral Cahani, risolli edhe njëherë në vëmendje rëndësinë dhe angazhimin që ka Komanda

Leksion mbi Forcën Tokësore për studentët e AFA



e Forcës Tokësore për përgatitjen serioze të efektivëve ushtarakë për përfaqësimin dinjitoz pranë forcave aleate në misionet jashtë vendit, Afganistan, Irak, Kosovë, etj. Gjatë leksionit nga auditori u ngritën një sërë pyetjesh dhe diskutimesh në lidhje me Forcën Tokësore. Në përfundim të leksionit Komandanti i KDS gjeneral brigade Prof. Asoc. Bajram Begaj në shenjë falenderimi i dorëzoi gjeneral Cahanit certifikatë mirënjohje.

KURSI I AVANCUAR I OFICERIT

Komanda Mbështetëse: 43 kursantë nga strukturat e FA

Në mjediset e Qendrës Stërvitore (QS) të Komandës Mbështetëse u zhvillua të hënën, më 19 shkurt, ceremonia e fillimit të kursit KAO në specialitet Furnizim, Transport-Mirëmbajtje, Armatim-Municion dhe Xhenio. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin komandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Gasper Lala, komandanti i QS kolonel Besnik Sylaj, si dhe komandantët e strukturave vartëse të KM. Në fjalën e hapjes komandanti i QS kolonel Sylaj, pasi falënderoi komandantin e KM dhe komandantët e strukturave vartëse të KM për pjesëmarrjen në këtë ceremoni u shpreh: "Sot kam kënaqësinë e veçantë t'ju uroj në këtë ceremoni, një fillim të mbarë të Kursit të Avancuar të Oficerit. Ky kurs institucional synon formimin profesional të oficerëve të Forcave të Armatosura me qëllim dhënien e njohurive tekniko - profesionale, organizative, metodike dhe aftësimin në rol të drejtuesit të ardhshëm të nënrepartëve në FA. Në këtë kuadër, dëshiroj të inkurajoj edhe personelin mësimdhënës të Qendrës Stërvitore, që të angazhohen dhe përkushtohen për të mundur arritjen e rezultateve dhe realizimin e objektivave, nëpërmjet mësimëve

teorike në klasa dhe stërvitjeve praktike në terren dhe në reparte sipas specialiteteve."

Komandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gasper Lala në fjalën e tij përshëndetëse uroi të gjithë kursantët e KAO për fillimin e këtij kursi kaq të rëndësishëm. Jam i bindur që me fillimin e këtij kursi ju do të aftësoheni profesionalisht në rol të drejtuesit të ardhshëm të nënrepartëve në FA. Kursi që ne hapim sot në QS është mjaft domethënës sepse arrin të përmbushë filozofinë tonë të arsimimit dhe stërvitjes, i cili synon rritjen e shkallës së profesionalizmit të ushtarakëve, që shërbejnë në strukturën e Komandës Mbështetëse dhe ato që shërbejnë në strukturat e tjera të FA, - u shpreh kolonel Lala. Në këtë kurs marrin pjesë rreth 43 kursantë nga të gjitha strukturat e FA. Ky kurs përfundon më datë 11 maj 2018.



Anija amerikane "Ross" në Gjirin e Vlorës

"Iliria" dhe "USSRoss" në stërvitje të përbashkët

NGA SHEFQET KËRCELLI

Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak midis Shqipërisë dhe SHBA, ka mbërritur në javën e parë të shkurtit në Portin e Vlorës anija ushtarake amerikane "Ross", e cila zhvilloi një vizitë portuale tre ditore dhe një stërvitje të përbashkët të planifikuar më parë me anije të Flotës sonë Detare. Kjo vizitë portuale i shërben forcimit të marrëdhënieve tashmë jetëgjatë midis dy vendeve tona dhe për t'u lejuar marinarëve mundësinë të përjetojnë mikpritjen e Vlorës dhe kulturën e pasur të Shqipërisë.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast në anije, ishin të pranishëm zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, ambasadori i SHBA, në Tiranë, z. Donald Lu, gjeneralë, drejtorë drejtorish në SHP, si dhe autoritete të qeverisë vendore.

Ambasadori Lu tha se të gjithë duhet të kuptojnë rëndësinë që ka ushtria në funksionet demokratike të çdo shoqërie: "Një nga misionet tona është të ndihmojmë të rinjtë shqiptarë të respektojnë profesionin e ushtarakut. Të gjithë, pavarësisht moshës duhet të kuptojmë rolin e ushtrisë në mbrojtjen e shoqërisë së lirë në mbarë botën".

Lajmi është publikuar edhe nga ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka,

e cila ka publikuar në rrjetin social facebook, disa fotografi nga momentet e zhvillimit të operacionit. Në statusin e saj ministrja Xhaçka shkruan, "Ndërkohë që kolegët e tyre të anijes "Butrinti" patrullojnë në detin Egje, ekuipazhi i anijes "Iliria" në Adriatik ka qenë pjesë e një stërvitjeje të përbashkët luftimi në det me shkatërruesin e marinës së SHBA, "USSRoss", përfundon ministrja. Kjo nuk është stërvitja e parë mes forcave ushtarake shqiptare dhe atyre amerikane, pasi të dyja vendet janë pjesë e Aleancës së Traktatit të Atlantikut Verior.

Konkretisht më datën 7 shkurt 2018, anija flamurtare e Forcës Detare shqiptare, "Iliria", (P-131), zhvilloi stërvitjen e përbashkët me anijen e Flotës së 6-të të SHBA, destrojeren me raketa, të klasit Arleigh Burke, USS RossDDG-71, në detin

Adriatik. Destojeri amerikan DDG-7, është në përbërje të Flotës së 6-të të SHBA, me vendbazim në Rota të Spanjës. Anija mbështet operacionet e aleatëve të NATO-s dhe mbron interesat kombëtare të SHBA në Evropë. Gjatë kësaj stërvitjeje anija jonë "Iliria" kishte për qëllim të zbulonte, identifikonte dhe siguronte anijen e NATO-s, detyrë të cilën e realizoi me efikasitet e profesionalizëm. Në përfundim të stërvitjes së përbashkët midis dy anijeve mike, Commander Bryan S. Gallo, Drejtues, Komandant i grupit të lëshimit të raketave të USS Ross (DDG 71) dhe Lt. Ryan Sisler, Oficeri ekzekutiv i DDG-71, Ross, përshëndetën ekuipazhin e anijes sonë "Iliria", si detarë dhe si miq, ashtu sic dinë të përshëndetin detarët. Fotografia e realizuar me mjeshtëri nga fotoreporteri i Flotës së 6-të të SHBA, Kyle Steckler,





Misione ndërkombëtare

Stërvitje me nënrepartet e grup-batalionit eFP në Letoni

Toga EOD e FARSH në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar në Letoni (NATO eFP BG)

Sipas njoftimit zyrtar të Komandës Mbështetëse të Forcave të Armatosura të datës 20 shkurt 2018, Toga EOD e FARSH në misionin e Prezencës së Përparuar të Përforcuar në Letoni (NATO eFP BG), vijon misionin duke u stërvitur me gjithë nënrepartet e grup-batalionit eFP në Letoni.

Gjatë kësaj faze, kjo togë është nënreparti përgjegjës për trajnimin e nënreparteve të tjera për asgjësimin e municioneve të paplasura (UXO), si dhe në luftën ndaj pajisjeve eksplozive të improvizuara (C-IED). Ky trajnim demonstrues u zhvillua në kuadër të stërvitjes Claymore Prime, sipas së cilit gjithë grup-batalioni është duke u stërvitur që me fillimin e këtij misioni.

Në kuadër të integritimit të nënreparteve të manovrës në grup-batalion, në lidhje me luftën ndaj pajisjeve eksplozive të improvizuara, personeli i togës EOD po trajnon të gjithë nënrepartet e manovrës së grup-batalionit si kompaninë polake të tankeve "Scorpions", kompaninë italiane të mekanizuar "Ardita", kompaninë e mekanizuar kanadeze "India" (LAV 6.0 Coy), kompaninë e mekanizuar spanjolle "Leon", baterinë kanadeze si dhe togën sllovene të kimisë (CBRN). Kjo është faza e fundit e trajnimit përpara se grup-batalioni të dalë në fushim për certifikim. Komandanti i kontigjentit, major Eduart Kaloshi shprehet se i gjithë efektivi i togës ka qenë i përgatitur dhe i motivuar për të realizuar me sukses këtë stërvitje. "Tek efektivi shikoj një ndjenjë të fortë besimi dhe sigurie që ata kanë në vetvete. Të gjithë janë të angazhuar për realizimin me sukses të kësaj stërvitje. Ata ndihen si një trup i vetëm ku secili ka rolin dhe përgjegjësit sipas funksionit organik për ta bërë këtë trup të jetë solid dhe i pandashëm", - u shpreh major Kaloshi. Gjithashtu për realizimin e kësaj detyre është dashur një përgatitje profesionale, është kryer rikonjicioni në terren, koordinimi me nënrepartet e tjera deri në provën paraprake. Procedurat operacionale të zbatuara, eksperiencia dhe pajisjet moderne bënë që ekipi EOD i FARSH në këtë trajnim të bënte një paraqitje të shkëlqyer, e cila u vlerësua maksimalisht nga të gjithë pjesëmarrësit.

shpreh realizëm, dashuri detarësh dhe profesionalizëm në stërvitje të këtij lloji. Sigurisht, stërvitje të tilla të përbashkëta midis Flotës së SHBA dhe Forcës Detare, ne kemi disa vite që i realizojmë me sukses në detin Jon dhe Adriatik.

E pata ëndëruar këtë fotografi me stërvitje detarësh që në korrik të vitit 1986, kur kryqëzorët amerikanë lundronin për në Split dhe Kroaci për vizitë portuale dhe furnizim. Ndërsa ne i ndiqnim me syrin e radarëve, grykat e topave dhe silurat e anijeve. Një kakofoni që u vërtetua mbas rënies së murit të Berlinit. Sot, më gëzon ky fakt, që një fotografi e tillë, traditë e përshëndetjes së detarëve, e ëndërruar para 40 vitesh u bë realitet. Faleminderit kolegëve tanë të Flotës së 6-të të SHBA, me të cilët ne tashmë jemi lidhur ngushtë e pazgjithshmërisht, ashtu si një nyje e fortë marinarësh.

Anija ka qëndruar tre ditë në Portin e Vlorës, në kuadrin e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve ushtarake dypalëshe. Anija "Ross" kishte në bord një ekuipazh prej 350 vetë dhe ka qenë pjesë e dhjetëra operacioneve ushtarake, më e fundit atyre në Siri. Pas Shqipërisë, anija i është drejtuar Spanjës dhe më pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Këto lloj vizitash demonstrojnë përkushtimin tonë ndaj stabilitetit në rajonal dhe sigurisë detare në këtë rajon jetësor të botës.

Shënim: Lajmi për këtë stërvitje është përcjellë dhe tek faqja zyrtare e Flotës së 6-të të SHBA.

USHTRIA TURKE:

5 automjete për Flotiljen Detare të Pashalimanit

Në Flotiljen Detare të Pashalimanit, u zhvillua më 9 shkurt, ceremonia e marrjes në dorëzim të 5 automjeteve për transport mallrash dhe trupash, dhuratë e Ushtrisë Turke. Në ceremoninë e marrjes në dorëzim të këtyre automjeteve morën pjesë Komandanti i Forcës Detare, gjeneralmajor Ylber Dogjani, zv/atasheu ushtarak i Republikës së Turqisë në vendin tonë, kapiten Adem Tursoi, Komandanti i Njësisë Logjistike turke në Bazën e Pashalimanit, kapiten i rangut të I-të Ertan Engerek, drejtues të Flotiljes Detare Pashaliman, kadro dhe detarë të Flotiljes, etj.

Fillimisht të pranishmit i përshëndeti komandanti i Forcës Detare, Gjeneral Major Ylber Dogjani, i cili mbasi falënderoi ushtarakët turq për dhurimin e 5 automjeteve, evidentoi

bashkëpunimin shumë vjeçar midis flotës turke dhe asaj shqiptare, e cila ka qenë kryesisht në fushën e arësimimit ushtarak, në dhurimin e ndihmave logjistike dhe infrastrukturore, vizitat e anijeve turke në portet tona, vizitat e delegacioneve të niveleve të ndryshme dhe zhvillimi i stërvitjeve të përbashkëta në kuadër të NATO-s. Nga ana e tij, kapiten i rangut të II-të Erton Engerek, shprehu falënderim për pritjen e organizuar nga pala shqiptare dhe bashkëpunimin e deritanishëm midis dy flotave, duke theksuar vijimësinë e këtij bashkëpunimi në fusha me interes reciprok, si dhe gatishmërinë e palës turke për të ndihmuar Forcën Detare shqiptare. Mjetet e dhuruara nga pala turke do jenë në përdorim të Flotiljes Detare Pashaliman

PAS 3 ORË ECJE NË KËMBË


FA shpëtojnë nënën e sëmurë të dy fëmijëve

Dita e martë, e datës 27 shkurt ka qënë e vështirë për Brigadën e Mbështetjes Rajonale të Kukësit, pjesë e strukturave të Forcave të Armatosura. Por jeta e njeriut është më e shtrejtë së çdo gjë. Pas 3 orë ecjeje në këmbë, Forcat Armatosura kanë arritur të transportojnë për në spitalin rajonal të Kukësit një 38-vjeçare, e cila ishte e bllokuar në shtëpinë e saj në fshatin Tejdrinë të njësisë administrative Ujmisht në bashkinë e Kukësit, në gjendje të rëndë shëndetësore.

Trëndafille Miçi, nënë e dy fëmijëve, paraqitej me temperaturë të lartë trupore, 40 gradë dhe e kishte të pamundur të transportohej për në spital për shkak të bllokimit të rrugës nga bora. Menjëherë pas marrjes së njoftimit, efektivet e Brigadës së Mbështetjes Rajonale të Kukësit dhe një mjet i rëndë, u nisën drejt fshatit Tejdrinë. Për shkak të trashësisë së borës, ushtarakëve iu desh të ecnin edhe për rreth 1 orë e gjysmë në këmbë deri në shtëpinë e të sëmurës. Pas marrjes së 38-vjeçares, efektivet e transportuan me barelë deri te mjeti i rëndë, për ta dërguar më pas në spitalin e Kukësit, nën kujdesin e mjekëve.

Kryeministri Edi Rama në një postim në rrjetin e tij social "Facebook" ka përshëndetur punën e ushtarëve të Forcave të Armatosura, të cilët pas 3 orësh ecjeje në këmbë kanë shpëtuar nënën e





Trëndafle Miçi, nënë e dy fëmijëve, paraqitet me temperaturë të lartë trupore, 40 gradë dhe e kishte të pamundur të transportohej për në spital për shkak të bllokimit të rrugës nga bora. Menjëherë pas marrjes së njoftimit, efektivët e Brigadës së Mbështetjes Rajonale të Kukësit dhe një mjet i rëndë, u nisën drejt fshatit Tejdrinë.

Efektivë të FA të Brigadës së Mbështetjes Rajonale të Kukësit gajtë transportit për në spitalin rajonal të Kukësit të një 38-vjeçareje



sëmurë të dy fëmijëve në fshatin Tejdrinë të Kukësit. "HERONJTË E DITËS-Pas 3 orësh ecje në këmbë, FA shpëtojnë nënën e sëmurë të dy fëmijëve në fshatin Tejdrinë të Kukësit". "I falenderoj shumë për ndihmën që na kanë dhënë," shprehhet Trëndafle Miçi. Mark Nufi ishte mjeku roje që e priti dhe që e ka ndjekur gjëndjen e saj shendetësore. Ai tha se pacientja tani është jashtë çdo rreziku. "Është jashtë çdo lloj rreziku. Është shumë mirë. Diagnoza e saj është helmim ushqimor. Ajo mund të rri edhe tre ditë. Nuk ka pse të rrijë më," thotë ai.

Në lidhje me këtë operacion ka folur edhe majori i FA Kastriot Imëraj. "Në një kohë rekord u nisën forcat dhe mjetet për transportimin e të sëmurës nga fshati Ymisht në drejtim të Kukësit," ka thënë ai. "Rruga ishte një terren tepër i vështirë. Pasi shkua në fshatin Tejdrinë nuk kalohej më me mjete transporti. Organizova efektivin me barrelë për të tërhequr të sëmurën për ta sjellë në Kukës," thotë Mirton Kerxhalliu, kapiten i FA. Fshati Tejdrinë është pjesë e njësisë administrative Ujmisht, njësi në të cilën bëjnë pjesë edhe 6 fshatra të tjerë si: Lusën, Resk, Malqene, Ujmisht, Zall-Lusën dhe Skavicë të cilat shtrihen në Jug-Perëndim të rrethit të Kukësit në të dy anët Luginës së Drinit të Zi. Kjo zone apo ky vend banim dëshmohet si vendbanim që nga shek. III-IV pas Krishtit, ku ka luajtur një rol të rëndësishëm në ngjarjet historike. Ujmishti përmendet si pronë e Kastriotëve e më pas e Dukagjinasve. Duhej të vinte viti 1529 që Ujmishti të përmendej në kadastrat osmane.

INTERVISTA

KFOR-i ishte misioni i parë për mua dhe përvoja më e mirë e punës, nisur nga çdo këndvështrim. Me bindje e them, që jam ndjerë e privilegjuar dhe me fat që m'u krijua mundësia për të qenë në vazhdimësi pjesë e kontributit që femrat ushtarake shqiptare japin në misione, me qëllim lënien gjurmë nëpërmjet prezencës tonë.



Eshtë privilegj të lësh gjurmë në misionet e FA

Intervistë me nënkolonele Alda Sula, shefe e Departamentit të Doktrinës dhe Publikimeve Doktrinare në Qendrën e Doktrinës dhe Kërkimit, në KDS, për shtypin ushtarak

Intervistoi: Mimoza GOLIKJA

Nënkolonele Alda Sula, mirë se erdhët në faqet e shtypit ushtarak. Ju jeni një emër i njohur për redaksinë tonë dhe jo vetëm për shkak të bashkëpunimit të hershëm që keni pasur me gazetën "Ushtria" dhe revistën "Mbrotja", si autore e një numër shkrimesh. Sot dëshirojmë t'ju kemi përsëri në faqet e shtypit tonë, por, këtë herë, në rolin e të intervistuarës. Ka pak kohë që jeni kthyer nga misioni i NATO-s, KFOR në Kosovë, ku ishit prej një periudhë gjashtë mujore si Shefe e

Shtabit e Grupimit të Mbështetjes Logjistike të Përbashkët të KFOR-it, si dhe Përfaqësuese e Lartë Ushtarake Shqiptare. Ky ishte për ju misioni i parë?

Së pari, meqë m'u dha rasti, më lejoni që të shpreh publikisht konsideratat dhe falenderimet e mia për shtypin ushtarak, për të gjithë stafin, për bashkëpunimin e vazhdueshëm që kemi pasur ndër vite dhe predispozicionin pozitiv e mbështetës ndaj punës sonë të përditshme, në interes të promovimit dhe percjelljes së mesazheve të ndryshme nga aktiviteti i FA. Duke e personalizuar, do të doja të thoja se jam ndjerë mjaft komode nga ky

bashkëpunim, duke përfutur shumë. Për t'u kthyer te pyetja juaj, KFOR-i ishte misioni i parë për mua dhe përvoja më e mirë e punës, nisur nga çdo këndvështrim. Me bindje e them, që jam ndjerë e privilegjuar dhe me fat që m'u krijua mundësia për të qenë në vazhdimësi pjesë e kontributit që femrat ushtarake shqiptare japin në misione, me qëllim lënien gjurmë nëpërmjet prezencës tonë. Këtu nuk dëshiroj të flas për veten, pasi pjesëmarrja në një mision të zhvesh disi nga individualiteti, duke të personalizuar me kombësinë, me forcën e armatosur të një vendi, me gjininë që ti përfaqëson. Përzgjedhja ime në këtë mision, me dy detyra, atë të Shefit të Shtabit të Grupimit të

Mbështetjes Logjistike të Përbashkët të KFOR-it dhe të Përfaqësueses së Lartë Ushtarake Shqiptare, nga ana e lidërshiptit ushtarak e civil, rriti tek unë besueshmërinë dhe njëkohësisht më impenjoi maksimalisht për një përfaqësim sa më dinjitoz e realizim të suksesshëm të misionit. Kjo e ka një arsye, por dhe një përgjigje..... mbështetja maksimale dhe e drejtpërdrejtë që lidërshipti ynë i ka dhënë dhe vazhdon t'u japë femrave ushtarake, duke na bërë të ndjehemi më krenare e të vlerësuar, më të përgjegjshme e kurajoze në përbalimin dhe përmbushjen edhe të këtyre sfidave, siç është angazhimi në mision. FALENDERIMIT i shtohet dhe PREMTIMI për angazhim e impenjim të vazhdueshëm e dinjitoz, në çdo rast e në çdo sfidë që na paraqitet e që do të përballemi. Në njëfarë mënyre, nuk po shkoja në një "rrugë të pashkelur". Një tjetër nënkolonele ka përfaqësuar denjësisht pozicionin më parë, sikundër dhe unë ia dorëzova këtë detyrë po një gruajë të aftë ushtarake. Kjo stafetë, le të çojë në rritjen e imazhit të figurës së femrës së FARSH dhe kontributit të saj në misione, siç është dhe misioni për të cilin ne po flasim.

Si vend anëtar i NATO-s që nga viti 2009, vendi ynë kontribuon në KFOR. Nënkolonele Sula, si erdhi ky mision për ju dhe çfarë nënkupton pozicioni juaj në shtabin e KFOR?

U ndjeva mjaft mirë kur mora njoftimin se së shpejti më duhej të përgatitesha për të shkuar me mision në Kosovë. Ishim një grup i vogël, ndoshta jo si misionet me trupat e kontingjenteve, por përgjegjësitë, detyrat dhe objektivat ishin po aq të rëndësishme, po aq të mëdha ndaj vendit, ndaj uniformës së FARSH dhe NATO-s. Që në fillim, ajo që më shqetësonte ishte ndjenja e përgjegjësisë për detyrën që më priste së bashku me grupin ku bëja pjesë. Tek unë ndikonin shumë faktorë. Së pari, për një ushtarak karriere, lidhur dhe me detyrat e kryera ndër vite, angazhimi në një mision do të ishte tepër sinjifikativ. Së dyti, siç u shpreha dhe në fillim të intervistës, nuk do të shkoja në një rrugë të panjohur. Por, ajo që më mbetej

për të bërë, ishte të shfletoja më shumë rreth KFOR-it, rreth detyrave të mia funksionale, të merrja kontakt me kolegët e mi pararendës për t'u informuar më në detaje mbi përmbushjen e detyrës. Tashmë janë bërë shumë vite që ne japim kontributin tonë edhe në Kosovë dhe përvoja nuk mungon. Ajo që bën diferencën është fakti se si i mirëpresim personalisht angazhimet që na jepen. Kjo i takon pjesës së paradisllokimit. Prezantimi i panoramës së aktivitetit në KFOR nga personeli ynë, të cilin do të zëvendësonim, ishte një tjetër element inkurajues që ndikoi ndjeshëm tek unë, duke e sjellë misionin si plotësisht të realizueshëm e me sukses. Përgjigjet e tyre pozitive rreth vazhdimësisë së misionit, më entuziasmuan dhe më shërbyen jo vetëm mua, por dhe pjesëtarëve të tjerë të grupit, si frymëzim se mbarëvajtja e misionit deri në përfundim do të ishte e sigurt. Ana psikologjike dhe morale në këtë rast del e një rëndësie të veçantë. Marrja dhe dorëzimi i detyrave nga kolegët tanë shqiptarë, na mbushi plot kurajë dhe besim, duke i parë si modelin më të mirë për vazhdimësinë e detyrave të ngarkuara. Ajo që më bëri përshtypje ishte fakti që personeli ynë në KFOR mbulonte pozicione tepër të rëndësishme e kyçe, duke vërtetuar më së miri rëndësinë e prezencës dhe kontributit tonë, i cili ka ardhur gjithmonë në rritje edhe në Kosovë.

Sic doli dhe tek pyetja juaj e parë, angazhimi im në misionin në KFOR përkoi me dy detyra shumë të rëndësishme, ajo e Shefit të Shtabit të Grupimit të Mbështetjes Logjistike të Përbashkët të KFOR-it (JLSG), dhe e Përfaqësueses së Lartë Ushtarake Shqiptare (PLU). JLSG është një nga njësitë e KFOR-it i cili në përputhje me misionin e KFOR-it, ka për detyrë të sigurojë mbështetjen operacionale logjistike e xheniere ushtarake për forcat e KFOR-it, dhe lëvizjen e lirë. KFOR-i në Kosovë, bazuar në misionin që ka, është reaguesi i tretë pas Policisë së Kosovës, EULEX, në drejtim të sigurimit të një mjedisi të qetë e të sigurtë, të mbështetjes dhe koordinimit të ndërhyrjeve humanitare ndërkombëtare dhe prezencës civile, të mbështetjes së zhvillimit të një Kosove stabël, demokratike, multietnike dhe paqësore, si dhe të zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Në këtë kuadër, shefi i Shtabit të JLSG është këshilltari i parë i komandantit të JLSG për të gjitha çështjet konceptuale e doktrinare logjistike, duke udhëzuar, menaxhuar, koordinuar me të gjithë stafin në emër të kom. JLSG, për të vendosur prioritetet e punës së komandës. Gjithashtu, është përgjegjësi kryesor për efikasitetin e brendshme të punës së të gjithë stafit, për koordinimin e realizimit të detyrave, me qëllim zhvillimin e veprimeve e aktiviteteve të komandës së



JLSG. Në mungesë të komandantit merr drejtimin e njësisë.

Gjithcka e thënë më lart, nënkuptonin për mua më shumë përgjegjësi, angazhim, komunikim, racionalitet, korrektësi, e më pak kohë të lirë.

Znj. Nënkolonele, ju jeni një ushtarake që gjatë karrierës suaj, keni kryer shumë trajnime dhe kurse të ndryshme. Si ishte jeta juaj e përditshme në mision dhe të qenit larg familjes suaj për një kohë kaq të gjatë?

Gjatë karrierës sime jam përpjekur jo rrallë herë të sfidoj vështirësitë e paraqitura, lodhjen dhe, hereherë, të pamundurën. Themi që vështirësitë na forcojnë, por kur bie fjala tek familja, edhe distanca më e vogël ndikon. Mision-familje, dy terma sa të ndryshme, po aq të ngjashme. Për nga ritmi ditor i aktivitetit, nocioni "kohë" përbën ngjashmërinë, ndërsa nocioni "cultural diversity" përbën diferencën. Për 6 muaj e kupton se je shkëputur nga familja tradicionale dhe je bërë pjesë e një "multinational family". Fakti që vij nga një familje ushtarake dhe kam krijuar po një familje ushtarake, e zbut paksa ndjesinë e largësisë dhe mallit, sado që është i pashmangshëm. Edhe teknologjia ka ndikuar pozitivisht në këtë drejtim. Pas një dite të ngarkuar, lodhja zhdukej që në momentin kur kthehesha nëdhomë dhe flisja me familjen, duke më dhënë ndjesinë e të qenit përsëri një mama që interesohet për shëndetin, mësimet, ushqimin etj. Por dhe distanca jo shumë e largët dhe krijimi i mundësive për të ardhur me leje pranë familjes, ka bërë që ditët të ikin shpejt, koha të kalojë e bashkë me të dhe pritja për përfundimin e misionit. Për familjen, më e rëndësishme ka qënë shëndeti im dhe përmbyllja me sukses e misionit.

Po si është dita në një mision?

Ajo është e mbushur me trajnime, sidomos kur je në fillimet e tua të para, takime, mbledhje, inspektime, përgatitje raportesh, etj. Në ditët e para të miat në mision, por dhe në vazhdimësi, më qëlloi të kryeja trajnimin e "Key Leader Training", të



lëvizja në të gjitha njësitë e varësisë së KFOR-it, të veproja si "Acting Commander", në mungesë të komandantit për një periudhë kohore relativisht të gjatë; të merrja pjesë në evente, përvjetore të ndryshme kulturore, të organizuara nga KFOR-i si dhe nga vendet e tjera kontribuuese, duke qënë se mbuloja dhe detyrën e Përfaqësuesit të Lartë Ushtarak. Si e tillë, nuk kanë munguar mbledhjet dhe takimet me personelin dhe kontigjentin shqiptar, mbi udhëzimet për mbarëvajtjen e këtij misioni, për të shmangur stresin, problematika që mund të lindnin e kështu me radhë. Por në cdo hap, kam patur pranë ndihmën e kolegëve të mi të JLSG nga 16 vende të NATO-s dhe jo-NATO, dhe të personelit ushtarak shqiptar, si ai që shërbente në shtabin e KFOR-it, ashtu dhe nga personeli i kontigjentit të Pejës. Kam patur bashkëpunimin dhe ndihmën edhe të personelit koso-

var që shërbente në KFOR, të cilët, nëpërmjet kësaj interviste dëshiroj t'i falenderoj për ndihmën e dhënë; ndihmën e mbështetjen e palodhur të ambasadës sonë të akredituar në Kosovë, e vecanërisht të amabsadorit tonë atje, z. Qemal Minxhozi. Puna e veprimtaria ime në KFOR-National/JLSG COS-AL SNR, në cdo aspekt ishte e ndërthurur.

Znj. nënkolonele, duke qënë në pozicionin e shefit të Shtabit të Grupimit të Mbështetjes Logjistike të Përbashkët të KFOR-it (JLSG), a kërkohet një koordinim i ngushtë me kolegët apo shefat e degëve të tjera të shtabit të KFOR-it, apo edhe me personelin tjetër të njësisë vartëse. Si ishte ky komunikim? Si është të shërbesh në KFOR?

Pjesëmarrja në mision ishte një nga sfidat e radhës, ndoshta sfida më e madhe e deri tanishme. Misioni, po të flasim me gjuhën e një "after-action review", ishte një "qasje gjithpërfshirëse", në drejtim të gjuhës së përbashkët të komunikimit, që ishte jo anglishtja, por në thelb mirëkuptimi, afritmeti, mirësjellja, bisedat e ndryshme që të njihnin më nga afër me kolegët jo vetëm të 16 vendeve të njësisë së JLSG, por edhe me personelin e njësisë të tjera të KFOR-it, apo përfaqësuesit e lartë ushtarakë të vendeve respektive kontribuuese; cultural diversity, ndarja e kulturave të ndryshme në cdo fushë; gender perspective, që edhe pse detyrat nuk njihnin diferencim, përsëri, të binte në sy trajtimi dhe respekti ndaj figurës femërore.

Prezenca femërore në KFOR ishte e konsiderueshme. Të gjitha këto të krijonin një mjedis komod pune, duke të mundësuar ingranimin e menjehershëm në ritmin ditor të misionit, sikundër dhe shmangien e cdo lloj stresi që natyrshëm lind, sidomos kur bëhet fjalë për një mision të parë. Në njësinë e JLSG dhe jo vetëm, unë gjeta një leadership të suksesshëm, përgjegjësi të ndara e shumë tëqarta, një marrëdhënie punë reciproke ekselente, bashkëpunim dhe komunikim të bazuar mbi besueshmërinë, këshillim në nivel ekspertësh, gjithcka në interes të realizimit të misionit. Ishte ky

nivel komunikimi me të gjitha këto elemente që cuan në finalizimin e disa prej projekteve më kryesore që njësia e JLSG kishte marrë përsipër, si: "by pass" i urës "beyli MBJ", inagurimi i hangarit të NATO-s në aeroportin ushtarak, zhvillimi i konferencave të ndryshme për HNS, shtrime rrugësh, transportim donacionesh në rajone të ndryshme të Kosovës, në mbështetje të projekteve të BCU/CIMIC, pjesëmarrje në stërvitje të ndryshme me skenarë EOD, etj. Të gjitha këto projekte u realizuan në koordinim e bashkëpunim të ngushtë jo vetëm me njësitë e tjera të KFOR-it, por edhe me strukturat civile jashtë KFOR-it si dhe me Forcën e Sigurisë së Kosovës/ FSK. Kur ke punuar 6 muaj, mund të thuash me gojën plot se të shërbesh në KFOR është një eksperiencë sa unike aq dhe emocion më vete. E them këtë, duke patur parasysh edhe traditën e organizimit të përcjelljes së personelit që përfundon misionin. Aty merr vlerësimet e kolegëve, vlerësimet e eprorëve, ndan opinionet e një pune 6 mujore të përbashkët.

Çfarë e dallon këtë mision nga misionet e tjera të NATO-s, në të cilat Forcat tona të Armatosura janë pjesëmarrëse dhe që ndoshta mund të quhen edhe më të rezikshme?

Mandatet e misioneve paqeruajtëse janë bërë gjithnjë e më komplekse. Jemi të ndërgjegjshëm se koncepti i sigurisë nuk është më ai klasik, lufta. Të gjithë e dimë se që nga muaji qershor 1999, NATO mori drejtimin e misionit paqeruajtës, me ndërhyrjen e saj në Kosovë, në mbështetje të përpjekjeve të shumta të ndërkombëtarve për ndërtimin e paqes dhe sigurimin e një zone të stabilizuar. Detyrat që realizon KFOR-i, të bëra prezent në website zyrtar si burime të hapura, për këdo që kërkon të informohet rreth tij, përfshijnë ndihmën për kthimin ose zhvendosjen e personave të zhvendosur dhe refugjatëve; rindërtimin dhe deminimin; ndihmën mjekësore; sigurinë dhe rendin publik; mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë kulturore; sigurinë kufitare; ndalimin e kontrabandës së armëve ndërkufitare; zbatimin e një programi amnistie për

armët, municionin dhe eksplozivin në mbarë Kosovën; shkatërrimin e armëve; mbështetjen për krijimin e institucioneve civile, rendit dhe ligjit, sistemit gjyqësor dhe penal, procesit zgjedhor si dhe aspekteve të tjera të jetës politike, ekonomike dhe shoqërore të Kosovës. Gjithashtu, një vëmendje e veçantë vazhdon t'i kushtohet edhe mbrojtjes së pakicave. Kjo përfshin patrullat e rregullta pranë enklavave të pakicave, pikat e kontrollit, eskortimin për grupet minoritare, mbrojtjen e vendeve të trashëgimisë si manastiret dhe donacionet përfshirë ushqimin, veshmbathjen dhe furnizimet shkollore. Të gjitha këto prekin e çënojnë sigurinë jo vetëm të Kosovës por edhe atë rajonale.

Kontributi i vendit tone, si pjesë e NATO-s, në këtë mision, është një kontribut jo vetëm për paqen e stabilitetin në Kosovë, por edhe për sigurinë rajonale. Ky kontribut ka ardhur në rritje, me shtimin, në fillim të vitit të kaluar, e një kontingjenti të forcave speciale të KFT, i cili kryen detyra në terren. Por jo vetëm, prezenca jonë është dhe po rritet edhe në përfshirjen e pozicioneve kyçe në shtabin e KFOR-it.

Periudha gjashtë-mujore e misionit tuaj përkoi dhe me ndryshimin e komandës midis komandantit të KFOR-it, gjeneralmajor Xhovani Fungo dhe pasuesit të tij gjeneral Salvatore Cuoci. Si ishte të punoja me ta?

Kur fola pak më lart për komunikimin në KFOR, me komunikimin e lidhshëm pata parasysh jo vetëm lidhshimin e njësisë ku unë punoja dhe stafin e tij, duke filluar nga Kol. Prieler(AUT), Kol. Prammer(AUT), por edhe lidhshimin e KFOR-it. Do të dëshiroja të ndaja dy momente që unë i kam shkëputur nga puna ime me dy gjeneralët e lartpërmendur të KFOR-it: ndihma e gjeneralmajor FUNGO, në lidhje me finalizimin e marrëveshjes teknike midis dy vendeve tona, Shqipërisë e Italisë për mbështetjen logjistike të kontingjentit tonë të Pejës, si dhe ndihma e pakursyer e gjeneralmajor CUOCI mbi organizimin e ditës së flamurit dhe vizitës së Ministrit të Mbrojtjes, Znj. Olta Xhaçka. Por ajo që më tërhoqi

vëmendjen ishte fakti që çdo drejtues i cili merr rotacionin e radhës sjell me vete dhe një slogan të tijën me një mesazh shumë domethënës, të skalitur në logon e KFOR-it. Mesazhi i Gjeneral Fungo-s e nëpërmjet tij i KFOR-it ishte "Trust and Commitment"- "Besueshmëria e Angazhim". Tashmë besueshmëria e prezencës së KFOR-it është vendosur në Kosovë, kështu që Gjeneral Cuoci solli një tjetër slogan kuptimplotë: "Endeavour Commitment"- "Angazhimi i Përpjekjeve".

Shpesh herë delegacione nga Këshilli i Atlantikut të Veriut dhe personalitete të tjera të vendeve të NATO-s dhe vendeve partnere vizitojnë KFOR-in. Po ju sjell në vëmendje vizitën e ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, znj Olta Xhaçka, në selinë e KFOR-it, më 24 nëntor 2017, vizitë që përkoi me kohën e misionit tuaj. Kur folëm paraprakisht së bashku për këtë intervistë ju më treguat për emocionin dhe krenarinë që ndjetë. Mund të ndani me lexuesit diçka nga kjo vizitë?

Festat kombëtare marrin më shumë kuptim kur ndodhesh jashtë kufijve të vendit tënd dhe përjetimi është më ndryshe. Unë këtë ndjesi e kam provuar edhe më parë. Por, këtë radhë, festa e Ditës së Flamurit ishte e veçantë se, përpos faktit se po e festonim në mision, në këtë ditë me ne u bashkua dhe Ministri i Mbrojtjes, znj Olta Xhaçka. Personalisht, mund të them që ishte event i bukuri, dhe emocionet shtohen kur urimet për festën kombëtare përcillen drejtpërdrejt nga ministri ynë i Mbrojtjes, nga komandanti i KFOR-it, nga të gjithë drejtuesit e tjerë madhorë ushtarakë, përfaqësuesit e lartë ushtarakë të vendeve kontribuuese në KFOR, nga kolegët tanë të huaj, kolegët tanë kosovarë, përfaqësuesit e FSK, si dhe të ambasadës sonë në Kosovë, të cilët na nderuan me pjesëmarrjen e gjerë të tyre në ceremoninë që ne organizuam me këtë rast, duke uruar dhe shijuar festën tonë. Teksa për të pranishmit, shfaqeshin pamjet filmike mbi progresin e Forcave të Armatosura ndër vite, në dokumentarin e përgatitur



për këtë qëllim nga QKMBM, vëreja interesimin maksimal dhe reagimet positive të tyre, të cilat më vonë u pasuan edhe në diskutimet e lira të përbashkëta me shprehje si: "do gjejmë mundësinë të vizitojmë Shqipërinë; do dëshirojmë të rivijmë përsëri e të provojmë ushqimet tuaja të mrekullueshme, etj'". Fakti që ministrja Xhaçka, e preu tortën (një tortë simbolike me flamurin shqiptar, e realizuar nga kolegët kosovarë), duke na patur në krah mua dhe oficeren tjetër shqiptare, ishte shumë domethënëse. Interesi i saj, vëmendja dhe mbështetja që personalisht dhe institucionalisht na ofron ne femrave, u evidentua edhe në këtë detaj, duke na shtuar besimin në forcën e lidhshimit e disiplinës, duke na bërë ta ndiejmë veten të privilegjuar që edhe ne jemi pjesë e kontributit të vendit tonë në misionet paqeruajtëse, duke kontribuar sado pak në stabilitetin dhe paqen në rajon. Ceremonisë festive i parapriu takimi që MM zhvilloi me komandantin e KFOR-it dhe me gjithë personelin ushtarak shqiptar që shërben në mision në KFOR. Vlerësimi i performancës së trupave tona këtu në mision, ishte në fokus të të gjitha diskutimeve të përbashkëta.

Më sipër ju na treguat rreth asaj që bëhet në KFOR. Pra ky mision nuk është një mision luftarak. Është një operacion i udhëhequr nga NATO, (nën autoritetin e Kombeve të Bashkuara) për mbështetjen e paqes në Kosovë që nga 12 qershori i 1999 në mbështetje të përpjekjeve më të gjera ndërkombe-tare për të ndërtuar paqen dhe stabilitetin në rajon. Por duam të dimë diçka rreth stërvitjeve që zh-

villohen atje të cilat gjithashtu janë shumë të rëndësishme, për shembull një nga këto stërvitje që përkoi me qëndrimin tuaj ishte "Silver Sabre", kryer së bashku nga KFOR, EULEX, Policia e Kosovës, Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe Agjencia e Menazhimit të Urgjencës të Kosovës. Pra kjo stërvitje, si një nga veprimtaritë më të rëndësishme të trajnimit, u krye dhe u kryesua nga KFOR. Si vijon këto stërvitje në syrin e një ushtaraku karriere të FA shqiptare?

E vërtetë, stërvitja, të cilës ju iu referuat, është një nga stërvitjet më të rëndësishme, që KFOR-i e cilëson si "flagship-exercise". Është një stërvitje e realizuar nën drejtimin e zëvendëskomandantit të KFOR-it, Gjeneral Brigade János CSOMBÓK, me përfshirjen e të gjithë aktorëve që ju përmëndët, e me objektiv për të përmirësuar mirëkuptimin e ndërsjellë në lidhje me rolet, aftësitë dhe kapacitetet e tyre për reagim emergjent në trazirat civile dhe operacionet e skenarëve të emergjencave të fatkeqësive në nivel të Kosovës. Dhe jo vetëm. Është dhe zhvillimi i stërvitjes "Dragon Fire", i zhvilluar nga batalioni i manovrës taktike të KFOR-it, në bashkëpunim me njësitë e tjera, një ndër të cilat ishte dhe njësi ku unë shërbeja. Objekti i kësaj stërvitjeje ishte praktikimi për planifikimin dhe kryerjen e sulmit ajror, operacioneve të kërkimit për të rritur ndërveprimin me kontingjentet shumëkombëshe të KFOR-it, sikundër dhe gatishmëria operacionale e EOD. Në të dyja këto stërvitje unë kam marrë pjesë nga afër dhe do të thoja që janë përvoja shumë të mira për t'i sjellë edhe tek ne. Si një ushtarake që kam marrë

pjesë në shumë stërvitje brenda vendit, mund të them se edhe stërvitjet tona qëndrojnë në të njëjtin nivel për nga organizimi, mënyra e zhvillimit etj. Megjithatë, sjellja e përvojave dhe elementeve të reja gjithmonë është pozitive.

Qendra e Doktrinës dhe Kërkimit në KDS, është qendra e mendimit dhe studimit të Doktrinës Ushtarake. Ndërkohë ju jeni Shefe e Departamentit të Doktrinës dhe Publikimeve Doktrinare në këtë qendër. Si është të kthehesh nga një mision si ai i KFOR-it dhe të hysh përsëri në zyrën akademike, nga ku ke munguar për gjashtë muaj?

E ritheksoj, është një përvojë e cila gjen konkretizim edhe në punën që aktualisht kryej pranë QDK. Pjesë e referencave të punës sime në KFOR, ka qënë dhe Doktrina e NATO-s, AJP 4.6 për Grupin e Mbështetjes Logjistike të Përbashkët, ajo ç'ka kjo doktrinë ofron dhe si është realiteti konkret në KFOR. Shefi i Departamentit të Doktrinës dhe Publikimeve Doktrinare, në Qendrën e Doktrinës dhe Kërkimit, pranë Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, përgjigjet për realizimin e detyrave të Departamentit në funksion të zhvillimit të Doktrinës së Përbashkët, monitorimit dhe harmonizimit të publikimeve të përbashkëta, manualeve, rregulloreve, procedurave standarde dhe botimeve të tjera, në përputhje me hierarkinë doktrinare dhe publikimet e NATO-s, përgatitjen e botimit të Revistës Ushtarake, si organ teorik-shkencor i KDS. Në grupet e përbashkëta të punës për rishikimin, ripunimin e publikimeve doktrinare në FA, do të silllet pse jo edhe përvoja e marrë nga misionet, në lidhje me problematikat e fushës.

Do ta donit një mision të dytë?

Nuk do t'i thoja jo një angazhimi tjetër në mision. Ajo që dëshiroj të shpreh në përfundim të intervistës është që gjithmonë jam e gatshme të jap më të mirën time të mundshme, në kryerjen me profesionalizëm të të gjitha angazhimeve dhe detyrimeve të ndërmarra.

Intervista Kolonel Stroni:

QSFT “fidanishtja” ku rriten liderat ushtarakë

Intervistë me kolonel Dritan Stroni, komandant i Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore

Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore (QSFT), përbën një nga elementët më të rëndësishme në organikën e kësaj njësie elitare të FARSH. Në një intervistë për gazetën “Ushtria” komandanti i QSFT kolonel Dritan Stroni, na njehtë më atë cfarë kjo Qendrës përfaqëson dhe me punën që kryhet nga personeli i saj për përgatitjen e ushtarakëve që trajnohen në të.

Z. Kolonel cili është misioni dhe disa nga detyrat kryesore të Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore?

Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore është një nga institucionet e sistemit të arsimit dhe stërvitjes të Forcave të Armatosura që ka si përgjegjësi kryesore arsimimin dhe stërvitjen individuale, kualifikimin dhe aftësimin e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve të Forcave të Armatosura në specialitetet e forcave të luftimit (Combat elements) dhe mbështetjes të luftimit (Combat Support). Gjithashtu pjesë e përgjegjësisë të Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore është edhe zhvillimi i kurseve në gjuhën anglisht për efektivat e Forcës Tokësore për nivelin 1/0/1/0, 1/1/1/1 dhe 2/1/2/1.

Çfarë kurse zhvillohen në këtë Qendër?

Në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore zhvillohen kurset institucionale për oficerë, nënoficerë dhe ushtarë sipas përcaktimit të bërë në “Konceptin e arsimit dhe trajnimit individual të personelit në FARSH” të



miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1083, datë 30.05.2017, kurse funksionale për nevojat e Forcës Tokësore, kurset e gjuhës angleze për nivelet 1/0/1/0, 1/1/1/1 dhe 2/1/2/1 për efektivat e Forcës Tokësore, si dhe kurse të ndryshme familjarizuese sipas nevojave dhe kërkesave. Kurset institucionale që zhvillohen në këtë Qendër janë Pjesa e dytë (e specialitetit) e Kursit Bazë të Nënoficerit, Pjesa e dytë e Kursit të Avancuar të Nënoficerit, Kursi Bazë i Oficerit dhe Kursi i Avancuar i Oficerit.

Vlen të theksohet se në misionin dhe përgjegjësitë aktual të Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore nuk është marrë në konsideratë përcaktimi doktrinar për forcat luftuese dhe ato të mbështetjes të luftimit, pasi në këtë qendror zhvillohen kurset institucionale në specialitetet këmbësori, zbulim, artileri tokësore dhe kimi, si dhe kurset funksionale të forcave speciale dhe komando, por nuk përfshihen specialitetet apo funksionet e tjera që janë pjesë të këtyre grupeve si, xhenio, policia ushtarake apo ndërlidhje. Kështu më konkretisht specialiteti i xhenios është element i mbështetjes së luftimit që ka për detyrë të sigurojë

lëvizshmëri, kundër-lëvizshmëri dhe qëndrueshmëri të trupave dhe jo element logjistik (Combat Service Support). Mirëmbajtja e infrastrukturës është një funksion apo detyrë logjistike që mbulohet nga forcat xheniere (MILENG).

A janë modulet mësimore që aplikohen në Qendrën që ju drejtoni, në përputhje me nevojat e që kanë realisht ushtarakët në punën e tyre të përditshme?

Fillimisht, duhet të pranojmë tezën se zhvillimi dhe përmirësimi nuk kanë fund. Në këtë këndvështrim, dua të vlerësoj punën e bërë deri tani nga trupa mësimore dhe gjithë aktorët e tjerë, që kanë rol në këtë proces jashtë Qendrës Stërvitore të Forcës Tokësore si në hartimin e kurikulave, metodikave mësimore dhe stërvitore dhe leksioneve të kurseve. Kështu, duke pranuar tezën e zhvillimit të vazhdueshëm, programet mësimore dhe stërvitore duhet të rishikohen dhe përmirësohen, për t’iu përgjigjur kërkesave dhe standardeve të kohës. Ne kemi filluar një proces, për rishikimin e programeve mësimore që

kemi aktualisht, si dhe hartimin e programeve të reja, për kurset të ndryshme brenda përgjegjësisë së Qendrës Stërvitore. Ky proces influencohet nga disa faktorë, por më të rëndësishmit për të qenë të suksesshëm janë; miratimi i standardeve dhe objektivave të kurseve, saktësimi i mekanizmit për hartimin dhe rishikimin e programeve, kryerjen e oponentëve dhe miratimi i tyre, standardizimi dhe miratimi i metodikave dhe leksioneve, përfshirja në gjithë proceset e personelit me ekspertizë dhe profesionalizëm në fushat dhe specialitetet respektive, përcaktimi i kohëzgjatjes së kurseve në varësi të programit dhe aftësisë së kursantëve për të absorbuar programin. Lidhur me përputhjen e nevojave që kanë ushtarakët për të zotëruar aftësi që kërkohen nga funksioni i punës që do të kryejnë pas përfundimit të kursit, dua të saktësojë se këto kurse japin njohuri të përgjithshme në specialitete të caktuara për t'i përgatitur ushtarakët për një nivel më lart të punës, ekspertizës apo gradës. Pra, kjo qëndron në themel të objektivave të kurseve dhe orienton punën tonë.

Sa i kualifikuar është stafi i instruktorëve të Q.S?

Dua të jem realist në lidhje me ekspertizën dhe profesionalizmin e trupës mësimore të Qendrës Stërvitore. Aktualisht, pas zhvillimit të disa kurseve institucionale dhe funksionale, pa harruar kurset e gjuhës së huaj të zhvilluar nga Seksioni i Gjuhës së Huaj, mund të them se ekspertiza dhe profesionalizmi i trupës mësimore për të zhvilluar një proces mësimor dhe stërvitor me standarde është në nivele të kënaqshme. Dua të theksoj se ka instruktor që janë shumë profesionist dhe të aftë, si për shembull instruktorët e Seksionit të Këmbësorisë apo Gjuhës së Huaj, por mund të them se më shumë duhet të bëhet nga seksionet e tjera. Gjithashtu, nuk mund të lë pa përmendur këtu edhe rolin e instruktorëve nënoficer, të cilët janë larg standardeve dhe kërkesave ndaj tyre. Është e rëndësishme të pranojmë se më shumë duhet bërë në këtë drejtim për të krijuar ekspertizën e nevojshme në Qendrën Stërvitore me qëllim implementimin e një procesi mësimor e stërvitor cilësor dhe me standarde. Është e nevojshme që në Qendrën Stërvitore të shërbejnë ekspertët më të mirë të fushave respektive që zotërojnë aftësi të mira në procesin e mësimdhënies. Këtu përparësi merr përmbushja e detyrimeve të Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1446, datë 06.10.2014

“Për miratimin e politikave dhe procedurave standarde të emërimit të personelit në Forcat e Armatosura”, si dhe Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 670, datë 11.04.2016 “Për miratimin e politikës dhe procedurës për menaxhimin e specialiteteve në Forcat e Armatosura”. Menaxhimi i burimeve njerëzore mund të luaj një rol të rëndësishëm në këtë çështje.

Cilat ishin disa nga arritjet e Q.S gjatë vitit 2017?

Qendra Stërvitore gjatë vitit 2017, ka përmbushur të gjitha detyrimet e programit të arsimit dhe stërvitjes në Forcat e Armatosura. Kështu janë zhvilluar 14 kurse të ndryshme institucionale dhe funksionale, me kohëzgjatje rreth 3 muaj secili, duke arsimuar dhe stërvitur në total 373 oficer, n/officer dhe ushtar. Megjithatë në pikëpamje të organizimit, Qendra Stërvitore e Forcës Tokësore ka efektivin më të vogël krahasuar me strukturat e tjera të ngjashme në Forcat e Armatosura, volumni i kurseve të kryera dhe numri i kursantëve të arsimuar dhe stërvitur ka qenë i konsiderueshëm.

Rishikimi dhe miratimi i programeve mësimore për kurset institucionale dhe funksionale ka pasur një vëmendje të veçantë dhe është një proces në vazhdim. Zhvillimi është një nga kërkesat kryesore për një forcë profesioniste.

Gjithashtu Qendra Stërvitore ka dhënë kontributin e saj në procesin e rishikimit të dokumenteve që rregullojnë dhe normojnë procesin e arsimit dhe stërvitjes në Forcat e Armatosura. Gjykojmë se më shumë duhet bërë në lidhje me këtë çështje, si dhe institucionet duhet të udhëheqin ekspertizën dhe kontributin e individit dhe jo individit t'i jap 'frymën' vendimmarrjes institucionale.

Një vëmendje të veçantë në aktivitetin e Qendrës Stërvitore për 6-mujorin e dytë të vitit 2017 mori vlerësimi i veprimtarisë së saj për përmbushjen e detyrimit për arsimit dhe stërvitjen individuale të trupave në specialitetet e Forcave Tokësore, analizimi i kësaj veprimtarie sipas këndvështrimit DOTMLPFI dhe propozimi i masave dhe kërkesave të nevojshme për rritjen e efektivitetit të kësaj strukture në përmbushjen e misionit dhe detyrave kryesore.

Çfarë objektivash keni për vitin 2018?

Përmbushja e detyrimeve që burojnë nga programi arsimor dhe stërvitor i Forcave të Armatosura është një nga objektivat kryesor që përbën prioritetin kryesor të Qendrës Stërvitore.

Rishikimi i programeve mësimore për kurset institucionale dhe funksionale, si dhe hartimi i programeve të reja mësimore dhe stërvitore për kurse funksionale do të jetë në vëmendje të vazhdueshme për t'iu përgjigjur kërkesës për zhvillim të vazhdueshëm profesional. Rritja e kontributit të Qendrës Stërvitore përtej arsimit dhe stërvitjes individuale të personelit duke mundësuar ekspertizë në planëzimin dhe zhvillimin e stërvitjeve kolektive. Një ekspert i mirë, mund të jetë shumë i vlefshëm në fazën e ekzekutimit të stërvitjeve kolektive në rolin e trajnuesit. Qendra Stërvitore, pavarësisht kushteve dhe situatës ku është, zotëron potenciale për të bërë më shumë. Është detyrim i të gjithë niveleve të komandimit dhe kontrollit për të mundësuar dhe çliruar këtë aftësi dhe kontribute.

Çfarë mendoni se duhet ndryshuar në interes të realizimit të këtyre objektivave?

Është e vështirë të listosh dhe kufizosh nevojat dhe kërkesat për të arritur objektivin madhor për një forcë profesioniste. Qendra Stërvitore është një kontribuuese në përmbushjen e këtij objektivit nëpërmjet detyrimeve që ajo ka. Duhet të jemi të ndërgjegjshëm dhe realist për të analizuar arritjen e objektivave me mundësitë që kemi. Pavarësisht kufizimeve mendoj se ka shumë për të bërë pa u vënë nën presionin e 'pamundësisë'. Duhet të ekzistoj vetëm vullneti i mirë dhe ndjenja për zhvillim. Kështu një çështje që do të influenconte pozitivisht në përmbushjen e objektivave të Qendrës Stërvitore do të ishte rishikimi dhe plotësimi i gjithë hierarkisë të dokumenteve kryesore të arsimit dhe stërvitjes në Forcat e Armatosura me qëllim sigurimin e një sistemi efektiv të arsimit dhe stërvitjes. Rishikimi i strukturës së Qendrës Stërvitore, duke marrë në konsideratë përcaktimet doktrinare, ekspertizën dhe efektivitetin, do t'i jepte përgjegjësinë dhe rolin që i takon kësaj qendre. Ofrimi i ekspertizës së nevojshme nëpërmjet menaxhimit të burimeve njerëzore dhe respektimit të politikave kryesore në Forcat e Armatosura për këtë qëllim do të rriste efektivitetin dhe profesionalizmin. Gjithashtu nuk duhet harruar mundësimin e një infrastrukture për të zhvilluar aktivitetin normalisht dhe përmbushur detyrimet. Të gjitha këto janë të prekshme, të realizueshme dhe larg pamundësisë.

Intervistoi: Major Ervin HODO



Shpallet Kampione e Ballkanit Ushtarakja Luiza Gega fiton medalje ari në Stamboll

30 vjeçarja Luiza Gega, pjestare e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, ka dalë e parë në garën ballkanike të 3000 m, që u zhvillua në Stamboll të Turqisë, duke rrëmbyer edhe medaljen e artë në Mitingun Ndërkombëtar të Sallave të Mbyllura në Stamboll të Turqisë duke i ka shtuar vetes edhe një tjetër medalje. Garat e atletikës u zhvilluan më 17 shkurt 2018. Kampionia shqiptare ka shënuar kohën më të shpejtë 9 minuta e 06 sekonda, duke mposhtur rivalët e tjera. Një vit më parë po në Stamboll, atletja 29-vjeçare mori medaljen e artë në garën e 1500

metrave me kohën kohën 4:06:65, që është edhe rekordi kombëtar në këtë disiplinë. Luiza Gega, sportin e atletikës e ka nisur që në moshën 14 vjeçare dhe ka ndjekur shkollën e mesme "Mjeshtëria Sportive" në Durrës e më pas "Universitetin e Sporteve" në Tiranë. Por ecuria pozitive e atletëve tanë në Stamboll nuk është mbydhur me kaq. Shkodrani Izmir Smajlaj ka kërcyer më tepër se atletët e tjerë duke marrë medaljen e artë me rezultatin 7.80 m kërcim. Vend ky që i ka dhënë titullin Kampion i Ballkanit. Ndërkohë Ambasada e SHBA-së në Tiranë ka urrear atletët shqiptarë Luiza Gega dhe Izmir Smajlaj të

cilët fituan medalje ari dhe u shpallën kampionë të Ballkanit gjatë Lojërave Ndërkombëtare të Sallave të Mbyllura javën që kaloi në Stamboll të Turqisë. Në një postim në faqen e saj, ambada e SHBA-së në Tiranë, shprehet se: "Urime atletëve shqiptarë Luiza Gega dhe Izmir Smajlaj të cilët fituan medalje ari dhe u shpallën kampionë ballkani gjatë Lojërave Ndërkombëtare të Sallave të Mbyllura që u mbajtën dje në Stamboll të Turqisë". "Gega fitoi në garën e 3000 metërshit ndërsa Smajlaj në kërcim së larti", shprehet ambasada SHBA-së në Tiranë, duke postuar dhe foton e dy sportistëve.



RRUSTEM BERISHA-RADMILLA SHEKERINSKA

Stërvitje e përbashkët kosovaro-maqedonase “Shqiponja 6”

Më 2 shkurt 2018, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Rrustem Berisha priti në Prishtinë, ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, zonjën Radmilla Shekerinska-Jankovska. Fillimisht të dy ministrat zhvilluan takim vetëm për vetëm dhe më pas u zhvillua takimi i përbashkët i të dy delegacioneve, me ç' rast u bisedua për marrëdhëniet e mira dypalëshe, aktivitetet konkrete si dhe për vazhdimin e marrëdhënieve në të ardhmen. Me këtë rast, ministri Berisha falënderoi ministrin Shekerinska për bashkëpunimin e mirë dhe konkret me Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë, për gatishmërinë për zgjerimin e fushave të bashkëpunimit si dhe për shkëmbimet tjera në fushën e trajnimeve, shkollimeve si dhe ushtrimeve fushore.

Ministri Berisha konfirmoi aspiratën e Republikës së Kosovës për Anëtarësim në NATO dhe integrim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se marrëdhëniet e mira me vendet anëtare të NATO-s dhe vendet që aspirojnë për t'u anëtarësuar në NATO është prioritet i yni. Në kontekst të kësaj, ministri Berisha foli edhe për përgatitjet për transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës (FAK) si Forcë e të gjithëve dhe për të gjithë qytetarët e vendit.

Nga ana e saj, ministrja e Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë tha se Ministria që ajo drejton është e gatshme për kulturimin, zgjerimin dhe avancimin e



bashkëpunimit shumë të frytshëm me Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ajo tha se kapacitetet shkollore, trajnuese dhe stërvitore janë të gatshme dhe në dispozicion për aktivitete të përbashkëta.

Të dy ministrat, Berisha dhe Shekerinska-Jankovska, pas takimit, para gazetarëve, konfirmuan gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mbështetjen reciproke, bazuar mbi Memorandumin e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrive, të dy vendeve tona.

Rëndësi e veçantë tha ministri Berisha i është kushtuar përfaqësimit të komuniteteve jo shumicë, si dhe është bërë një hap më shumë edhe me hartimin e Strategjisë për integrim të komuniteteve ku aktualisht FSK-ja ka brenda strukturës së saj mbi 10%. „Në kuadër të kësaj është transformimi i FSK-së në FAK përmes ndryshimeve kushtetuese, në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë faktorët politikë dhe përfaqësuesit politikë të komuniteteve, në koordinim të plotë me partnerët tanë ndërkombëtarë dhe NATO-në”,

përfundoi ministri Berisha.

Ministrja Radmila Shekerinska-Jankovska tha se marrëdhëniet e mira me FSK-në do të vazhdojnë edhe në të ardhmen, duke thelluar këtë bashkëpunim edhe më tutje. Ajo përmendi edhe shkollimin ushtarak dhe programin e ri të NATO-s për shkollime ushtarake dhe, siç tha ajo, kur kadetët e vendeve tona shkollohen dhe bashkëpunojnë bashkë mirë tani, këtë frymë do ta bartin edhe në të ardhmen si ushtarakë. Ministrja Shekerinska tha gjithashtu se sipas planit të bashkëpunimit për këtë vit, ndërmjet dy ministrive ne do të marrim pjesë në ushtrimin “Shqiponja 6” si dhe do ta shfrytëzojmë për stërvitje dhe trajnim edhe Qendrën e Trajnimit për Kërkim-Shpëtim të FSK-së. Ndërsa, sa i përket transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura ajo tha se përkrahin transformimin me ndryshime kushtetuese dhe shtoi: “Ne e përkrahim qëndrimin e bashkësisë ndërkombëtare se duhet të respektohen të gjitha procedurat, situata politike dhe të gjitha situatat e ndjeshme në rajon”.



I pranishëm gjenerali Timothy Orr, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës

FSK parakalon në 10 vjetorin e Pavarësisë së Kosovës

Në përvjetorin e dhjetë të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 18 shkurt 2018 në sheshin "Zahir Pajaziti" të Prishtinës, u mbajt manifestimi qendror, ku parakaluan edhe kuadratet e njëjësive të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës. Në përvjetorin e dhjetë të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, në tribunë ishin prezentë edhe ministri i MFSK-së, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës, gjenerali Timothy Orr dhe zyrtarë të lartë të Ministrisë dhe oficerë madhor të FSK-së.

Manifestimi filloi me intonimin e Himnit shtetëror të Kosovës nga Orkestra frymore e FSK-së. Më pas, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, raportoi para presidentit Thaçi, për gatishmërinë e Forcave të Sigurisë së Kosovës për parakalim.

Në fjalën e tij, presidenti i Republikës së Kosovës, njëherësh edhe komandant suprem i FSK-së, Hashim Thaçi tha, se: „bërja e këtij shteti dhe çlirimi i Kosovës i ka bashkuar breza të tërë të cilët flijuan gjithçka për të bërë realitet shtetin sovran dhe demokratik, e cila para 10 viteve pikërisht, më 17 shkurt, që ishte dhe do të mbetet ngjarja më e rëndësishme e popullit tonë. Herën e fundit kur kishim një parakalim të FSK-së, ishte para katër viteve. FSK-ja i kishte kryer të gjitha përgatitjet për t'u transformuar në Forcë të Armatosur të Kosovës, fatkeqësisht në politikë e Kosovës, nuk ishim në gjendje që t'i përcjellim si duhet në hapa Forcat e Armatosura të Kosovës, por tani gjërat kanë ndryshuar në Kosovë. Si president i Kosovës jam i vendosur që shtetin e Kosovës ta bëjmë me ushtrinë e tij, dhe atë sa më shpejt që është e mundur" tha ai. Presidenti Thaçi, më tej shtoi se "FSK dhe Policia e Kosovës të cilat janë më të mirat në rajon, janë edhe fuqia e shtetit dhe garancia më e mirë e sigurisë dhe stabilitetit të vendit tonë, prandaj momenti i shumëpritur i zyrtarizmit të ushtrisë tonë është duke trokitur në derën e hapur. Partnerët tanë strategjitë dhe NATO janë duke e përkrahur plotësisht këtë proces të ushtrisë së Kosovës, sepse ajo do të jetë vetëm një vlerë tjetër e shtuar në shërbim të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë", tha më tej presidenti i Kosovës Hashim Thaçi.

Pas fjalës së presidentit Hashim Thaçit, parakaluan kuadratet e FSK-së: Trupa Frymore, Njësia Ceremoniale, dhe shtatë kuadratet e FSK-së, dhe pesë kuadrate të Policisë së Kosovës. Në manifestim ishin të pranishëm udhëheqësit shtetëror të Kosovës, si dhe dhjetëra delegacione shtetërore, burrështetas, presidentë, kryeministra, ministra, mysafirë të shumtë nga trupa-diplomatike, KFOR-it, si dhe mijëra qytetarë të Kosovës dhe trojeve etnike.

KURSI "KAPITENI I KARRIERËS" NË SHBA

Togeri Albert Asllani oficeri më i mirë ndërkombëtar

Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, togeri Albert Asllani, pas një trajnimi gjashtëmuor në shkollën ushtarake „United States Army Cyber Center of Excellence” në Fort Gordon të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) u nderua me çmimin “Colonel Alan C. Dexter, OBE, Award”.

Këtë çmim e marrin studentët e dalluar të cilët tregojnë arritje të larta akademike si dhe profesionalizëm dhe leadership gjatë studimeve. Çmimi “Colonel Alan



C. Dexter, OBE, Award” për Togeri Albert Asllanin është edhe një dëshmi se Forca e Sigurisë së Kosovës është në rrugë të duhur sa i përket ngritjes profesionale të pjesëtarëve të saj, dhe se ky kualitet profesional është duke u dëshmuar edhe jashtë vendit si në: shkollime, trajnime, operacione, përfshirë këto edhe në akademitë më prestigjioze në botë. Togeri Albert Asllani pas kthimit nga SHBA-të do të vazhdojë shërbimin në Komandën e Forcave Tokësore (KFT) duke bartur përvijat e tij të fituara në këtë trajnim specialistik në të mirë të avancimit dhe ngritjes profesionale të FSK-së. Në këtë trajnim kanë marr pjesë oficerë nga shumë vende të botës. Ky është trajnim special për përgatitjen e oficerëve (Kapiten) të karrierës.

Mehmet Pashë Dërralla

Ministri i parë i luftës dhe fryma e re e Kombit shqiptar

(Me rastin e 175 vjetorin e lindjes dhe 100 vjetorin e vdekjes së Mehmet Pashë Dërrallës)

KOLONEL PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI
Shef/Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Mbrojtjes
Akademia e Forcave të Armatosura

Mehmet Pashë Dërralla ishte atdhetari, patrioti, ushtaraku i zgjuar, dëshmitar i pavarësisë shqiptare, Ministri i parë i Luftës, që me jetën dhe veprimtarinë e tij shkroi epokë lavdie dhe krenarie kombëtare. Gjeneral Dërralla ka qenë ideator, organizator, udhëheqës dhe frymëzues i mjaft kuvendeve mbarëkombëtare. Ai ishte ushtarak karriere që shërbeu në situata luftarake dhe në kohë të vështira pushtimi. Orientimi i tij ishte krejtësisht i qartë e i kthjellët drejt atdhetarizmit dhe Shqipërisë së pavarur. Sa herë do të kujtohet siguria e kombit në themel ka mendimin dhe veprimin e burrit tetovar që solli një frymë të re në qeverinë e parë të shqiptarëve. Ai nuk u ul në poltronin e butë të Ministrisë së Luftës dhe as e pranoi atë si privilegj, por vetëm si përgjegjësi përpara kombit. Gjeneral Dërralla i vuri aftësitë, eksperiencën e mençurinë në funksion të qeverisë së parë të shqiptarëve të udhëhequra nga Ismail Qemal Bej Vlora. Ai i vuri shpatullat një Shqipërie të dalë nga robëria shekullore osmane, që nga fqinjët shikohej si një "copëz", për t'u gëlltatur. Pashai tetovar më 1912-tën ishte në mugutirë të burrërisë, por në kulmet e mençurisë dhe eksperiencës luftarake të mbledhur në zjarrin e betejave për lirinë e shqiptarëve. Mehmet Dërralla mblodhi rreth vetes bashkë me Isa Boletinin, kreshnikun e Kosovës 70 oficerët e parë, 155 kapterë dhe rreth 5000 vullnetarët e parë që janë edhe embrioni i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare me përvojë lindore dhe perëndimore. Mehmet Dërralla, në kulmin e karrierës së gjeneralit të ushtrisë osmane çmoi më të rëndësishme fatet e Shqipërisë se sa zbulimin e supeve me spaleta e grada. Burrat e mençur të kombit shqiptar krijuan për herë të parë traditën ushtarake shqiptare me Ministrinë e Parë të Luftës në Vlorë. Gjeneral Dërralla bashkë me kryeministrin Ismail Beun zgjodhën Major Ali Shefqet Shkupin në krye të shtatmadhorisë



Mehmet Pashë Dërralla

së parë shqiptare. Në krye të intelektualizmit ushtarak shqiptar dhe gjeneralizmit të kohës ishte padyshim Mehmet Pashë Tetovari, që firmoste "Mehmet Rruzhdiu". Është ky emri zyrtar i gjeneral Dërrallës. Me këtë emër pashai ka firmosur në më të shumtën e herës aktet e qeverisë në funksionin e Ministrit të Luftës. Mehmet Pashë Dërralla nuk merakosej për kualitetet dhe titullin e

“Pashait”, as për vlerësimet”, “ushtarak i zellshëm dhe me perspektivë”, “ushtarak karriere i suksesshëm”, që osmanët i kishin pakursim. Pashai tetovar është një nga figurat më të ndritura të historisë së kombit shqiptar, të shtetit të ri shqiptar, një nga patriotët më të mëdhenj të kombit, ndër të parët që u vu në krah të Ismail Qemalit për të krijuar pavarësinë e shtetit shqiptar, ndër figurat më eminente dhe heroike kombëtare në përpjekjet për krijimin e shtetit shqiptar, sot e 106 vite më pare. Burri i Tetovës Mehmet Pashë Dërralla tashmë l përket gjithë kombit. Ai është ndër të rrallët e asaj plejade, përjetësisht i denjë për të merituar falënderimet e shqiptarëve.

Ai e hapi trimërisht e mençurisht udhën e madhe drejt lirisë e mëvetësisë së shqiptarëve në Ballkan. Mehmet Hasan Dërralla, është dekoruar pas vdekjes në nëntorin e vitit 1992, me “Urdhrin për veprimtari patriotike të klasit I”, me motivacionin “Si komandant i njohur i forcave kryengritëse të viteve 1910-1912 dhe si ministër i Luftës në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës, ka dhënë një kontribut të shquar në krijimin dhe organizimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare”.


Trualli i mençurisë dhe trimërisë i kombit arbëror Pollogu i Iliridës ku lindi nëna e Gjergjit, Vjosava Tribalda, një shqiptare e madhe

Mehmet Rruzhdii (Dërralla) lindi në vitin 1843 në fshatin Gradec ose Draudaran të krahinës së Pollogut pranë Tetovës. Gjyshi i Mehmetit ka qenë Kurt Dërralla, që i përket fillimit të shekullit të XIX, ndërsa stërgjyshi patrioti i njohur tetovar Ruzhdi Dërralla. Fakt është se “Dërralla” ka kuptimin “derë e halleve” të kombit, por dhe “Derë e rrallë”. Dërrallajt në historinë arbërore kanë hyrë me katër mbiemra: Dërralla, Kalkanderi, Ruzhdia dhe Kosova. Pollogu është një nga tetë rajonet e Maqedonisë së sotme, dhe ndodhet në veriperëndim të vendit, që kufizohet në perëndim me hapësirën shqiptare, në veri me Kosovën, ndërsa brenda vendit kufizohet me rajonin jugperëndimor dhe rajonin e Shkupit. Nga Pollogu i Iliridës ishte edhe nëna e Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Vojsava Tribalda, një shqiptare, nga vendi ku patriotizmi është gatuar që në rrënjë. Gjon Muzaka, bashkëkohas e bashkëluftëtarë i Skënderbeut dhe njohës i mirë i aristokracisë së Shqipërisë në “Gjenealogjinë” e tij në tre vende e përmend nënën e Gjergjit, Vojsavën; ndërsa Marin Barleti, biograf dhe autor i jetës së Skënderbeut, na çon në Pollogun e origjinës së nënës së Skënderbeut, Vojsavës, që ishte e bija e njërit ndër princërit më të njohur të familjes Tribalda sundimtar të krahinës



Mehmet Pashë Dërralla, gjeneral i Ushtrisë Perandorake, i ulur majtas, bashkë me disa ushtarë në shërbim të tij në vitin 1878

së Pollogut. Mehmeti bashkëpatriot i Vojsavës, kreu arsimin fillor në Tetovë, kurse shkollën e mesme e kreu në Shkup. Pas shkollimit në vendlindje, ndoqi studimet e larta në Akademinë Ushtarake të Stambollit, të cilën e përfundoi me rezultate të shkëlqyera. Për disa vite do shërbente në Anadoll, i emëruar në një regjiment këmbësorie. Në 40 vjet të jetës së tij (1878-1918) ishte mjaft aktiv në luftën për liri, pavarësi e çlirim ndaj gjithfarë pushtuesish të trojeve shqiptare. U arsimua në tri nivelet ushtarake më të mira të kohës (gjimnaz, shkollë e lartë, akademi ushtarake prestigjioze). Mehmet Pashë Dërralla ishte ushtarak karriere; që arriti gradën pasha/general që në moshën 35 vjeçare. Ai ishte i përkushtuar dhe specialist në përmasa të një strategu ushtarak të përmasave të mëdha. Gjeneral Dërralla shërbeu në disa funksione të larta shtetërore e ushtarake, brenda dhe jashtë hapësirës së vilajeteve shqiptare. Kudo ishte model i përsosmërisë ushtarake, profesionale, teorike dhe praktike. Gjeneral Dërralla ka qenë ideator, organizator, udhëheqës dhe frymëzues i mjaft kuvendeve mbarëkombëtare si në Prizren si një ndër protagonistët e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të viteve 1878-1881; në Pejë; në Vlorën ku u hodhën themelet e shtetit të ri shqiptar që nënshkroi Pavarësinë e Shqipërisë. Ka qenë mendimtar, komandant në beteja, drejtues me përmasa strategjike në trevat e Kosovës, por shquhet në kryengritjet e mëdha të viteve 1910 deri në vitin 1912. Ai ishte anëtar i Qeverisë së Përkohshme në Shtetin e parë Shqiptar të Ismail Bej Vlora, ku mbajti detyrën e Ministrit të parë të Luftës në historinë ushtarake kombëtare. Ishte me plotë kuptimin e fjalës themelues i Ushtrisë së parë Kombëtare, në vitet 1912-1914. Mehmet Pashë Dërralla ishte personalitet që përfaqëson virtytet më të çmuara të një kombi. Ishte komandant i garnizonit të Stambollit, i internuar politik nga Stambolli 9 vjet në Bagdat; ndërsa një vit e gjysëm do t'i kalonte në burgjet e Portës së Lartë Osmane, ndër më të tmerrshmet e kohës.



Deklarata e Pavarësisë së Shqipërisë, 28 Nentor 1912

Jeta në shërbim të kombit e Gjeneral Mehmet Pashë Dërrallës

Plejada e ushtarakëve madhorë që kishin shërbyer për Perandorinë Osmane por që me shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë erdhën dhe shkrinë jetën e tyre për Shqipërinë lidhet para së gjithash me antagonizmin e tyre me qeverinë e Stambollit. Ministri i Luftës gjenerali me pamje shtatlartë Mehmet Pashë Dërralla në bashkëpunim të ngushtë me Kryetarin e qeverisë Ismail Qemal Vlora krijuan lidhje të ngushta me patriotët të shquar si Haxhi Zeka, Bajram Curri, Idriz Seferi, etj, duke u angazhuar gjerësisht në problemet e mbrojtjes kombëtare shqiptare. Gjeneral Dërralla kishte identitetin e tij me formim thellësisht kombëtar. Ai nuk përfilli as medaljet e heroizmit dhe as privilegjet që rridhnin nga Porta e Lartë. Gjeneral Dërralla edhe përpara Pavarësisë kishte kapur momentin historik duke marrë përgjegjësi duke luajtur rol të rëndësishëm, krahas burrave të shquar të Lidhjes së Prizrenit, për organizimin e veprimeve luftarake. Gjenerali tetovar u vu në dispozicion të Ushtrisë Vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u caktua këshilltar ushtarak i Sulejman Vokshit, i cili bënte detyrën e ministrit të Luftës të Lidhjes së Prizrenit. Burime dokumentare eidentojnë se ai u caktua komandant i Forcave Ushtarake të Lidhjes së Prizrenit për viset e Maqedonisë, vlerësuar kjo si një zonë me rëndësi strategjike. Mehmet Dërralladhe babai i tij, Hasan Dërralla janë nënshkrues të akteve të Lidhjes, Statutit, "Kararname", urdhëresave/Talimat, bashkë me

54 përfaqësues të tjerë. Gjeneral Mehmet Dërralla, në veprimtarinë e tij atdhetare në kuvende, në besëlidhje, në pajtime gjaqesh apo regjistrimin e vullnetarëve, kurdoherë, thoshte: "Jena shqiptarë, s'e duam të huajin në vatrat tona, vetëm lufta me mendë e me pushkë ka me na qitë në dritë". Sinjifikative është drejtimi i Ministrisë së Luftës nga Dërralla, detyrë për të cilën ishte zgjedhur me 42 vota. Ai e veshi postin e Ministrit të Luftës me prestigj mbarëkombëtar. Veprimtaria e Gjeneral Dërrallës është lidhur ngushtësisht me bashkëpunimin e ngushtë me Hasan Bej Prishtinën, që e bashkonte ndjenja atdhetare dhe reputacioni që kishin këta dy atdhetarë.

Ministri i Luftës me ideale të qarta për Atdheun dhe Kombin

Në kujtesën historike të kombit shqiptar por edhe e dokumentuar në arkiva është tashmë katërcipërisht e vërtetuar se, "Ideali i tij suprem ishte Atdheu dhe Kombi i bashkuar. Mehmet Dërralla është pinjoll i një trangu atdhetar nga Gradec ose në Draudarunin e thellësisë së shekujve ilir, arbëror, daradan, në një katund jo të zakonshëm të Tetovës. Lindja, rritja dhe edukimi në një familje të pasur ekonomikisht e të pastër në sjellje, tradita atdhetare, kulturë fisnore, konturuan fizionominë e ardhshme të personalitetit të tij. Në këtë periudhë kjo trevë sikurse gjithë hapësirat shqiptare ishte nën Perandorinë Osmane. Mësimet e para i mori në shkollën e Tetovës e më pas arsimin e mesëm e kreu në Shkup. Ai u edukua me aspiratat e mëdha për liri e qytetari të Rilindjes Kombëtare. Familja, mjedisi atdhetar, zgjerimi i njohurive shkollore, gjeti tek Mehmeti terren miqësor për të kuptuar ngjarjet që përcillte shoqëria shqiptare. Tek ai u ngulitën idetë patriotike, vlerat progresive, mospajtimi me robërinë osmane etj. Gradualisht u formuan vlerat e një atdhetari me dinjitet, luftëtar aktiv dhe i devotshëm për liri e Atdhe.

Profesioni ushtarak i karrierës pëlqej nga shqiptarët. Ai konsiderohej privilegj për familjet dhe oxhaqet e mëdha dhe të pasura ekonomikisht. Duke dëgjuar këshillën e mirë të babait të tij, Mehmet Dërralla, me vullnet e dëshirë ndoqi studimet ushtarake. Duke shfaqur intelekt, vullnet, korrektësi e pasion, diplomohet në Akademinë e parë Ushtarake në Stamboll. Mbarimi me rezultate të shkëlqyera të studimeve ushtarake, emërohet në një regjiment këmbësorie në Anadoll. Këtu shërbeu me përpikmëri të lartë dhe nga të dhënat e përkufizuara "i zellshëm, me prespektivë", i jepet e drejta për studime në Shkollën e Lartë, në Akademinë e Dytë të Shtatmadhorisë në Stamboll. Duke qenë në funksione të rëndësishme si shtatmadhor, demonstroi dije, aftësi profesionale, mbajti raporte të moralshme në detyrë e shoqëri si dhe prirej drejtuesi e organizatori ushtarak. Sukseset në karrierë falë aftësive dhe shkallës së lartë të përkushtimit në të gjitha detyrat e ngarkuara, do ta bënin Mehmet Pashë Dërrallën që në moshën 35-vjeçare të përlligjte kualitetet e titullit të "Pashait", që nënkuptonte atë të gjeneralit. I graduar kështu me gradën më të lartë të kohës do të niste nga detyrat e reja që do t'i besonte komanda e lartë, fillimisht si komandues xhandarmërie

në Bagdad të Irakut. Më pas do të vijonte në Halep të Sirisë dhe më tej për t'u transferuar në Selanik, që në atë kohë përfaqësonte një nga portet më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane në Ballkan. Nga Selaniku, Mehmet Pashë Dërralla, do të merrte emërimin në vilajetin e Kosovës për të shërbyer në kryeqendrën e tij në Shkup, në Manastir. Më tej kreu funksionin e komandantit të qarkut të Prizrenit në të cilin bënte pjesë: Tetova, Gjakova dhe Luma e Kukësit. Pikërisht me këtë detyrë gjeneral Dërralla, do t'i jepte fund karrierës si oficer i Ushtrisë Osmane. Për gjeneral Dërrallën filloi një karrierë tjetër, me një profil të ri. Në shenjë proteste hoqi spaletat dhe yjet e gjeneralit të Ushtrisë Osmane dhe i'u përkushtua çështjes kombëtare. Pas këtij momenti gjenerali u vu në dispozicion të Ushtrisë Vullnetare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ishte koha kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare kulmonte një moment historik. Gjithnjë si general, i shërbeu Shqipërisë në organet vetëqeverisëse dhe të ushtrisë së kombit të vet. Pikë kthese në jetën e tij ishte Kuvendi i Prizrenit. Për lëvizjen ai ishte një nga ushtarakët e vetëm të profilizuar, me kulturë të gjerë akademike dhe me përvojë ushtarake. Duke u çmuar dhe vlerësuar këto cilësi dhe vlera moralo-atdhetare, të kushtueshme në atë kohë historike për kombin atij iu afrua vendi i këshilltarit dhe luajti rolin e një reformatori në shtabin e Sulejman Vokshit, i cili ishte patriot i madh, veprimtar e figurë e shquar e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gjenerali popullor Sulejman Vokshi kryente detyrën e Ministrit të Luftës

renit dhe autonomia e saj u shtypën në vitin 1881. Në të njëjtën linjë vazhdoi aktiviteti i atdhetarit Mehmet Dërrallës edhe pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit nga ushtria osmane e dërguar nga Stambolli. Prej këtij momenti, gjeneral Dërralla do të kontribuonte në Kuvendin e Pejës, që u zhvillua më 23 deri 29 janar 1899, një organizatë politiko-ushtarake mbarëshqiptare, i dyti për nga rëndësia pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gjeneral Dërralla spikati ndër 450 delegatët, duke lënë përshtypje prej udhëheqësi dhe drejtuesi ushtarak, atij i takoi nderi si burrë, mendimtar, organizator e drejtues i mençur të ishte përkrah Haxhi Zekës. Sidoqoftë përballë taboreve osmane, kjo lëvizje detyrohet të dështojë. Kuvendi i Pejës pësoi të njëjtin fat: u shtyp pa i mbushur qëllimet dhe objektivat e saj. Dhe Mehmet Dërralla ndërroi taktikë dhe kështu ai u vu në krye të aksioneve të veçuara të grupeve të vogla vullnetare, duke iu kundërvënë që në embrion synimeve e veprimeve të monarkive ballkanike si të Serbisë, Bullgarisë e Greqisë. Në këtë krizë Mehmet Pashë Dërralla u kap nga forcat osmane dhe u internua në shkretëtirat e Irakut prej nga u kthye prej aty nga viti 1908, falë një amnistie të përgjithshme, që u dha pas kryengritjes xhonturke. Në situatën e mëvonshme Mehmet Dërrallës, ju ofrua një funksion i lartë në ushtrinë osmane, por ai e refuzoi prerazi, duke vënë në dukje se, tashmë i përkiste tjetër kauze që kishte të bënte me idealin kombëtar. I ngazëllyer nga liria e fituar, 65 vjeçari tetovar udhëtoi nga Bagdati në Selanik, e më pas në

Shkup, ku Mehmet Dërralla u prit dhe u shoqërua me madhësi deri dhe me të shtëna topi, si traditë në nderim të gjeneralëve. Konti Leopold Berthold, diplomat i shquar dhe ministër i Jashtëm i Austro-Hungarisë do të shprehej se, "I internuari politik Mehmet Pashë Dërralla është një burrë me tipare të theksuara shqiptare, i pajisur me kulturë të gjerë



Shpallja e Pavarësisë në Vlorën historike të flamurit, 28 nëntor 1912

së kabinetit qeveritar të Lidhjes Shqiptare.

Supbaskuar, babë e bir në frontin e luftëtarit popullor

Dukuri e veçantë dhe e admirueshme ishte se në organizimin politik e ushtarak të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, morën pjesë dhe dhanë ndihmesë të vyer dy figura të familjes Dërralla: Hasan Dërralla i ati, më tepër si politikan dhe Mehmet Dërralla, i biri, si strateg ushtarak. Betejat e ashpra, dëmtime të rënda për osmanët, për afro 3 vjet, e afirmuan Mehmet Dërrallën si prijës i talentuar i një lufte popullore. Lidhja Shqiptare e Priz-

dhe ndjenja të pastra atdhetare". Roli i Mehmet Pashë Dërrallës në organizimin dhe drejtimin e kryengritjeve të mëdha të Kosovës spikati veçanërisht në vitet 1910 deri 1912. Ishin këto beteja që kulmuan me atë të verës së vitit 1912, e cila shënoi marrjen e Shkupit, ish-qendrës së vilajetit. Kryengritësit shqiptarë, tashmë tronditën tërë mjedisin ballkanik, në të cilin faktori shqiptar filloi të bëhej dominant. Në fokusin e lëvizjes së tyre u vendos në këtë periudhë shpërfillja e hegjemonizmit të shteteve fqinje siç ishte Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia, të cilat prej kohësh investonin për strategjinë e tyre që kishte të bënte me mohimin e ekzistencës së kombit



Ismail Qemali, Isa Buletini dhe delegatët e Kuvendit të Vlorës, nëntor 1912

shqiptar, në mënyrë që të zgjerohin territoret e tyre.

Në shërbim të sulltanit, por me mendje të mëmëdheu

Sikurse kreshniku i Kosovës Isa Buletini, edhe Mehmet pashë Deralla ka shërbyer në oborrin e Sulltan Hamitit. Ai shërbeu dy herë si komandant i garnizonit të Stambollit, detyrë që më vonë e ka kryer edhe Ali Shefqet Shkupi. Ishte një ndër gjeneralët e oborrit dhe drejtonte një pjesë të trupës mbrojtëse të Pallatit Mbretëror në Top Kapi Sarayë. Dokumentet për këtë janë në arkivat e Stambollit. Historianë të ndryshëm si Zija Shkodra kanë gjetur emrin e tij në fillim të viteve 1870, derisa ishte në Stamboll, me shumë urdhra të lëshuar për gardën, një pjesë e së cilës drejtohej nga nënkolonel (Yarbay) dhe colonel (Allbay) Mehmet Dërralla, duke u referuar viteve 1870-1877. Mehmet pasha në këtë periudhë pati një situatë të kompleksuar në lidhje me formimin dhe riformimin e familjes, për situatat që po përjetonte. Me Nadiden, e cila ishte vajza e madhe e Guvernatorit çerkez të Bagdadit, pati edhe fëmijën e parë nga ajo martesë që ishte I biri, Gajuri. Fundi i vitit 1908 shënon përfundimin e karrierës së tij ushtarake për Perandorinë Osmane. Kthehet në Selanik, me gruan Nadide. Gradën e gjeneralit të fituar më 1878 e dorëzoi, për shkak të zhgënjimit nga premtimet e xhonturqve më 1908, duke mbyllur kështu karrierën 30-vjeçare në shërbim të Perandorisë Osmane dhe pas shumë vitesh peripeçish jetësore, angazhimesh ushtarake, Mehmet Pashë Deralla ju përkushtua çështjes shqiptare.

Kreshniku i Kosovës Isa Boletini propozon Mehmet Dërrallën për "Ministër Luftë"

Gjeneral Mehmet Pashë Dërralla ishte një nga protagonistët kryesorë të qëndresës shekullore përballë sulmeve serbo-malazeze, të cilat synonin pushtimin e Shqipërisë Veriore. Nën komandën e tij, luftëtarët shqiptar i bllokuan forcat serbe në hapësirën ndërmjet Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi. Ismail Qemali së bashku me Hasan Bej Prishtinën, ishin një çift brilant i binomit të përbashkuar historik të kombit shqiptar, gjatë udhëtimit për në Vlorë më 1912. Ata porositën që të

njoftohej Mehmet Pashë Dërralla i qarkut të Prizrenit, që përmblihte rrethinat e Tetovës, Prizrenit, Gjakovës dhe të Lumës së Kukësit për ngjarjen e madhe të kombit, Kuvendin e Vlorës. Ndërsa në zanafillën e shtetit të ri shqiptar, me shpalljen e Pavarësisë Kombëtare më 28 nëntor 1912, Kuvendi i mbledhur në Vlorë e në të cilin merrnin pjesë të gjitha viset shqiptare, Ministër i Luftës i qeverisë së kryesuar nga plaku i bardhë i flamurit Ismail Qemal Vlorë, u caktua Mehmet Pashë Dërralla. Gjeneral Dërralla u propozua në këtë post të lartë nga burri i shquar i Kosovës martire Isa Boletini. Kuvendi Kombëtar i Vlorës, si kulmi i kuvendeve të njëpasnjëshme krahinore, ndërkrahinore e kombëtare në historinë mijëvjeçare të Shqipërisë, kurorëzoi shpalljen e pavarësisë dhe zgjedhjen e organeve drejtuese të shtetit të ri shqiptar. Në vitin 1878, pra 140 vjet më parë, në Kuvendin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, përfaqësues dhe firmëtar i Tetovarëve ishte, i ati Hasani, ndërsa në vitin 1912, në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, oxhaku i Dërrallajve përfaqësohej nga Mehmet Pashë Dërralla, burri që ka hyrë në histori dhe në këngën e popullit: "Mehmet pashë Dërralla, / Ritur me përshesh baruti, / Të kishte shku fjala dhe palla, / Lisit i vije te supi...". Ai nënshkroi në memorien e përjetshme të kombit shqiptar, që është gdhendur me shkronja të arta në historinë e kombit tonë "Shqipëria më sot të bëhet më vehte, e lirë e mosvarme". Ky moment u fiksua në fotografinë historike në krah të Ismail Qemalit e Luigj Gurakuqit, në mes të delegatëve dhe iu prezantua popullit liridashës të Vlorës duke dalë në ballkon, në radhën e parë të Kabinetit qeveritar, me rastin e përvjetorit të parë të ngritjes së Flamurit.

Burrë i shquar i shqiptarisë kërkonte 56.000 km² për shtetin e shqiptarëve

Më 4 dhjetor 1912, u zhvillua mbledhja e pestë e kuvendit për zgjedhjen e qeverisë. Kryeministri Ismail Qemali, udhëheqës i madh i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, i pari Kryeministër në historinë e Shqipërisë, shtroi kushtet që duhet të përmbushin Ministrat: "Të kënaqin Evropën në njerëz anë dhe Stambollin në anën tjetër; të jenë emra të njohur në Shqipëri, por dhe

jashtë saj". Që në votimin e parë, të qeverisë së parë shqiptare, gjenerali Mehmet Pashë Dërralla u votua me 42 vota, duke u radhitur i treti pas Luigj Gurakuqit me 54 vota dhe Myfit Bej Libohovës me 52 vota. Dikasteri i Luftës dhe Ministri vinin të tretët për nga rëndësia pas atij të Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Brendshme. Gjenerali 69-vjeçar, me përvojë mbi 40 vjet drejtimi dhe komandimi, zuri vendin parësor në Qeverinë e parë të shtetit shqiptar. Ai bëri betimin: "për Atdhe dhe për Kombin shqiptar". Ishte betimi më suprem, pasi, siç ka shkruar historiani i kombit Marin Barleti "Dashuria për Atdhe është më e madhja nga të gjitha. Ajo qëndron mbi çdo dashuri tjetër". Ndaj dhe ushtarakët e emigruar në vende të ndryshme dhe ushtarët e oficerët që ende ishin në shërbimin ushtarak të ushtrisë turke, e mirëpritën caktimin e Mehmetin në postin e ministrit të Luftës. Organizimi, sistemimi, furnizimi e drejtimi ku ndihej më e ngutshme, u vlerësua nga Ministri Dërralla, detyra më e parë shtetërore. Me forcat e ardhura në Vlorë, formoi një trupë të vogël të armatosur. Pjesën më të madhe e vendosi në brezin e Vlorës dhe në Qafën e Llogorasë, për t'u ruajtur nga ndonjë sulm i mundshëm i trupave greke e osmane. Kështu Ministri i parë i Luftës, nisi detyrën e vështirë të cilën në emër të popullit Kuvendi i Vlorës i'a ngarkoi këtij burri të shquar të Shqipërisë. Ministri Mehmet Dërralla u përqëndrua në këto drejtime kryesorë në punën e ministrisë: përpjekjet për sigurimin e mbrojtjen në planin e jashtëm si një parim bazë në politikën e diplomacinë e shtetit; administratën lokale në mënyrë të prerë dhe pa ushqyer asnjë iluzion të merrte në dorë situatën ushtarake e të rendit; autoritetet civile e ushtarake osmane të dorëzoheshin tek shteti shqiptar për të vepruar në bazë të rregullave si një shtet i pavarur; mbrojtja e Shqipërisë më tepër se ushtarake ishte diplomatike dhe përqëndrimi i vëmendjes për të penguar përparimin dhe sprapsjen e trupave pushtuese në vijat e ndaluara etj.

Vizionar me njohuri teorike, organizative e strategjike

Organizimi i Forcave të Armatosura përbën një ligjësi për çdo shtet e qeveri. Ndaj në Shqipëri, edhe vet ministri Dërralla që në fillim të dhjetorit të vitit 1912 e shikonte si domosdoshmëri dhe nga rrethanat që diktohej, për marrjen në dorëzim dhe mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së fituar pas tërheqjes përfundimtare të ushtrisë osmane, çlirimin e pjesës së vendit të pushtuar nga sllavët e grekët, bërjes ballë të ndërhyrjes së mundshme ushtarake dhe gjenocidit nga vendet fqinje, stabilizim të rendit dhe qetësisë së prishur etj. Ministri i parë i Luftës, gjenerali Dërralla dispononte njohuri teorike dhe përvojë të gjatë organizative në nivel taktik, operativ dhe strategjik. Por bazë ai pati dhe traditën luftarake, mjeshtërinë e luftëtarëve dhe të kapëdanëve popullorë, të cilat janë dhe baza në fillimin e historikut të ushtrisë së rregullt shqiptare, e cila që nga 4 dhjetori 1912 ka përshkruar një rrugë sa orgjinale aq dhe me vlera. Gjatë kohës dhe në shumë dokumente arkivore të

kohës, gjenerali Mehmet Dërralla quhej dhe Kalkanderi, emër i qytetit të Tetovës ku ai kishte lindur. Meritë e Mehmet Dërrallës ishte organizimi i Komandës së Përgjithshme dhe Shtabin Madhor me strukturat përkatëse dhe në varësi të tyre strukturat në prefektura e nënprefektura, komuna e fshatra, duke u përcaktuar edhe përgjegjësitë lëndore e territoriale. Edhe pse ishte figura e parë e Ministrisë së Luftës, kontribuoi personalisht në hartimin e "Rregullore për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës", më 13 prill 1913, në hartimin e "Rregullores së Qeverisë së përkohshme mbi formimin e Milicisë Shqiptare", më 3 qershor 1913; në organizimin e strukturës së Milicisë shqiptare, për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike, me misionin "për mbrojtjen e vendit deri sa të formohet ushtria e rregullt" etj. Një ndër studiuesit e veprimtarisë atdhetare të Ministrit të Parë të Luftës Zeqirja Idrizi, ka bërë këtë vlerësim, "Ai shkëlqeu në gjerdanin e personaliteteve ushtarake të kohës së tij... ishte nga më të shndritshmit, sepse vendosi themelet e para të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare... një model për brezat e gjeneralëve dhe oficerëve shqiptarë të çdo niveli për të gjitha kohërat, si një gjeneral me karrierë, i mendimit ushtarak dhe politik, i organizimit në paqe dhe i drejtimit në fushën e luftës, me dimensione të mëdha historike të veçanta. Mbi të gjitha shëmbëlltynë e njeriut, që mbi gjithçka e në çdo situatë, e njihte popullin dhe vendin e tij. Korrekt me vartësit, komunikues e që ngjallte besim te të tjerët dhe armik i brutalitetit, i arrogancës dhe i ashpërsisë. Ai mbetet një shembull i përmasave jo të zakonshme për të gjithë ushtarakët dhe gjeneralitetin shqiptar të gjitha brezave. Në Gradec, më 28 nëntor 2011, Mehmet Pashë Dërralla u nderua duke përruar një bust në sheshin që mban emrin e tij, në qendër të qytetit, si edhe një shkollë që mban emrin "Mehmet Dërralla". Presidenti i Shqipërisë, para lapidarit të tij në Tetovë, në prill 2012, e quajti gjenerali Mehmet Dërrallën: "Një nga figurat më të ndritura të historisë së kombit shqiptar, të shtetit të ri shqiptar, një nga patriotët më të mëdhenj të kombit tonë... ndër të parët që u vu në krah të Ismail Qemalit për të krijuar pavarësinë e shtetit shqiptar, një nga figurat më eminente dhe heroike kombëtare në përpjekjet për krijimin e shtetit shqiptar, sot e 100 vite më parë". Është fakt se dita e festës Kombëtare të Forcave të Armatosura Shqiptare, 4 dhjetor 1912, kohë në të cilën ishte Ministër lufte, lidhet dhe me emrin e kontributin e Mehmet Pashë Dërrallës, tetovarit me palcë arbërore. Ministria e Mbrojtjes e dekoroi Gjenerali Mehmet Pashë Dërrallën me medaljen "Për shërbime të shquara" në 4 dhjetor 2009 në përvjetorin e 97-të, të Forcave të Armatosura Shqiptare. Megjithatë vlerësimi i kësaj figure të ndritur të historisë sonë kombëtare duhet të dalë në dritë. Asnjëherë nuk është vonë të vlerësohet e djeshmja, duke mos e lënë pluhurin e harrës të bjerë mbi vlerat e klasit më të lartë. Vepra e atdhetarëve shkëlqen në çdo kohë dhe asnjëherë nuk është vonë për të nderuar ata që kanë vënë gurë të qoshes së historisë tonë kombëtare.

KRONOLOGJI E JETËS DHE VEPRIMTARISË SË MEHMET PASHË DËRRALLËS

Amaneti i Pashait: Katër vilajetet si katër shtyllat e kombit me gjak, gjuhë e histori

1843. Lindi në fshatin Gradec (ose Draudaran) të Pollogut pranë Tetovës. Mehmeti ishte djali i vetëm i Hasan Dërrallës. Gjyshi i tij ka qenë Kurt Dërralla, që i përket fillimit të shekullit të XIX, ndërsa stërgjyshi patrioti i njohur tetovar Ruzhdi Dërralla. Dërralla ka kuptimin "derë e halleve" të kombit, por dhe "Derë e rrallë". Si ndarje administrative sot Gradeci i përket Gostivarit.

1843-1844. Pranë fshatit Gradec në Pallçisht të Tetovës, zhvillonte aktivitet kundërosman një figurë dhe prijës i madh i shqiptarëve, që në histori njihet si Kryengritja kundërosmane e Dervish Carrës. Kryengritjet ishin frymëzim i parë për Mehmet Dërrallën.

1855-1860. Kreu arsimimin fillor pranë vendlindjes së tij në Tetovë. Dërrallajt në historinë shqiptare kanë hyrë me katër mbiemra: Dërralla, Kalkanderi, Ruzhdia dhe Kordova.

1860-1865. Kreu me sukses arsimimin e mesëm (gjimnaz) në qytetin që më vonë do të quhej "qyteti i shkronjave të shqipes" në Manastir.

1866. Futet nën armë në shërbim të Perandorisë osmane ku ngjitet me shpejtësi shkallët e karrierës ushtarake dhe hierarkinë administrative ushtarake osmane.

1866-1867. Kreu studimet në Akademinë e parë ushtarake të Shtatmadhorisë në Stamboll, akademi që ishte hapur që më 1834. Vlerësimi për djaloshin tetovar ishte "i zellshëm, i disiplinuar dhe me perspektivë".

1867-1869. komandant i xhandarmërisë në Bagdad, Irak me gradën "yzbash" (kapiten).

1870. Lindi i biri i Mehmet Dërrallës, Halim Bej Dërralla, që ishte pinjoll dhe vazhdues i derës së madhe të Dërrallajve. Kishte prirje luftarake dhe komanduese. Shpejt ai u bë dhe bashkëluftëtar me babain e tij.

1870-1872. Mehmet Dërralla caktohet komandant i xhandarmërisë në zonën e Halepit në Siri.


1872. Shërbeu në një rregjiment këmbësorie në pjesën e Anadollit dhe më tej në detyra madhore në Selanik, ku ishte një nga portet më të rëndësishëm të Perandorisë Osmane në Ballkan. Vlerësimi në detyrat që shërbeu ishte: "ushtarak karriere i suksesshëm".

1872-1873. Kreu studimet në akademinë e Shtat-

modhorisë në Stamboll, që ishte një ndër akademitë më prestigjioze për kohën (e themeluar që në vitin 1834) dhe fiton gradën "binbash" (major).

1874-1877. Vetëm në tre katër vjet falë aftësive të shkëlqyera të komandimit dhe të drejtimit ushtarak përparon me shpejtësi në gradat ushtarake "yarbay"/nënkolonel dhe "allbay"/kolonel. Mehmet pashë Dërralla shërben në oborrin e Sulltanatit, dy herë si komandant i garnizonit të Stambollit, drejtues i trupës mbrojtëse të Pallatit Mbretëror në Top Kapi Sarayë me gradën ushtarake Yarbaj dhe Allbay.

janar 1878. Mehmet Pashë Dërralla caktohet komandant i Vilajetit të Kosovës, ku në moshën 35 vjeçare ju dha grada "Pasha", që aktualisht është e njësuar me gradën ushtarake gjeneralbrigade, që përlligjite kualitetet më të larta cilësore ushtarake. Në vijimësi e shohim në funksionin e qeveritarit dhe komandantit të qarkut të Prizrenit që përfshinte edhe Gjakovën, Tetovën dhe



40 firmëtarët e pavarësisë së shqipërisë, nëntor 1912

Lumën.

10.6.1878. Kuvendi i Lidhjes shqiptare të Prizrenit. Pashai 35 vjeçar, duke u bërë karrierë si oficer i ushtrisë osmane dhe iu përkushtua çështjes kombëtare; ishte delegat i Tetovës, bashkë me Esad pashë Tetovën/Dërralla, Sheh Mustafa Tetova, Rexhep pashë Dërralla, Hasan Musharanuredin, Haxhi Sadiku, Mehmet Efendiu, Abdyl Rrufi, Riza Fuati.

2-4.9.1878. Aksioni i Gjakovës kundër Mehmet Ali Pashës dhe Abdulla Pashë Drenit. Mehmet Dërralla, në kulmin e karrierës së pashait osman çmoi më të

rëndësishme fatin e Shqipërisë se sa spaletat, gradat e medaljet e heroizmit osman.

1878. Mehmet Dërralla, është nënshkruar i akteve të LSHP: Statuti/Kararname, urdhëresave/Talimat-eve bashkë me 54 përfaqësues patriotë të tjerë shqiptarë.

1878. Është viti që shënon aktin e parë të tragjedisë shekullore të metodës gjenocide të dëbimit të 150.000 shqiptarëve. Hasan Dërralla ishte kundërshtari i parë antigjenocid si një ndër feudalët më të mëdhenj të kohës.

5-8.1.1880. Beteja vendimtare e Velikës e Pepajt ku sprapsën përfundimisht mësymjet e përsëritura të Knjaz Nikollës që kishin filluar në nëntor e dhjetor të vitit 1879.

Prill maj 1881 është periudha kur shuhet veprimtaria e LSHP, që zgjati 3 vjet.

1878-maj 1881. Këshilltar ushtarak akademik i Sulejman Vokshit, i cili bënte detyrën e ministrit të Mbrojtjes të Lidhjes shqiptare të Prizrenit.

23-29.1.1899. Merr pjesë në Kuvendin e Pejës të organizuar nën drejtimin e Haxhi Zekës bashkë me 450 delegatë të tjerë. Mehmet Dërralla u bë bashkëautor i Lidhjes së Pejës.

29 janar 1899. Mehmet Dërralla ishte një prej hartuesve të programit me 11 pika, "aktin të besës" me 12 nene dhe apelit "Rruga e shpëtimit është në besa-besën". Kuvendi miratoi me unanimitet të plotë propozimet e pashait të Tetovës për rrugën e shpëtimit që është Besa-Besën për Shqipërinë.

1900. Pas shtypjes së kryengritjes së Pejës së bashku me 30 aktivistët më të shquar të kësaj lëvizje izolohet fillimisht në Selanik dhe më tej, për 8 vjet në Halep të Sirisë dhe në shkretëtirat e Irakut pranë Bagdatit. Sulltan Hamiti II pati frikë të eliminonte Mehmet Pashë Dërrallën sepse ai e kishte sfiduar autoritetin perandorak dhe fama e tij ishte e përhapur nga Brigjet e Adriatikut e deri në brigjet e Detit të Zi.

1901. Mehmet Dërralla pasi merr njoftim për vdekjen e gruas së parë, aty ku ishte në internim në Bagdat martohet me një grua çerkeze dhe pati me të dy djem: Hysenin dhe Gajurin dhe dy vajza: Hanxherin dhe Nigjarin.

1907. Një letër e Mehmet Dërrallës mbrin në Tetovë për të birin, Halimin: "Edhe pse me zemër të plagueme ndër vise të Bagdatit, zemra më rreh e fluturon ndër ato bjeshkë e kepa për me puthun ato sokola që duan me çlirua vendin prej osmanllisë".

1908. Përfiton nga amnistia e xhonturqve dhe pas 8 vjet internimi, kthehet në vendlindje. Në Shkup është pritur me 21 të shtëna të topave, pasi ishte zakon kur kthehej ndonjë gjeneral ushtarak, nderohej ushtarakisht. 20.000 luftëtarë detyruan shpalljen e amnistisë së përgjithëshme.

1908. Mehmet Dërralla merr ftesë nga xhonturqit, "për rikthim në Ordu/ushtri", si "i mirëpritur të rivishte uniformën e gjeneralit të ushtarisë". Austro-hungarezët kanë të dokumentuar përgjigjen e tij: "U jam mirënjohës për bamirësinë, por tashti i takoj tjetërkujt. Jeta time i

takon Shqipërisë në të katër vilajetet e saj".

Maj 1908. Ministri i Jashtëm i Austro-Hungarez dhe diplomat i shquar, Konti Leopold Berthold, në një prononcim të tij në prag të amnistisë së Sulltanit osman do të shprehej se, "I internuari politik Mehmet Pashë Dërralla është një burrë me tipare të theksuara shqiptare, i pajisur me kulturë të gjerë dhe ndjenja të pastra atdhetare".

5.7.1908. Pjesëmarrës në kuvendin e Ferizajt dhe nënshkruar i telegramit që iu dërgua Sulltanit, ku kërkohet: "Të rivendoset kushtetuta e vitit 1876".

20.7.1908. Bashkë me Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Mufid Gjirakastra ishin anëtar të komisionit për marrëveshje me xhonturqit në Stamboll.

23.7.1908. Rivendoset kushtetuta e viti 1876 dhe urdhërohen zgjedhjet e reja në vend nën trysinë e madhe të popullsisë së vilajetit të Kosovës. Ky vendim i Sulltanit u mirëprit dhe në Tetovë, Pollog, ku u kthye edhe Halim bej Tetova, i biri i Mehmet Dërrallës, i shoqëruar me rreth 150 shqiptarë të tjerë.

Korrik 1908. Me kërkesë të parisë së vilajetit të Kosovës, xhonturqit vendosën Mehmet pashë Dërrallën prefekt në qytetin e Prizrenit dhe Hasan Tahsin pashën si guvernator/vali të Janinës.

1909. Mehmet Dërralla zhvillon një aktivitet të dendur me klubin "Bashkimi" të Stambollit, ku me nismën e Dr. Ibrahim Temos, të Mehmet Dërrallës e doktor Zenel Abedinit u formua "Komiteti Nismëtar Kombëtar" në Aksaraj të Stambollit.

27.10.1909. U formua "Komitetit Kombëtar" në shtëpinë e Aqif Pashës, me rreth 80 pjesëmarrës, të cilët ishin deputetë të parlamentit osman si dhe intelektualë të shquar.

5-6.11.1909. Mbledhja e dytë e "Komitetit Kombëtar" për të eliminuar gjakderdhjen me pjesëmarrës Mehmet Dërralla, Sulejman pasha (senator), Aziz pasha (deputet i Beratit), Hasan Prishtina (deputet) dhe Rexhep efendi Tetova.

1908-1912. Oxhaku i Dërrallajve në Tetovë do të shndërrohej në një çerdhe të shqiptarizmes. Mehmet Pasha dhe i biri Halimi ishin kurdoherë në krye të lëvizjeve të mëdha atdhetare, duke dhënë ndihmesë jo vetëm me trimërinë, guximin, logjikën, por edhe me pasurinë e tyre. Të dy sëbashku ata do të prisnin e do të përcillnin në shtëpinë e madhe në Tetovë, patriotë e atdhetarë si Sali Gjukën, Bedri Pejanin, Bajram Currin, Isa Boletinin, Mid'hat Frashërin, Hamdi Ohrin, Hoxhë Vokën dhe dhjetra atdhetarë të tjerë nga krejt viset etnike shqiptare.

1910-1912. Mehmet Pashë Dërralla u vendos në krye të organizimit dhe zhvillimit të mbi 55 kryengritjeve të mëdha të Kosovës që kulmuan në verën e vitit 1912, që shënoi marrjen e Shkupit, ish-qendrës së vilajetit të Kosovës. Shqiptarët tronditën mjedisin ballkanik, ku në këtë periudhë ata shpërfillën hegjemonizmin e shteteve fqinje siç ishte Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia.

5.1.1912. Në "Arabati Baba Teqe" të Tetovës, u mbajt takimi për zgjedhjet parlamentare të xhonturqëve, që do zhvilloheshin më 15 janar 1912.

21-25.5.1912. Kuvendi i Junikut me 250 delegatë u mbajt me qëllimin imediat për zgjerimin e veprimeve luftarake të kryengritësve, ku shtrou si një detyrë të ngutshme bashkërendimin dhe organizimin e kryengritjes në shkallë kombëtare. Programi i këtij kuvendi ishte "Liria administrator e Shqipërisë".

14-23.7.1912. Kuvendi i Ferizaj ishte i dyti pas kuvendit të parë të 5-23 korrikut 1908. Në Ferizaj ishin mbledhur rreth 15.000 luftëtarë. Pjesëmarrës ishin nga sanxhaku i Prishtinës, Sanxhaku i Pejës, i Prizrenit dhe krahinave veriore të Kosovës. Qëllimi ishte shpallja e kushtetutës së vitit 1876, rivendosja e rendit kushtetues dhe Shqipëria autonome.

Korrik 1912. Sukses me rëndësi strategjike i grupimit në katërkëndëshin Gjilan-Prizren-Lumë-Tetovë. Ideja e kryengritjeve çlirimtare ishte e gjeneralit Mehmet Pashë Dërralla, ku me fjalën e tij ende pa u përplasur në dyluftim 430 ushtarë të Korpusit osman të Manastirit dezertuan në anën e luftëtarëve të lirisë.

23.12.1912. Takimi i Gjilanit i 70 prijësve luftëtarësh shqiptarë të Kosovës, ku Mehmet Dërralla hodhi idenë e autonomisë dhe të kryengritjes së përgjithëshme për marrjen e Shkupit.

9.8.1912. Kryengritjet e idejuara nga Mehmet Pashë Dërralla çuan në Memorandumin e Ferizajt, që ndryshe është quajtur historikisht "14 pikat e Hasan Prishtinës".

12.8.1912. Sulltani për të qetësuar situatën e krijuar nga trazirat në vilajetin e Kosovës, e emëroi Mehmet Pashë Dërrallën "Mytesarif" në Prizren.

13.8.1912. Forcat kryengritëse shqiptare çliruan Shkupin dhe përjetuan çaste solemne. Vilajeti i Kosovës gëzonte çlirimin e parë krahinor. Shkupi ishte shuplaka më e rëndë që kishte marrë Perandoria Osmane nga shqiptarët që prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Populli e himnizoi përjetësisht në vargje: "Janë tmerrue shtatë Kralia, Sot në Shkup ka ra Shqipnia".

8.10.1912. Mehmet Dërralla i propozon Zeqij pashës, komandantit turk të Tetovës, për të bashkuar forcat shqiptaro-osmane kundër sulmeve të ushtrisë serbe, që në fakt nuk u pranua.

27.10.1912. Edhe pse u organizua mbrojtje e përbashkët, forcat osmane të korpusit të VII-të në gadishullin e Rumelisë (Ballkanit) braktisën Tetovën e Gostivarin dhe u zhvendosën drejt Kërçovës.

28.10.1912. Mehmet Dërralla familjarisht shkon në Dibër të Madhe, ku ndodheshin edhe Isa Boletini, Elez Isufi, Ajdin Draga, e shumë luftëtarë të tjerë shqiptarë.

Nëntor 1912. Ndërkohë që Mehmet Dërralla me Isa Buletinin dhe të tjerë u nisën drejt Vlorës për Kuvendin e madh të Pavarësisë, i biri i Mehmet Dërrallës, Halimi udhëhoqi një çetë prej 200 luftëtarësh tetovarë për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

21.11.1912. Mehmet Dërralla, Isa Buletini, Vehbi Agollin e bashkë me patriotë të tjerë u nis nga Dibra për në Vlorë, sepse ishte anuluar shkuarja në Durrës. Delegatët udhëtuan me kuaj në rrugëkalimin Dibër-Borovë-Rupnik-Librazhd-Elbasan-Belsh-Fusha e Dumresë-Lushnjë-Imeshtë-Mbrostar-Fier-Mifol-Vlorë.

20-25.11.1912. Armata e tretë serbe me 63 mijë vetë e drejtuar nga gjenerali terrorist Boxhidar Janković i bie kryq e tërthor Kosovës me thirrjet hysterike: "një mijë për një" dhe "gjak, gjak, gjak shqiptar!" Monarkitë ballkanike satelite të Fuqive të Mëdha i ishin sulur si asnjëherë 60.000 km² të truallit shqiptar.

25-30 nëntori 1912. Masakra barbare në Qarkun e Prizrenit ku përfshihej edhe Tetova e Shkupi, ushtria famëkeqe serbe shkoi në thikë e bajonetë mbi 5000 shqiptarë.

28.11.1912. Ismail Qemal Bej Vlora dhe patriot të tjerë shpallën pavarësinë e Shqipërisë; ndërkohë që Mehmet Pashë Dërralla, Isa Bej Buletini dhe patriotë të tjerë ishin rrugës për Vlorë.

29.11.1912. Mehmet Dërralla, Isa Buletini dhe patriot të tjerë mbërritën në Vlorë rreth orës 14.00, pasi ishte shpallur Pavarësia shqiptare. Ata vinin nga Kosova një ndër 4 vilajetet Shqiptare me rreth 22.000 km² si dhe rreth 40% të popullsisë shqiptare.

30.11.1912. Merr pjesë si delegatë të përzgjedhur në mbledhjen e dytë të Kuvendit Kombëtar, ku në protokollin e mbledhjes është e dokumentuar: "Si delegatë të rinj erdhën z. Mehmet Pashë Dërralla, Isa bej Boletini, Ajdin Draga, Dervish bej Ipeku nga Peja e Kosovës, etj...". Ata nënshkruan aktin historik që, "Shqipëria më sot të bëhet më vehte, e lirë dhe e mosvarme..". Mehmet Pashë Dërralla në atë kohë quhej tetovar megjithëse Tetova dhe Gostivari së bashku i takonin Sanxhakut të Prizrenit.

4.12.1912. Mehmet Dërralla me propozim të Isa Buletinit zgjidhet Ministër i Luftës në qeverinë e Ismail Qemalit me 42 vota dhe zë vend në tavolinën e përfaqësuesve mbarëkombëtarë shqiptarë të katër vilajeteve. Ishte kurorëzuar ëndërra shekullore e shqiptarëve që është fiksuar në foton e 63 delegatëve të Kuvendit të Vlorës. (Mehmet Dërralla i Kosovës është në rreshtin e parë i treti në të djathtë të Ismail Qemalit).

4.12.1912. Mehmet Pashë Dërralla me një përvojë komandimi e drejtimi mbi katër dekadash bëri betimin suprem që ishte i përngjashëm me betimin që ka shkruar historiani i kombit shqiptar Marin Barleti: "Dashuria për Atdhe është më e madhja nga të gjitha; ajo qëndron mbi çdo dashuri tjetër!"

20 dhjetor 1912. Mehmet Pashë Dërralla në funksionin e Ministrit të Luftës hartoi një platformë të krijimit të një force të armatosur kombëtare të ndarë në tri etapa gradualiteti, që janë: Etapa e piketimit (dhjetor 1912), Etapa e sanksionimit (janar-qershor 1913) dhe Etapa e tretë e konkretizimit (1913-1914).

Janar 1913. Mehmet Pashë Dërralla bashkërendoi veprimet dhe gjeti mirëkuptim me dy gjeneralë e komandantë të mëdhenj të ushtrisë osmane me shqiptarin Ali Riza Pasha i Armatës Perëndimore të Omanëve dhe Hasan Riza Pashën komandant i garnizonit të Shkodrës që pranoi të luftonte për mbrojtjen e Shkodrës nën flamurin shqiptar. Në këtë kohë mbrojtja e Shqipërisë më shumë se ushtarake ishte diplomatike, ku beteja diplomatike vazhdonë në Londër në konferencën e ambasadorëve nën drejtimin

e Eduard Grey-it.

30.3.1913. Në kohën kur Ismail Qemali, Isa Boletinin dhe Luigj Gurakuqi u nisën në krye të delegacionit qeveritar shqiptar, për në kryeqytetet e Europës Perëndimore si Romë, Vjenë, Paris e deri në Londër, drejtimi i punëve të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës ju besua Mehmet pashë Dërrallës

Mars 1913. Mehmet Dërralla me mbështetjen e kryeministrit hartuan platformat e shmangjes së ballafaqimeve ushtarake me Aleancën Ballkanike në truallin shqiptar, por ju vu kusht atyre që të largoheshin nga vendi ynë. Fakt është se aktet e qeverisë Mehmet Pashë Dërralla, i ka firmosur në më të shumtën me siglën: "Mehmet Ruzhdiu", ku për mbiemër ka marrë emrin e stërgjyshit.

Mars 1913. U dërguan dy telegrame të hartuar në Ministrinë e Luftës dhe në bashkëpunim me kryeministrin për Komandën e trupave serbe në Durrës si dhe për Mbretin e Greqisë, ku në thelb kërkohet lirimi i tokave shqiptare, pasi tani Shqiptarët kishin shpallur pavarësinë.

22.4.1913. Nën drejtimin e Mehmet Dërrallës hartohet rregullorja e parë e Ushtrisë shqiptare për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës me një faqe me 7 nene. Plaku i urtë por me zemër luftarake afroi rreth vetes rreth 70 oficerë dhe 150 nënoficerë që kishin shërbyer në ushtrinë osmane dhe ishin të shkolluar, e të ndershëm për të plotësuar radhët e ushtrisë, policisë, xhandarmërisë e milicisë së rregullt shqiptare. Usharakë të tjerë që u bënë pjesë e ekipit të tij ishin: Ismail Haki Tatzati, Rexhep Shala, Mustafa Maksuti, Mustafa Aranitasi, Ali Fehmi Kosturi, Hysen Prishtina, etj.

22 Prill 1913. Mehmet Pashë Dërralla menjëherë pas hartimit të rregullores së parë, nxjerr urdhresa që thotë: "derisa të krijohet Komanda e Përgjithshme, detyrat që i përkasin kësaj komande do t'i ngarkohen Ministrisë së Luftës. Kjo nënkuptonte se Mehmet Pashë Dërralla kryente njëherësh dy funksione të Ministrisë të

Luftës dhe të Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë kombëtare shqiptare.

Prill-fillimmaji 1913. Qeveria e Përkohshme e Vlorës në mungesë të Kryeministrit drejtohej nga Mehmet Pashë Dërralla si në aspektin e punëve të brendëshme edhe në takime me diplomat të plotëfuqishëm e një numër përfaqësuesish të huaj sidomos me konsujt e Fuqive të Mëdha të vendosur në Vlorë ose që vinin në ata muaj me klimë të nxehtë politike.

4.5.1913. Mehmet Pasha bëhet inisiator i themelimit të shtabit Madhner (Shtabit Madhor), ku në këtë detyrë u caktua Major Ali Shefqet Shkupi që vinte nga detyra e komandantit të garnizonit të Stambollit, por që ishin nga e njejta trevë.

4.5.1913. Me inisiativë të Mehmet Pashë Dërrallës në këtë datë të krijimit të Shtatmadhorisë u zbatua praktika e shumë ushtrive perëndimore që ndau Ministrinë e Luftës nga aparati i Shtabit të Përgjithshëm si organ luftime. Që në atë kohë u përcaktua hallka organike Brigadë me batalione, kompani e toga, që i përgjigjej çdo prefekturë (nahije).

3.6.1913. Hartohet "Rregullore e Qeverisë së përkohshme mbi formimin e Milicisë Shqiptare". Rregullorja "Milicia Shqiptare" kishte mision "për mbrojtjen e vendit deri sa të formohet ushtria e rregullt". Ishte në varësi të ministrit të Luftës, si strukturë ushtarake dhe "çdo prefekturë do të konsiderohet si brigadë, ndërsa çdo nënprefekturë një batalion, kurse komunat sa një kompani. Qytetet janë konsideruar kompani të veçanta, kurse fshatrat toga milicie. Kryetarët e tyre do të gradohen. Rekrutohen moshat 20-40 vjeç. Komandat e milicisë do kishin regjistërin e ngjarjeve në formë statistike vjetore, ku gjithë ngjarjet raportoheshin në Ministrinë e Luftës".

28.6.1913. Konsulli austro-hungarez Lejhanetz i atashuar në Vlorë pas takimit me Ministrin shqiptar të Luftës dërgonte në Vjenë këtë mesazh: "Administrata e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës kërkon sa më shpejt në dispozicion një numër librash shërbimi lidhur me organizimin, stërvitjen e shërbimin e brendshëm të armëve të ndryshme të ushtrisë si këmbësoria, artileria, xhenioja, prapavija, shëndetësia".

Maj-qershor 1913. Në Vlorë pranë Ministrisë së Luftës dhe Shtabit Madhner formohet një kompani model. Kjo nismë pasoi me formimin e xhandarmërisë, forcave aktive të ushtrisë, forcave rezervë, forcat vullnetare. Egjithë ushtria e kësaj periudhe me të gjithë llojet e forcave kishte nën armë 12.000 luftëtarë.

Tetor 1913. Ministri i Luftës, bashkë me oficerët



Shtëpia e Pavarësisë
në Vlorë në 28.11.2017

holandezë, koloneli De Veer, formoi një xhandarmëri me pesë mijë vetë me kontrata 6 mujore, me uniformë të përafërt me atë italiane. Edhe oficerët ishin me kontratë 6-mujore.

1913. Ministria e Luftës e shtriu autoritetin e saj ushtarak në mënyrë të përputhshme me shtrirjen e autoritetit të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës që erdhi gjithmonë duke u zgjeruar.

21.10.1913. Ministri i Luftës mbajti një fjalim për qytarët e Vlorës, ku fokusi ishte drejtimi ushtarak dhe tokat e popullsisë shqiptare. Ndër të tjerash në miting u shpreh: "As desha dhe as munda që ta jap Ministrinë e Ushtrisë për Esat Pashë Toptanin sepse këtë detyrë të shenjtë ja kishte besuar Kongresi Kombëtar i Vlorës që përfaqsonte gjithë trevat shqiptare.

3.12.1913. Miratohet akti i "kontratave 6-mujore për oficerët", me rregulla për disiplinën, ndëshkimet, organizimin e këshillit disiplinor dhe këshillit të luftës" nga Qeveria e Përkohshme e Vlorës, por në këtë kohë ministri Dërralla pati dhënë dorëheqjen nga kabineti qeveritar. Mehmet pashë Dërralla u largua nga Qeveria e Vlorës. Gazeta "Përlindj" e Shqipërisë" njoftonte: "Ministri i Luftës hoqi dorë. Zoti Mehmet pashë Dërralla, i cili që ditën kur u çpall liria gjendet si ministër i Luftës, e gjet me nevojë të apë lënien nga nëpunësia që kish". "Qeveria e Përtashme ka zanë një rrugë dhespotike, krejt kundër ndjenjave liberale".

30.12.1913. Dekret i Qeverisë së Vlorës: "Mbi formimin e Gjindarmërisë së Përkohshme shqiptare në krahinat e jugut".

1913. Bandat serbo-sllave organizuan në fshatin e lindjes së ministrit shqiptar të luftës në Gradec një ndër masakrat çnjerëzore, ku në afërsi të varrezave të fshatit pushkatuan 163 burra se gjoja ishte bërë vrasja e një ushtari serb me emrin Zafir. Mbijetuan vetëm 3 veta.

Dhjetor 1913. Ministri i Luftës pasi dorëhiqet, nuk largohet nga trevat shqiptare, por qëndron në Durrës. Gazetat "Liri e Shqipërisë", "Përlindj" e Shqipërisë" dhe "Shqypnia e re", e Hilë Mosit njoftuan se: "Ministri i Luftës hoqi dorë", por jo nga çështja shqiptare.

22. janar 1914. Jep dorëheqjen Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe mandatin qeverisës i'a desoi dhe i'a dorëzoi Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK).

Mars 1914. Mehmet pashë Dërralla caktohet prefekt i Elbasanit nga Vidi, në vendin që lëshoi Aqif Pashë Biçaku.

23.5.1914. Mehmet Dërralla ndërmjetësoi me kryengritësit shqiptarë me flamur të bardhë në dorë për armëpushimin me trupat qeveritare, ndërkohë që ishin vrarë 13 vullnetarë shqiptarë kryengritës. Ndërhyrja e tij mbylli gjakderdhjen.

28.5.1914. Mehmet Dërralla shkoi në Shijak si përfaqësues të Komisionit Ndërkombëtar, që të hynte në bisedime paqësore. Studuesit gjykojnë se Mehmet Pashë Dërralla ishte në shërbim të princit Vid dhe qeverisë së Turhan Pashë Përmetit, për të mirën e çështjes kombëtare.

5.8. dhe 11.8.1914. Mehmet Dërralla, së bashku

me Dervish Himën, me përkrahjen e Hasan Prishtinës, Bajram Currit, Isa Boletinit kanë bërë përpjekje për të hyrë në lidhje me kryengritësit fshatarë të Shqipërisë së Mesme për të luftuar kundër pushtuesve serbë.

3.9.1914. Vilhelm Vidi largohet përfundimisht nga Durrësi dhe Shqipëria. U krijua një situatë e vështirë për qëndrimin e patriotëve të çështjes kombëtare në Durrës, prandaj morën rrugën për Shkodër.

Tetor 1914. Mehmet Pashë Dërralla kapet në pabesi bashkë me birin Halim Bej Dërralla, arrestohet dhe dërgohen të lidhur në Krallovë të Bullgarisë, ku akuzohen nga gjykata ushtarake bullgare. Por me ndihmën e disa patriotëve shqiptarë të Shkupit arratisen nga burgu dhe vazhdojnë jetën nëpër malet e Sharrit të përndjekur nga bullgarët dhe serbët.

Fillimviti 1915. Mehmet Dërralla dhe patriot të tjerë shkojnë në zonën e Shkodrës, edhe pse edhe në Shkodër përndjekja e tyre vijonte.

Qershor 1915. Mehmet Dërralla, u arrestua në Shkodër së bashku me Aqif pashë Elbasanin, Luigj Gurakuqin, e patriot të tjerë që gjurmoheshin e mbikëqyreshin rigorozisht nga "Crna Rukës"/"Dora e Zezë" serbo-malazese dhe "Bella Rukës"/"Shoqëria e Fshehtë Ushtarake".

Nëntor 1915. Mehmet Dërralla i kapur në mallet e Sharit nga forcat serbo-bullgare dërgohet në burg, në kështjellën e Karlovës në Bullgari, dhe më vonë transferohet në qelitë e Podgoricës edhe pse vazhdonte të ndiqej me sy survejues nga Cetinja, Beogradi dhe Sofja vetëm se ishte shqiptar me ideale të vendosura shqiptare.

5.11.1915. Trupat serbe në Luginën e Vardarit në fushën e Pollogut masakruan 149 martirë shqiptarë, ku nga trugu i Dërrallajve ranë heroikisht këta burra: Musliu, Shabani, Fetah, Jahja, Jamini, Abduramani, Ahmeti, Ismaili, Isai, Mehmeti.

1916. Pas pushtimit austro-hungarez të Shqipërisë e Malit të Zi u liruan nga burgu dhe Mehmet Dërralla me patriotë të tjerë; pas liritimit nga burgu shkoi në Pejë, tek e mbesa e tij, Esmë Begolli.

1918. Përndjekja e tij vazhdon dhe humb jetën në Podgoricë, i helmuar nga klika antishqiptare, burri i shquar Mehmet Hasan Dërralla në moshën 75 vjeçare. Mehmet Dërralla është njohur me katër mbiemra: Tetova, Kalkanderi, Ruzhdija dhe Kosova. Mehmet Dërralla mbylli sytë me amanetin: "Amanet burra, katër shtyllat e kombit të përbashkuara", që ishin katër Vilajetet shqiptare me një bashkësi, me një gjuhë, me një gjak dhe me një histori.

1921. Kur u konstituua Parlamenti i parë shqiptar i biri i Mehmet Dërrallës, Halim Bej Dërralla ishte deputet i trevave shqiptare të Maqedonisë.

Dhjetor 1924. Presidenti shqiptar duke kaluar nëpër Tetovë shkon një natë tek shtëpia e Dërrallajve (tek Halim Mehmet Dërralla).

1925-1928. Halim Mehmet Dërralla rizgjodhet deputet në Parlamentin shqiptar të Tiranës.

1930 dhe 1931. Halim Mehmet Dërrallës, jurist i njohur dhe atdhetar i shquar i birit të Ministrit të parë të Luftës i bëhet dy herë atentat, por që të dyja herët



ka qenë të dështuara.

1933. Halim Mehmet Dërralla si rezultat i presioneve të mëdha të mercenarëve serbë dhe me miratimin e mbretit të shqiptarëve vendoset në Tiranë.

1934. Halim Mehmet Dërralla sëmuret dhe shkon për një vizitë tek mjeku. Por vetëm pak çaste pas vizitës mjekësore vdes në mënyrë misterioze sikurse dhe babai i tij, çka vërteton atë se personalitetet e lëvizjes kombëtare shqiptare jo rrallë i ka prerë plumbi, shpata dhe helmi, por jo në pak raste janë prerë edhe në besë.

30.11.1992. Dekretet e Presidentit shqiptar me dekret nr. 376 datë 30.11.1992, dekoron Mehmet Pashë Dërrallën me "Urdhërin për veprimtari Patriotike të Klasit të Parë".

4.12.2009. Në përvjetorin e 97-të, të Forcave të Armatosura Shqiptare, Ministri i Mbrojtjes së RSH, e dekoroi Gjeneral Mehmet Pashë Dërrallën me medaljen "Për shërbime të shquara".

28.11.2011. Në fshatin e lindjes në Gradec, u vendos busti në sheshin që mban emrin e tij, ku është edhe

një shkollë që mban emrin "Mehmet Dërralla".

26.11.2012. Mehmet Pashë Dërralla, ministri i parë i luftës në qeverinë shqiptare nderohet me Urdhërin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nga kryetari i shtetit shqiptar.

2013. Në Gradec të Tetovës pas një shekulli është ngritur "Lapidari i lirisë", që u kushtohet 163 burrave të ekzekutuar nga Serbo-sllavët në vitin 1913. Mehmet Pashë Dërralla ka tre buste: një bashkë me Ministrat e tjerë në Vlorë të përgatitur nga Skulptori Sotir Kosta nga Përmeti, një në Tetovë të përgatitur nga dy shqiptarë nga Tetova si dhe një skulpturë mbi kale që ndodhet në muzeun e Londrës.

Maj 2014. Publikohet Revista shkencore ndërkom-bëtare "Diskutime", nr. 11/2014, me titull "Neoshqiptarizma e Mehmet Pashë Dërrallës", publikim i Qendrës për Marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime ballkanike & Akademia diplomatike shqiptare me qendër në Tetovë.

Bibliografia:

- Historia e Shqipërisë, Vëllimi I, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1959.
- Historia e popullit shqiptar, Vëllimi II, Botim i Akademisë së Shkencave, Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë, 2002.
- Historia e popullit shqiptar, Vëllimi III, Botim i Akademisë së Shkencave, Shtëpia Botuese "Toena", Tiranë, 2007.
- Buletini Arkivor Ushtarak, Qershor, Tiranë, 2011.
- Gjergj Titani, Proletar Hasani, Personalitete Ushtarake shqiptare në vite, 1912-dhjetor 2012, Vëllimi i parë, Shtypshkronja Gentgrafik, Tiranë, 1997.
- Draft-studim Personalitete ushtarake shqiptare, Tiranë, 2012-2014. (AQFA).
- Çelebiu, Evlia, Shqipëria parë tre shekujsh, Enciklopedia shqiptare e mesjetës shqiptare, Shtëpia Botuese "Besa", Tiranë, 2000.
- Proletar Hasani, Kush e ka drejtuar ushtrinë shqiptare, Tiranë, 2001.
- Historia e Ushtrisë shqiptare, Organizimi, pjesa e parë, Shtëpia bot. ushtrisë, Tiranë, 2008.
- Buda, Aleks, Shqipëria përballë krizës Lindore të viteve 1878-1881, Tiranë, 1978.
- Alban Nexhip;Kaçi,Nesip;Shqiptarët në Perandorinë Osmane, Monografi Tiranë:Albin, 1997.
- Klyçe, Sulejman, Shqipëria në historinë osmane, Tiranë: Globus R, 2004. (përkthyer dhe pajisur me shënime nga Zyber Hasan Bakiu).
- Mantranit, Robert, Historia e Perandorisë Osmane, Tiranë: Dituria, 2004.
- Eqerem Bej Vlora, Kujtime (1885-1925), Tiranë: Shtëpia botuese e Librit & Komunikimit. (sipas kujtimeve të babait të tij, Syrja Bej Vlora-ish deputet i parlamentit osman).
- Fjalorit Enciklopedik, Tiranë: Baucchus, 2002.
- Eqerem bej Vlora. Kujtime 1885-1925, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe e Komunikimit, (Botuar për herë të parë nga Instituti i Studimeve për Evropën Juglindore në Mynih të Gjermanisë në vitin 1973), 2003.
- Golemi, Zaho, Buletini Arkivor ushtarak, "Ministri i Parë i Luftës", Tiranë, Mars 2011.
- Jacques, Edëin. Shqiptarët, (Historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme), Fasano, Itali: Grafischena, (Botimi i parë 1996), 2003.
- Smirnova, Nina D. Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX, Tiranë: Ideart, 2004.



**FA shpëtojnë nënën
e sëmurë të dy fëmijëve**